Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Profil

Ruzhdi Lata, modeli ku besimi bashkëjeton me punën

Nga **OSMAN XHILI**



4

Kulturë

Ahmet Balliu, një jetë mes tingujve muzikorë

Nga **prof.dr. HAJRI SHEHU**



15

Përvjetor

"Dy shtatat" e jetës sime

Kam mall e dashuri për vendlindjen, për të gjithë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



16

PËRSHTYPJE UDHËTIMI

Nga Peshkopia në Fushë Lurë, rrugës nga Grykë Noka

Nga **MARK D. VICKERS**

187 kilometra nga Tirana dhe vetëm 20 kilometra nga kufiri me Maqedoninë, Peshkopia është qyteti kryesor i rrethit dhe qarkut Dibër. Kisha lexuar pak mbi historinë e qytetit, aq sa të dija se banorët e parë ishin vendosur që në kohët para Krishterimit. Ndërsa qëndroja në dhomën time në një hotel të thjeshtë, dëshiroja aq shumë t'u tregoja të gjithëve që dinë aq pak mbi Shqipërinë se ajo ka kulturën më të lashtë dhe më të mrekullueshme në Evropë...

Çfarë vendi i mrekullueshëm! Kisha lexuar se zona ku ndodheshim ishte akoma shtëpia e arinjve të murrmë, rrëqebujve, ujqërve, kunadheve dhe kapronjve, po për fat të keq nuk pashë asnjë prej tyre. M'u kujtua shprehja e poetit të famshëm Gjergj Fishta (1871-1940): "Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë".

— Faqe 8-9

RRJETE SOCIALE

Tiku që çdo ditë mbledh dibranët!

Nga **SAMET ZAGRADI**

Mijëra dibranë ndodhen larg vendlindjes. duke ndërtuar një jetë më të mirë, por pa e harruar vendin ku u lindën dhe u rritën. A ju mungon këtyre njerëzve Dibra? Ju mungojnë bukuritë e rralla, traditat, vendet, njerëzit, gatimet e mrekullueshme të gjysheve, odat dibrane, dialekti karakteristik, përse jo, dhe problemet e hallet që çdo ditë i jetojmë. Teknologjia ka bërë që këto gjëra të mos i harrojmë, madje t'i shohim çdo ditë edhe pse virtualisht.

— Faqe 12

HISTORI

Shënimet e kronistëve dhe historianëve osmanë, për Skënderbeun dhe familjen Kastrioti

Nga **ILMI VELIU**

— Faqe 18-19

Bashkitë e Qarkut të Dibrës harrojnë rikonstruksionin e shkollave



Katër bashkitë e qarkut Dibër japin vetëm disa thërrime nga buxhetet e tyre për mirëmbajtjen, rikonstruksionin ose ndërtimin e ambienteve arsimore, duke mbajtur sytë nga qeveria për ndonjë financim të mundshëm.

Photocredit @KURTIDRITAN

NGA **DRITAN KURTI** - Faqe 6-7

Agim Deva, dibrani që prezanton falas Shqipërinë në SHBA



Faqe 13

NË BRENDËSI: ■ Një pyetje për Kryeministrin: "Ku është kantieri? ■ Aksident tjetër në minierë, plagosen dy minatorë në Bulqizë ■ Qershitë e Dibrës, transporti mban larg tregtarët ■ Fshatarët fitojnë betejën kundër koncesionit për shfrytëzimin e pyllit ■ Të dhëna arkeologjike nga Çidhna e Poshtme ■ Izet Dema, portreti i një njeriu që banorët e thërrasin "Doktor" ■ Vera Laçi, duke u stërvitur soliste, u bë mjeshtre e artit dibran ■ 100 vjet shkolla e Allajbegisë ■ Atëherë ishim vetëm 15 vjeç... ■ Botimet historike të studiuesit dhe historianit matjan ■ Mësuesi orator Haki Pahumi ■ Promovohet libri "Dritëhijet e një poeti", monografi për Naim Plakun ■ Poezi nga Halil Teodori dhe Dritan Qoku ■ Provat e jetës e të përkushtimit të Elmaz Muratit

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (145). Maj 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit qershor

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Dritan KURTI / portavendore.al
Mark D. VICKERS
Hajri SHEHU
Dea & Klovis KAROSHI
Adem BUNGURI
Halil TEODORI
Dritan QOKU
Ilmi VELIU
Zabit LLESHI
Destan RAMA
Mevlud BUCI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

LAJME SHKURT

Ndihma gjatë muajit të Ramazanit

Shoqata Atdhetare Dibra në New York, nën kujdesin e z. Bekim Paçuku, do të organizojë grumbullimin e mjeteve monetare për të ndihmuar familjet në nevojë gjatë muajit të Ramazanit në qytetin e Dibrës së Madhe. Ndihmat do të shpërndahen në pako me vlerë 100 USD, të cilat do të paketohen nga kompania “Dash Komerc” – Dibër, e cila do të realizoje edhe shpërndarjen e tyre nëpër shtëpitë e familjeve në nevojë. Çdo pako e shpërndarë do të mbikqyret nga një grup i caktuar nga Shoqata, e cila i bën thirrje bashkëatdhetarëve të saj në SHBA, që të bëjnë donacione duke filluar nga 100 dollarë. Shoqata sqaron në faqen e tyre zyrtare në FB dhe ëeb, se mënyrat e pagesës do të jenë Cash në zyrën e shoqatës ose përmes Credit Card ose PayPal.

MINISTRJA E SHËNDETËSISË NË DIBËR:

Rehabilitojmë këtë vit 80 qendra shëndetësore

Dy qendra të reja shëndetësore në qarkun e Dibrës janë rehabilituar plotësisht dhe pajisur me të gjithë mjeket e nevojshme, duke ofruar shërbim cilësor për 30 mijë banorë të Maqellarës në Dibër dhe Shupenzës në Bulqizë.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu inaguroi qendrat shëndetësore të Maqellarës dhe Shupenzës, të cilat ofrojnë shërbim shëndetësor 24 orë për banorët e këtyre zonave.

“Po vendosim një standart të ri në shërbimin parësor me rikonstruksionin e qendrave shëndetësore model për nga instrastruktura dhe pajisjet, siç janë qendrat që inagurojmë sot në Maqellarë dhe në Shupenzë. Kemi nisur programin kombëtar të rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore në 4 vite dhe këtë vit do të rehabilitojmë 80 qendra të kujdesit parësor nga veriu në jug të vendit”, tha Manastirliu.

Qendra shëndetësore e Maqellarës ofron shërbim 24 orë për rreth 14 mijë banorë të kësaj njësie administrative në Dibër, njofton ministria sipas së cilës edhe qendra e Shupenzës në zonën e Bulqizës ofron shërbim shëndetësor dhe urgjencë 24 orëshe.

“Kjo qendër i shërben jo vetëm rreth 7 mijë banorëve të Shupenzës por edhe rrethinave, duke mbuluar shërbimin për zona të thella të Bulqizës për rreth 15 mijë banorë.

Katër qendra shëndetësore janë rehabilituar në qarkun e Dibrës (Maqellarë, Kastriot, Shupenzë dhe Komsi) me mbështetjen e projektit “Shëndet për të Gjithë” të Qeverisë zviceriane me vlerë 50 milion lekë” – thuhet në njoftimin zyrtar.

Përvec rehabilitimin dhe pajisjes së qendrave shëndetësore, të gjithë mjekët e familjes në qarkun e Dibrës janë trajnuar dhe pajisur me “çantën e doktorit”, e cila përmban 17 instrumente mjekësorë.

“Me mbështetjen e “Shëndet për të gjithë”, do të pajisen edhe infermierët e të gjithë qarkut Dibër me çantën e infermierit, shumë e nevojshme për ofrimin e ndihmës së parë në rast të urgjencave në territor” – deklaron Ministria e Shëndetësisë. *(Javanews.al)*

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com



Shesh-grumbullimi i kromit në minierën e Bulqizës. Foto: © Sami Curri.

Aksident tjetër në minierë, plagosen dy minatorë në Bulqizë

Shembja e një masivi gurësh plagosi dy minatorë në Bulqizë në një nga galeritë që menaxhohen nga kompania AlbChrome. Një nga minatorët u soll në Tiranë në gjendje të rëndë.

Autor: **Hysen Likdisha** | *BIRN* | *Bulqizë*

Dy minatorë u plagosën dhe njëri prej tyre u nis me helikopter drejt Tiranës në gjendje të rëndë, pas një aksidenti në një nga galeritë e kromit në Bulqizë. Policia njoftoi se Selim Zeneli, 50 vjeç dhe Mentor Gjeta, 31 vjeç u plagosën rreth orës 13:00 të mesditës së martë, ndërkohë që shkaqet janë ende në hetim.

Sipas komunikatës paraprake të policisë mësohet se gjatë punës në nivelin e 17 të minierës, “nga tavani i galerisë është shkëputur një masiv shkëmbor që ka zënë poshtë dy minatorët”. Policia tha se menjëherë në galeri ka mbërritur grupi i kërkim-shpëtimit, që u ndihmua edhe nga minatorët e tjerë të turnit duke bërë të mundur nxjerrjen mbi sipërfaqe të dy minatorëve që kishin mbetur të bllokuar.

Të plagosurit janë dërguar për të marrë ndihmë mjekësore në spitalin e Bulqizës dhe mjekët kanë konstatuar se njëri prej tyre ndodhej në gjendje më të rëndë. Minatori është dërguar me helikopter drejt Tiranës, për të marrë ndihmë mjeksore të kualifikuar. Burime nga spitali i Bulqizës i thanë BIRN se të plagosurit kanë pësuar dëmtime kryesisht në kokë dhe gjymtyrët e poshtme.

Galeria ku ndodhi aksidenti menaxhohej nga kompania AlbChrome –pjesë e grupit Balfin, që është koncensionari më i madh në zonën e Bulqizës. Në një reagim për BIRN, grupi Baflin deklaroi se minatorët e aksidentuar ndodhen jashtë rrezikut për jetën, ndërkohë që nënvizoi se kompania Alb Chrome ka marrë masa e nevojshme për të minimizuar aksidentet.

“Kompania Alb Chrome ka angazhuar menjëherë skuadrën e gatshme të kërkim – shpëtimit, ka nxjerrë minatorët nga vendi i aksidentit dhe ka kontaktuar me Ministrinë e Mbrojtjes për transportimin e njërit prej tyre në spitalin e Traumës në Tiranë” tha Sokol Kondi, manaxher i marrëdhënieve me publikun për grupin Balfin. “Njëri prej [minatorëve] ka pësuar një frakturë në njërën këmbë,” shtoi ai.

Aksidentet në zonën minerare të Bulqizës janë bërë thuajse të përjavshme. Shtatë minatorë dhe një punëtore seleksionimi kanë humbur jetën prej nëntorit të vitit të kaluar, ndërsa mjaft të tjerë janë plagosur. BIRN gjeti në një shkrim të mëparshëm se megjithëse konstatoheshin probleme për sigurinë në miniera, masat ndaj koncesionarëve ishin kryesisht gjoba, ndërsa faji për aksidentet mbetej mbi viktimat.

Kondi tha se aksidenti nuk kishte ardhur si pasojë e mungesës së masave të sigurisë në galeri dhe insistoi që kompania Alb Chrome i merrte seriozisht çështjet e sigurisë në minierë.

“Do të donim të theksonim se aksidentet që ndodhin në Bulqizë, ku ka kompani dhe galeri të shumta minerare, nuk kanë asnjë lidhje me kompaninë Alb Chrome, e cila i ka marrë të gjitha masat përkatëse të sigurisë,” përfundoi ai.

Në fillim të muajit, një grua, rreth 50 vjeçe, që punonte si seleksionuese e kromit për kompaninë “Brisel Shpk” u bë viktima e rradhës e problemeve të sigurisë në punë në minierën e Bulqizës. Kompania ishte pezulluar në fund të vitit që shkoi, pasi dy minatorë humbën jetën në galeritë e menaxhuara prej saj.

Gruaja vdiq gjatë transportit për në spitalin e Bulqizës, ndërsa kishte marrë plagë të rënda nga goditja e një makine të tonazhit të rëndë në sheshgrumbullimin e kromit mbi zonën D në Bulqizë.

Policia, e cila identifikoi viktimën, deklaroi se gruaja vdiq pasi ishte goditur nga një makinë. Në një komunikim të dytë me mediat, policia njoftoi se viktima dhe drejtuesi i mjetit që e aksidentoi për vdekje punonin për kompaninë “Brisel Shpk”.Ndërkohë, megjithë pretendimet e autoriteteve për hetime, agjencia e lajmeve BIRN shkroi se kishte gjetur në disa shkrime të mëparshme se në shumicën dërrmuese të rasteve, faji u lihej viktimave dhe në pak të tjera kolegëve të tyre minatorë.

50-vjeçarja është viktima e 8 në shtatë muaj që humb jetën në minierën e Bulqizës.

Kromi është minerali më i rëndësishëm i Shqipërisë nga pikëpamja ekonomike. Aktualisht ka rreth 110 kompani të licencuara për të shfrytëzuar rezervat e kromit në zonën e Bulqizës, eksportet e së cilit arrijnë në rreth 100 milionë euro në vit. Ndërkohë megjithë aksidentet e shumta dhe faktin se disa herë është vënë alarmi për situatën e rëndë të sigurisë në punë në zonë, nuk duket se ka ndonjë ndryshim të gjendjes.

aktualitet

DEKLARATË E KRYEMINISTRIT

Brenda majit do të çelim kantierin e Rrugës së Arbrit dhe do të fillojë e nuk do të ndalet më puna deri sa të përfundojë përfundimisht. Ky aks do ta bëjë Dibrën zonë të integruar me kryeqytetin dhe do të çelë potencial shumë të madh për të gjithë atë krah, që lidh Tiranën me Dibrën dhe ka bukuri përrallore të paprekura dhe që shumëkush nuk i ka parë dot për shkak të mungesës së rrugës.

EDI RAMA,
Lezhë, 8 maj 2018



Karikaturë nga
© Bujar Kapexhiu

16,000 NËNSHKRUES TË PETICIONIT PËR RRUGËN E ARBRIT PYESIN KRYEMINISTRIN RAMA:

"KU ËSHTË KANTIERI?

Në përgjigje të pyetjeve nëse kanë filluar punimet në fshatin FSHAT, në bashkinë Klos, po publikojmë këtë foto të rregjistruar më 7 Maj. Që nga ajo ditë, nga informacioni që kemi, kantieri që premtoi Edi Rama, se do të ndërtohet në fund të Majit, nuk është gjëkundi. Vazhdoni të nënshkruani peticionin: http://chn.ge/1NZeyGu

Njoftimi është shoqëruar me një foto të anëtarit të Grupit te Lobimit, Dr Gëzim Alpion, i cili gjatë vizitës në Shqipëri në fillim të Majit u interesua të mësoj për ecurinë e punimeve të kësaj vepër të premtuar dhe të lënë pas dore që nga vitit 2005.

Kujtojmë lexuesit se, menjëherë pas vizitës së Dr Alpion në Tiranë, KM Rama u shpreh: "Brenda majit do të çelim kantierin e Rrugës së Arbërit dhe do të fillojë e nuk do të ndalet më puna deri sa të përfundojë përfundimisht."

Fakti qe kantieri i premtuar nuk ekziston tregon se Rama vepron, ose bën sikur vepron, në lidhje me këtë vepër të rëndësishme infrastrukturore për Dibrën, verilindjen e Shqipërisë, kombin shqiptar dhe Ballkanin vetëm kur ka reagime nga Grupi i Lobimit që inicioi peticionin online me 18 Mars 2013.

Që nga ajo kohë, gjatë 5 viteve të regjimit Rama, në mungesë të një opozite të efektshme politike, Grupi i Lobimit është e vemja 'force', megjithëse jo politike, që e sëkëlldis vazhdimisht Kryeministrin Rama i cili, nga mënyra se si e trajton Rrugën e Arbrit, duket se do ta kishte harruar këtë vepër më keq se çdo paraardhës i tij. Kjo duket edhe nga fakti se në 5 vjet që është në pushtet, ky KM nuk ka arritur të ndërtoj qoftë edhe një metër rrugë, por ka paraqitur si arritje, atë që lanë pa përfunduar qeveritë para tij.

Me të drejtë, 16,000 nënshkrues të peticionit, nga të cilët rreth 14,000 online dhe 2,000 në formulare, pyesin me indinjim Ramën se përse, edhe në rastin e kantierit të larpermendur, nuk po e mban fjalën.

Ndërkohe, 6 deputetët e qarkut të Dibrës, si paraardhësit e tyre, vazhdojnë të heshtin në mënyrë të turpshme për Rrugën e Arbrit, dhe



bëhen 'të gjallë' vetëm kur mbrojnë interesat e ngushta të partive përkatëse.

MEDIA: 20 VJET TV BULQIZA

Më 12 maj, në qytetin e Bulqizes u festua 20 vjetori i Televizionit Bulqiza. Drejtori i TV Bulqiza dhe njëkohësisht pronari i saj Edmond Isaku e hapi fjalën e tij me urimin për pjesëmarrjen dhe u ndal në mënyrë të veçantë në rrugëtimin e gjatë dhe të vështirë përgjatë 20 viteve dhe vlerësoi lart kontributin e bashkëpunëtorëve të tij në të gjitha fushat pa të cilin nuk do të arrihej suksesi i tanishëm. TV Bulqiza radhitet ndër televizionet lokale me një teknologji bashkëkohore dhe një performancë mjaft cilësore. Ky institucion është bërë një zë i fuqishëm informimi dhe formimi qytetar ku paqyrohet me realizëm dhe vërtetësi jeta, puna, zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, sociale, kulturore, fetare. Në fjalën e tij zoti Isaku u ndal te vizioni dhe filozofia e tij lidhur me menaxhimin dhe drejtimin e këtij institucioni duke vënë theksin tek fuqia transformuese që ka media elektronike në emancipimin kulturor dhe shoqëror të banorëve të rrethit të Bulqizës dhe më gjerë. Me një staf të motivuar dhe me përvojë të gjatë ky telefizion ka rritur performancën e tij jo vetëm në informacionin e gjithanshëm që përcjell, por edhe me nivelin e lartë të përpunimit të materialeve që emetohen nga stafi: me gazetarë Hysen Likdisha, operator Defrim Karaj, montazhier Myrteza Gjoka dhe sa e sa të tjerë që kontribuojnë për realizimin e produksioneve me një nivel të lartë dhe shije moderne në metodikën e pasqyrimit të realitetit që jetojmë dhe evokimit të së kaluarës historike dhe vlerave të këtij komuniteti. Edmondi me frymën e tij mjaft bashëpunuese ka ditur të afrojë pranë këtij institucioni forcat e reja krijuese dhe interpretuese të qytetit dhe të rrethit Bulqizë, duke shfrytëzuar në dobi të përparimit shoqëror talentet dhe performancën e tyrë estetike dhe mediatike. Një vodeoklip i përgatitur posaçërisht për këtë aktivitet shpalosi veprimtarinë e televizionit dhe kontributin e tij në vite duke u ndalur në momentet më pikante të veprimtarisë krijuese dhe transmetuese. Më pas përshëndeti deputetja e qarkut Dibër znj. Dhurata Çupi e cila u ndal te vlerat promovuese që ka ky institucion, rëndësinë që kanë përgjithësisht mediat lokale në qytetërimin, transformimin dhe emancipimin e shoqërisë. Në emër të Bashkisë Bulqizë përshëndeti zoti Melaim Damzi, kryetar i kësaj bashkie. Zoti Damzi vlerësoi rolin dhe kontributin që ka luajtur TV Bulqiza si një instituzion me integritet të lartë social-kulturor, duke qenë i pranishëm në të gjitha zhvillimet vendore dhe, i ekuilibruar dhe duke kontribuar edhe në problematikat që kemi patur në komunitet drejt një sensibilizimi publik kurdoherë me kahje positive për progres.

Kryetari i Shoqatës Bulqiza zoti Bashkim Lami vlerësoi kontributin që ka dhënë televizioni Bulqiza në promovimin e vlerave kulturore sportive e fetare si dhe pasqyrimit të traditave patriotike dhe luftërave të përgjakshme që janë bërë nga populli i Bulqizës në mbrojtjen e lirisë kombëtare e shoqërore si dhe duke u bërë interprete e promovuese e vlerave intelektuale të krahinës së Bulqizës dhe më gjerë.

TREGU



Pavarësisht vështirësive, 3 qershor në Peshkopi do të organizohet "Festa e Qershisë", një veprimtari e cila synon të kthehet në traditë në të ardhmen, sidomos me ndërtimin e Rrugës së Arbërit, kur ky panair do të jetë vetëm 1 orë larg nga kryeqyteti.

Qershitë e Dibrës, transporti mban larg tregtarët

Me dhjetra ton qershi po shkon dëm në qarkun e Dibrës, ku fermerët ankohen për mungesën e tregut, ndaj në protestë simbolike edhe prenë disa pemë. Por në Drejtorinë e Bujqësisë së Qarkut, thonë se problemi i madh nuk është mungesa e tregut por gjendja e rrugës së Peshkopi-Dibër e cila mban larg eksportuesit pasi prodhimi dëmtohet gjatë transportit. Fermerët nga ana tjetër kërkojnë ndërtimin e një qendre grumbullimi e cila sipas tyre do të ishte zgjidhja.

Një fermer dibran preu para kamerave një prej pemëve të qershive që kultivon në shenjë protestë për mungesën e tregut që në zonë po çon dëm dhjetra tonë prodhim.

Por në Drejtorinë e Bujqësisë së Qarkut Dibër, drejtori Novruz Jashari thotë se interesi i kompanive eksportuese nuk ka munguar, por problemi i madh është gjendja e rrugës Peshkopi-Tiranë.

"Me rreth 460 hektarë tokë të kultivuara, në Dibër ishte përllogaritur të prodhohej rreth 3 mijë ton qershi. Edhe për defektin e mbjelljeve ndër vite, ku pjesa më e madhe e qershisë në Dibër e kultivuar është e varietetit bulat, e cila piqet herët dhe nuk i reziston transportit. Kompania në dy ngarkesa që tentoi të nisej drejt Lushnjes dështoi për shkak edhe të dëmtimit të rrugës", tha për TV Ora Neës Jashari.

Por kushtet atmosferike sipas Drejtorit të Bujqësisë dëmtuan cilësinë e prodhimit. Këtë situatë duket se po shfrytëzojnë përpunuesit e qershisë.

"Ka çdo ditë persona qoftë në nivel kompanish, qoftë individë të veçantë që vinë dhe grumbullojnë qershitë. Mund të ndodhë që për shkak të humbjes së cilësisë qershitë mund të bien në 30 lekë", i tha Ora Neës, deklaroi drejtori i Bujëqsisë në Dibër.

Fermerët nga ana e tyre thonë se zgjidhja do të ishte ndërtimi i një qendre përpunimi e cila do tu garantonte atyre shitjen e prodhimit, ose në të kundërt paralajmërojnë se do të detyrohen që ti presin të qershitë, ashtu siç kanë bërë në të shkuarën edhe me mollën e famshme të Dibrës.

"Qershia ka ngelur. Një sasi e madhe ka rënë në tokë. Kam shitur shumë pak, 3-4 kuintalë, me 5 lekë kilen", i tha një fermer gazetarit të Top Channel.

Edhe ky televizion konstatoi se vështirësitë e tregut vijnë për shkak të rrugës së keqe.

"Edhe pse është një ndër qershitë më cilësore në vend, prodhimi i Dibrës e ka të vështirë rrugën e shpërndarjes në tregjet e vendit, për shkak edhe të aksit të amortizuar Peshkopi-Tiranë", konstatoi Top Channel.

Pavarësisht këtyre vështirësive, Fondacioni ALCDF, në bashkëpunim me Bashkinë Dibër, World Vision, CNVP dhe Friends of Albania, më mbështetjen e USAID dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë do të organizojnë më 3 qershor në Peshkopi, "Festën e Qershisë", një veprimtari e cila synon të kthehet në traditë në të ardhmen, sidomos me ndërtimin e Rrugës së Arbërit, kur ky panair do të jetë vetëm 1 orë larg nga kryeqyteti.

Rruga e Arbërit nr. 145

“Të jetosh e të punosh në Dibër, - thotë Ruzhdiu, - është njësoj si me qenë tërë jetën student, në një universitet të famshëm”.

profil

Ruzhdi Lata, *modeli ku besimi bashkëjeton me punën*

Nga **Osman XHILI**



Kryetari i komunës të Dibrës së Madhe, i nderuari Ruzhdi Lata, po punon në zyrën e tij të punës, në një ditë të zakonshme. Zyrtarë të shumtë hyjnë e dalin aty, me letra dhe dokumente në duar, pyesin, konsultohen, firmosin e vulosin dokumente e më pas largohen. Kryetari sapo ka fituar një mandat të dytë në krye të komunës, duke marrë besimin e popullit. Ky mandat i dytë është një obligim më shumë për të, për t’ja kthyer popullit këtë respekt në punë konkrete, vepra, rrugë, shkolla, kopshte fëmijësh dhe vende pune për njerëz.

Vitet ecin dhe si pa kuptuar, për kryetar Ruzhdiun numri i tyre ka shkuar 64. Nganjëherë, udhëtari ndalet për të marrë pak frymë dhe pushon pak. Kthen kokën pas dhe sheh sa rrugë ka përshkuar, hedh sytë përpara dhe sheh sa rrugë i ka mbetur. Në një nga këto momente, Ruzhdi Lata e sheh veten fëmijë të vogël, që kërkonte të çajë nëpër dallgët e jetës. Mbaroi arsimin fillor në Dibër të Madhe dhe u nis për në medresenë “Alaudin”, në Shkup. Ishte i vetmi fëmijë nga qyteti i tij, por dëshira për dije e mposhti ndjenjën e vetmisë dhe ai po ngjiste shkallët me hap të matur e të sigurtë. Pas pesë vjetësh në medrese, filloi studimet universitare pranë filologjikut, po në Shkup, për gjuhët orientale, arabisht, osmanisht dhe turqisht. Më vonë studime të tjera pasuniversitare dhe mbron magjistraturën me temën: “Realiteti historik i Qorbelasë”, vepër e Naim Frashërit. Djaloshi i atëhershëm ishte i etur për dije në fusha të ndryshme. E dinte që duhej të ishe vetë i pasur për tu dhënë pasuri të tjerëve, të ishe vetë i ditur për t’u dhënë të tjerëve prej saj.

Plot 40 vjet punoi si myfti i Dibrës së Madhe, në kuadër të bashkësisë islame të Maqedonisë. Paralelisht kësaj ishte ligjërues në fakultetin e filologjikut në Shkup, pikërisht, aty ku dhe ishte diplomuar, deri në vitin 1991. Serbët i larguan që aty dhe për dy vjet një punë e tillë vazhdoi në Prishtinë, në kushte shumë të vështira. Dy vite të tjera ligjëron si profesor i shkencave islame në Shkup dhe tre vite të tjera akoma, në universitetin shtetëror të Tetovës. Në vitin 2013 kandidon dhe fiton si kryetar i komunës së Dibrës së Madhe dhe pak kohë më parë merr një mandat të dytë.

Po ta përmbledhësh tërë këtë punë titanike do të duhet ta ndash në tre kolona, mësimdhënie në universitete, puna si myfti dhe pjesa tjetër si kryetar komune, por që vetë Ruzhdiu dëshiron ta fokusojë në dy pjesë.

“Dibra e Madhe në harkun historik të kohës, nxori kolosë të mendimit islam dhe patriotë të shquar të çështjes kombëtare. Haxhi Vehbi Dibra, Sherif Lëngu, Muharem Mullai, Haki Sharofi, janë vetëm disa emra nga ajo plejadë e gjatë ulemashë të shquar. Ishte vërtetë privilegj dhe kënaqësi të kishe pararendës të tillë të shquar, por dhe përgjegjësi e madhe për të ruajtur vlera të tilla. Në shumë gjëra puna duhej filluar nga e para. Duhej riorganizuar jeta fetare, rindëruar dhe ndërtuar shumë xhami në qytet, në rajonin e Zhupës, apo të Rekës, që i mbulonte myftinia e Dibrës. Me një organizim të mirëfilltë, u ndërtuan dhe u restauruan mbi pesëdhjetë xhami, të gjitha me kontribut të besimtarëve, në fshat apo qytet, ku ata jetonin. Paralelisht me këtë, u punua fort për përgatitjen e kuadrit fetar që do të shërbente në këto xhami. Rreth 100 nxënës u diplomuan në medrese dhe gjithë kjo armatë e kualifikuar punon sot si kuadër fetar, apo na administratën shtetërore. Nga rindërtimi i xhamive veçojmë xhaminë e “Hinqarit”, të ndëruar në vitin 1456, atë të ‘” Namazjarit “ dhe të Kojnarës”, tregon Lata.

Viti 2012, ishte njëqind vjetori i shpalljes së pavarësisë. Shumë njerëz dhe institucione kishin gjetur mënyra të veçanta për promovimin e kësaj ngjarje të madhe në jetën e shqiptarëve.

“Duke parë xhematin në rritje, ne si myftini, - tregon kryetar Ruzhdiu, - kishim të domosdoshme ndërtimin e një xhamie të re, me kapacitet rreth 600 vendesh. Meqë kjo përkonte në kohë me festën e pavarësisë, ne menduam që murin e gjatë rrethues të xhamisë ta zbukurojmë me 100 dritare, që simbolizonte ngjarjen e madhe”.

Tani ajo thirret shpesh xhamia e 100 dritareve, kurse disa të tjerë e quajn “xhamia e myftiut”. Veç kësaj, xhamia ka dhe një simbolikë tjetër. Krahas minares me një lartësi prej 33 metrash, ngjitur me të ka dhe një sahat kullë po kaq të lartë.

Plot 40 vjet punoi si myfti i Dibrës së Madhe, në kuadër të bashkësisë islame të Maqedonisë. Paralelisht kësaj ishte ligjërues në Fakultetin e Filologjikut në Shkup, pikërisht, aty ku dhe ishte diplomuar, deri në vitin 1991. Serbët i larguan që aty dhe për dy vjet një punë të tillë vazhdoi në Prishtinë, në kushte shumë të vështira. Dy vite të tjera ligjëron si profesor i Shkencave Islame në Shkup dhe tre vite të tjera akoma, në Universitetin shtetëror të Tetovës.



Kur isha në rolin e myftiut, disa njerëz miqësisht më kritikonin se po ndërtoja vetëm xhami. Fati i jetës e deshi që tani të jem në pozicionin e ri të kryetarit të komunës. Nuk e pata fare të vështirë këtë ndryshim kursi. Nga Dibra në Dibër, nga puna me njerëzit tek puna me njerëzit, nga ndërtim xhamish në ndërtim shkollash, rrugësh e fabrikash. Kisha pasur rreth 200 ndërhyrje në pajtime grindjesh, mosmarrëveshjesh, pse jo dhe gjaqesh.

KRYETARI I KOMUNËS

“Kur isha në rolin e myftiut, disa njerëz miqësisht më kritikonin se po ndërtoja vetëm xhami. Fati i jetës e deshi që tani të jem në pozicionin e ri të kryetarit të komunës. Nuk e pata fare të vështirë këtë ndryshim kursi. Nga Dibra në Dibër, nga puna me njerëzit tek puna me njerëzit, nga ndërtim xhamish në ndërtim shkollash, rrugësh e fabrikash. Kisha pasur rreth 200 ndërhyrje në pajtime grindjesh, mosmarrëveshjesh, pse jo dhe gjaqesh. Nuk kishte familje ku nuk kisha pirë të paktën një kafe dhe kjo njohje deri në detaje do të ma lehtësonte mjaft detyrën e re”.

“Në vitin 1888 një hoxhë i njohur, Sait Najdeni, hapi të parën shkollë shqipe në Dibër. Me këtë dëshirë për dijen dhe shkollën do të desha dhe unë tu bëj dhuratë dibranëve një ndërtesë të re për fëmijët e tyre gjimnazistë. Ndërtesa e vjetër ishte tejet e amortizuar, e ngushtë dhe nuk i plotësonte kërkesat në rritje të kohës, aqsa shumë nxënës e bënin mësimin në dy turne. Me një bashkëpunim të jashtëm, me bashkësinë për zhvillim të Turqisë, në vitin 2016, u ndërtua gjimnazi i ri me një sipërfaqe 5400 metra katrore dhe infrastrukturë moderne”.

“Fatmirësisht, punët na ecën mbarë. U ndërtua qendra e qytetit prej 10,000 metrash katrore, e pllakëzuar me gurë natyralë dhe me sistem kanalizimesh të nëndheshme që do vlejnë dhe për shumë kohë më vonë. Bashkë me përfaqësuesit tanë në qeveri, u restaurua rruga Dibër – Strugë, ura e Boshkut, rruga për te llixhat e Banishtit, rruga e Bomovës dhe ka filluar zgjerimi i rrugës nga Dibra tek dogana e Bllatës, si vijimësi e rrugës së Arbërit nga Shqipëria. Bregut të liqenit u ndërtua dhe elektrifikua trotuari për këmbësorët, kurse bashkë me myftininë u ndërtua tregu i ri i qytetit, prej 500 metrash katrore, që do të mbetet si pronë e myftinisë. Nuk ka shumë kohë që në qytetin e vogël ka filluar punë një fabrikë e ujit “Moya”, me një kapacitet prej 18 mijë litrash në orë”.

“Në Dibër funksionon fabrika e gipsit “Knauf”, që prodhon një gamë artikujsh për Maqedoninë, Shqipërinë dhe Kosovën, duke dhënë rregullisht koncesionin për komunën. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm janë dhe llixhat e Banishtit, të marra po me koncesion nga firma “Capa”. Investimet serioze në këtë sektor kanë bërë që ky objekt të jetë me standarte europiane dhe të ketë jo më pak se 100 mijë fjetje në vit”, tregon kryetari Lata.

Por kryetari nuk paska të ndalur në rrugëtimin e tij, për mirëqenien dhe begatinë e Dibrës dhe qytetarëve të saj. Në fushatën e fundit ka dhënë të tjera premtime dhe premtimi deri në kthimin në realitet, për të është vetëm çështje kohe. Ndonëse Dibra ka bollshëm ujë të pijshëm, kryetar Ruzhdiu mendon se duhet një tjetër rezervuar uji me kapacitet 2500 metër kub. Më tej shton se është gati një projekt prej 10 milion eurosh për vaditjen me pika për fushën e Dibrës, nga liqeni pranë.

Përnjëherësh e shkëputa vëmendjen nga biseda me kryetarin. Jo, nuk ishte mungesë edukate, isha i sigurtë për këtë. Mendja më shkoi te Maqellara ime ngjitur me Dibrën, me të njëjtat resurse e pasuri ujore, por shumë larg e krahasuar me fqinjën. Projekte herë të shkatërruara si liqeni i Bllacës e herë të sabotuara, si ai i para pak vitesh për ujin e pijshëm. Ndërkohë e kapa sërish fillin kur kryetari thoshte se ka një bashkëpunim të shkëlqyer me emigrantët në Amerikë, që janë të gatshëm të investojnë në qytetin e tyre. Kemi dhe shumë punë për të bërë, por unë i vetëm nuk ua dal dot. Bashkë me qytetarët që më kanë zgjedhur, bëhemi një forcë e madhe që rrëzon çdo pengesë dhe arrin çdo objektiv. “Të jetosh e të punosh në Dibër, thotë Ruzhdiu, është njësoj si me qenë tërë jetën student, në një universitet të famshëm”.



Një përpjekje e bashkisë Bulqizë për të zgjatur afatin e një leje për hapjen e një rruge që i shërben një koncensioni për shfrytëzim pylli, u kundërshtua nga banorët e zonës dhe solli përplasje të ashpra në Këshillin Bashkiak, ndërsa Bashkia u detyrua të tërhiqej nga kërkesa për të votuar vendimin.

Fshatarët fitojnë betejën kundër koncesionit për shfrytëzimin e pyllit

Nga **Hysen LIKDISHA** / BIRN



Historia e koncesionit fillon në vitin 2015 kur ministria e Mjedisit dha leje për shfrytëzimin e parcelave pyjore pranë fshatrave Koçaj dhe Dushaj. Ashtu si në mjaft koncesione të tjera që kanë të bëjnë me burimet natyrore të zonës, banorët kundërshtuan, duke akuzuar se nuk ishin pyetur dhe se koncesioni prekte burimet e tyre jetësore. Madje ish-kryeplaku i njërit prej fshatrave Qemal Stafa, akuzoi se një shkresë e shkurtit 2015, në të cilën thuhet se komuniteti ishte dakord dhe që ishte nënshkruar prej tij ...

Për gati tre vjet banorët e fshatrave Koçaj dhe Dushaj ia kanë dalë të bllokojnë zbatimin e një koncesioni për shfrytëzimin e një parcele pylli pranë tyre. Madje disa edhe u arrestuan pas protestave dhe kundërshtimit me forcë të koncesionit 10-vjeçarë që i jepte të drejtë kompanive "Almex-Wood" dhe 'Lubima' sh.p.k, për shfrytëzimin e pyllit pranë fshatrave.

Rezistenca e banorëve dhe një vendim i prefekturës së Dibrës në fund të vitit 2015, bllokuan ndërtimin e rrugës që do të shërbente për shfrytëzimin e pyllit, duke djegur afatet e lejes që kompania kishte për ndërtimin e saj.

Por ndërsa banorët iu gëzuan këtij fakti, Bashkia e Bulqizës pas një kërkesë të koncesionarit tentoi në fillim të majit të shtynte afatet e lejes së ndërtimit të rrugës përmes një projekt-vendimi, për të cilin kërkoi miratimin e Këshillit Bashkiak. Si rrallë herë ky i fundit u angazhua në debate që zgjatën disa orë, ndërsa këshilltarët e PS dhe PD akuzuan kryebashkiakun e LSI Melaim Damzi se po "tallej" me këshillin. Pas dy mbledhjesh bashkia, përmes juristit të saj, njoftoi tërheqjen e kërkesa për votimin e projekt-vendimit, duke thënë se këshillit i ishte kërkuar vetëm mendim.

Për banorët bllokimi i ndërtimit të rrugës është një fitore e pjesshme. Të thërritur në mbledhjen e këshillit pas ndërhyrjes së Prefektit të Dibrës Nexhmedin Shehu, një prej tyre akuzoi bashkinë se ndërsa nuk kishte bërë asnjë investim, po përpiqej tu merrte pyllin. "Bashkia nuk na ka bërë asgjë, qoftë edhe një kanal vaditës, tani don edhe të na marrë pyllin, të vetmen gjë që na ka dhënë Zoti, për të jetuar", tha Bajram Disha.

Përballë tyre përfaqësuesi i kompanive që fituan koncesionin Kujtim Korra, u tha këshilltarëve bashkiakë se do të përballeshin me ligjin. "Unë të drejtën time do ta gjej, por kërkoj mirëkuptimin tuaj. Pra ejani të bashkëpunojmë, ndryshe do të përballeni me ligjin, pasi unë me atë kontratë përfaqësoj shtetin", tha Korra i cili pretendon se koncesioni është i ligjshëm dhe se ai do ta shfrytëzojë pyllin për të cilin ka marrë leje.

Historia e koncesionit fillon në vitin 2015 kur ministria e Mjedisit dha leje për shfrytëzimin e parcelave pyjore pranë fshatrave Koçaj dhe Dushaj. Ashtu si në mjaft koncesione të tjera që kanë të bëjnë me burimet natyrore të zonës, banorët kundërshtuan, duke akuzuar se nuk ishin pyetur dhe se koncesioni prekte burimet e tyre jetësore. Madje ish-kryeplaku i njërit prej fshatrave Qemal Stafa, akuzoi se një shkresë e shkurtit 2015, në të cilën thuhet se komuniteti ishte dakord dhe që ishte nënshkruar prej tij ishte falsifikuar. "Në asnjë rast nuk është e firmosur nga unë", tha Stafa duke thënë se kishte kërkuar hetimin e falsifikimit.

Megjithatë kompanitë koncesionare "Almex-Wood" dhe 'Lubima' shpk, tentuan të fillonin punën për ndërtimin e rrugës që do tu mundësonte shfrytëzimin e parcelave. Banorët kundërshtuan me forcë duke u përplasur me kompaninë dhe policinë e cila shoqëroi disa prej tyre.

Pas protestave të banorëve, Partia Demokratike akuzoi se përfituesit e koncesionit kishin lidhje fisnore me funksionarë të lartë të LSI, e cila atëherë kontrollonte Ministrinë e Mjedisit dhe lëshoi lejen vetëm pak kohë para se të hynte në fuqi moratoriumi për pyjet.

Në nëntor 2015, pas një peticioni të 224 familjeve, të cilët pohonin se nuk ishin dakord me shfrytëzimin e pyjeve nga koncesionari, me pretendimin se një gjë e tillë sjell për ta dëme të mëdha mjedisore dhe u rrezikon furnizimi me ujë të pijshëm, vaditës dhe lëndën drusore, prefektura e Dibrës urdhëroi "pezullimin e punimeve për hapjen e rrugës auto-pyjore. Kompania kundërshtoi vendimin e prefektit si të jashtëligjshëm, por puna për hapjen e rrugës u bllokua.

Banorët thonë se rezistuan edhe pse gjatë gjithë kohës ishin nën presion. "Na është bërë presion nga policia, askush nuk na ka mbrojtur. Firma është munduar të futet fshehtas në pyjet tona", tha Bajram Disha. Bllokimi i ndërtimit të rrugës e bllokoi koncesionarin, i cili po ashtu humbi edhe afatet e parashikuara në leje për ndërtimin e saj.

Por në fillim të majit Bashkia e Bulqizës u përpoq t'i shtynte afatet për ndërtimin e rrugës përmes një vendimi të cilin kërkoi ta votonte në Këshillin Bashkiak. Vendimi bazohej në një ankesë të koncesionarit i cili i kërkonte bashkisë që të ndërmjetësonte me banorët për të mirat e koncesionit. "Të punojë me komunitetin, për t'i bindur ata në të mirat që do të kenë nga zbatimi i kësaj kontrate koncensionare", thuhej në kërkesën që kompanitë i dërguan bashkisë.

Duke i renditur disa arsye si pengesa për zbatimin e koncesionit, koncesionari kërkoi nga bashkia Bulqizë, shtyrjen e afatit të hapjes së rrugës deri më 19 shtator 2018. Mbi bazën e kësaj kërkese bashkia Bulqizë hartoi një projekt-vendim të cilin ia përcolli për miratim këshillit bashkiak me objekt: " Për miratimin e kërkesës së Shoqërisë Almex-Ëood, K. Korra dhe Lubima-shpk, për shtyrjen e afatit të hapjes së rrugës auto-pyjore, të cilën e ka të miratuar në kontratën koncesionare nga ish Ministria e Mjedisit me kontratë nr. 3687 prot. datë 25.05.2015".

Por projekt-vendimi solli debate të ashpra në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dhe pas disa orë debatesh bashkia nuk siguroi dot votat për ta kaluar atë. Vendimi u la të diskutohej në një mbledhje të dytë, por këtë herë me kërkesë të Prefektit të Qarkut Dibër Nexhmedin Shehu, u kërkua që të pranishëm të ishte edhe një përfaqësi nga banorët e fshatrave.

Pas kësaj përfaqësuesi i bashkisë në mbledhje, juristi Denis Zholi, kërkoi tërheqjen e bashkisë nga ky projekt-vendim. Sipas tij këshilli nuk kishte kompetencë, për zgjatjen e afatit të kontratës koncensionare. "Bashkia kërkon të miratohet ndërtimi i kësaj rruge, por nuk kërkojmë vendim-marrje nga këshilli, pasi nuk është kompetencë e tij, zgjatja e afatit të kontratës koncesionare. Nuk kërkojmë vendimmarrje, por vetëm opinione të këshilltarëve", tha Zholi.

Qëndrimi i ri i bashkisë solli reagim të këshilltarëve të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. Munir Sinani, kreu i grupit të këshilltarëve socialistë, tha se këshilli nuk ishte për të dhënë opinione, por për të miratuar vendime. "Kryetari Damzi, bëri lobing një javë më parë, për të miratuar një projekt-ligj të jashtligjshëm. Mosmarrveshjet dhe konfliktet mes banorëve dhe koncensionarit të zgjidhen nga institucionet dhe gjykata", tha Sinani. Këshilltarët e djathtë, Ardian Hida dhe Edmond Isaku, akuzuan kryebashkiakun Damzi, se ishte tallur dhe po luante ping-pong me këshillin, "duke sjellë në këshill për miratim ligje paçavure".

Nga ana e saj kompania koncesionare tha se nuk do të hiqte dorë. Kujtim Korra, përfaqësuesi i firmës koncensionare, i cili po ashtu ishte pjesmarrës në këtë mbledhje të këshillit bashkiak, tha se kompania do e "gjente të drejtën e saj". "Unë disponoj një leje për shfrytëzimin e pyllit dhe ju garantoj se do ta shfrytëzoj atë konform të gjitha rregullave", tha ai. Kompania po ashtu pretendoi se i ishte shkaktuar ndër të tjera dëm 100 mijë euro nga djegia e një makinerie gjhatë protestave.

Banorët që ishin të pranishëm kundërshtuan përpjekjen e bashkisë për të shtyrë afatet e lejes, ndërsa thanë se do ta kundërshtonin me çdo kusht koncesionin. "Firma e përkrahur nga bashkia e policia, kërkon ta bëjë edhe këtë parcelë pyjore për ta mbjellë thekër, siç dhe janë bërë parcelat e tjera rrotull saj. Pavarësisht presioneve, me ma heq kokën, pyllin do vazhdoj ta ruaj" tha Pëllumb Xhaferri, një banor i fshatrave që preken. Banorët thanë se parcela që ata po mbronin ishte e vetmja e ruajtur në zonë dhe se jeta e tyre varej nga pylli pranë fshatit.



Rruga e Arbërit nr. 145

vëzhgim

Katër bashkitë e qarkut Dibër japin vetëm disa thërrime nga buxhetet e tyre për mirëmbajtjen, rikonstruksionin, ose ndërtimin e ambienteve arsimore, duke mbajtur sytë nga qeveria për ndonjë financim të mundshëm.

Bashkitë e Qarkut të Dibrës harrojnë rikonstruksionin e shkollave

Nga **Dritan KURTI**

Katër bashkitë e qarkut Dibër japin vetëm disa thërrime nga buxhetet e tyre për mirëmbajtjen, rikonstruksionin, ose ndërtimin e ambienteve arsimore, duke mbajtur sytë nga qeveria për ndonjë financim të mundshëm. Ndërsa shkollat në këto bashki rrënohen dhe bëhen më të pasigurta nga dita në ditë për fëmijët, sidomos në zonat rurale dhe të thella, buxhetet e bashkive tkurren dhe më shumë.

Pjesa dërmuese e tyre janë ndërtuar shumë dekada më parë. Në shumë shkolla; tarracat, çatitë dhe muret janë pothuajse drejt shembjes, sidomos në zonat e thella malore, ku ka pasur jo pak raste rreziku serioz për nxënësit dhe mësuesit. Mungesa e elektricitetit është një problem i vjetër, pasi instalimet kanë dalë jashtë funksionit. Dyert e brendshme të këtyre godinave arsimore janë gjysmake, duke mundësuar që i ftohti të depërtojë lirshëm. Tavolinat dhe stolat po ashtu datojnë prej 3 dekadash, duke u kthyer në aspak komode për qëndrimin e nxënësve, ku hera-herës grisin edhe rrobat. Godinat e arsimit 9-vjeçar dhe atij të mesëm kanë mungesë të theksuar të laboratorëve të kimisë e fizikës.

Në Bashkinë Dibër, ndër shkollat më problematike është ajo e fshatit Fushë-Aliaj në njësinë Administrative Fushë-Çidhën me 68 nxënës. Në këtë shkollë prej pesë vitesh ka mungesë të energjisë elektrike, tualetet nuk funksionojnë dhe ujë të pijshëm nuk ka, për pak metra tub, i cili ka mbetur pa u lidhur me tubacionin e brendshëm të shkollës. Drejtori i kësaj shkolle, Haki Përnezha tha për Portën Vendore, që të gjitha shqetësimet janë ngritur pranë Bashkisë së Dibrës, por deri tani asnjëri nga problemet nuk është zgjidhur. "Ne kemi bërë shkresa të vazhdueshme ndaj bashkisë, por gjithmonë na është thënë që do të ndërhyjnë, ndërsa deri tani nuk e kanë bërë. Është mëkat që një shkollë e ndërtuar para dhjetë viteve, të mos ketë funksionet minimale për mësimdhënie" – tha Përnezha. "Sa herë kemi nevoja personale shkojmë tek tualeti i kësaj familjes që kemi pranë shkollës, pasi tualetet brenda shkolle janë të ndotura dhe nuk mund të rrezikojmë nga ndonjë infeksion i mundshëm", tregon S. P., nxënës i shkollës 9-vjeçare Fushë-Aliaj.

Kryetari i Bashkisë Dibër, Muharrem Rama, thotë se të ardhurat vendore nuk mjaftojnë



Muret e shkatërruar në shkollën Fushë-Aliaj, Dibër. Foto: Dritan Kurti

për të mbuluar të gjitha nevojat e godinave arsimore. "Investimi më i madh që mund të bëjmë neve në godinat e arsimit është që të hidro-izolojmë tarracat, por shumë shkolla kanë edhe probleme shtesë që kërkojnë një fond të konsiderueshëm. Aktualisht ne kemi të depozituara disa projekte në ministrinë e linjës që presim të na financohen" – tha mes të tjerash Kryebashkiaku Rama.

Mbi 90% e godinave arsimore në Qarkun e Dibrës kanë sistem ngrohje me dru zjarri. Vetëm disa shkolla në zonat urbane përdorin kaldajën, që në shumë raste ka qenë jofunksionale apo është kthyer në një rrezik për nxënësit.

Në raportin e dhjetor 2017, për cilësinë e godinave shkollore në Bashkinë Dibër, KLSH evidentoi mungesën e strategjisë për godinat shkollore parauniversitare; mungesën e studimeve për ndërtimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e godinave shkollore parauniversitare; si dhe hartimin e projekteve jocilësore në ndërtimin dhe rikonstruksione e objekteve arsimore.

Raporti KLSH http://www.klsh.org.al/web/208_vendimi_cilesia_e_godinave_shkollore_3784.pdf

Në Bashkinë e Bulqizës, një tjetër shkollë me gjendje alarmante mbetet edhe ajo e fshatit Strikçan.

73 nxënës të shkollës 9-vjeçare "Hajrulla Tollja" në fshatin Strikçan të njësisë administrative Zerqan në Bashkinë e Bulqizës e zhvillojnë procesin mësimor në kushte skandaloze. Godina e kësaj shkolle është drejt rrënimit total, pasi ka pësuar dëmtime të mëdha në të gjitha klasat. Tavanet janë shembur në disa klasa, ndërsa në disa të tjera shembja mund të ndodh nga dita në ditë. Po ashtu, çatia rrjedh ujë sa herë ka reshje shiu.

Drejtori i kësaj shkolle, Mustafa Haxhiu thotë se kushtet janë vërtetë të këqija. Sipas tij, problemi i çatisë mbetet emergjent pasi rrezikon jetën e nxënësve. "Bashkia ka ndërhyrë një vit më parë, por godina është shumë e amortizuar, ndaj problemet janë rishfaqur. Nëse nuk rregullohet nga fillimi, atëherë problemet do të vazhdojnë. Ne ia kemi paraqitur disa herë shqetësimin Bashkisë Bulqizë dhe na është premtuar që do të ndërhyhet përsëri edhe këtë vit" – tha Haxhiu. Por për prindërit e nxënësve të kësaj shkolle, fëmijët e tyre po rrezikojnë jetën në këto kushte. Ata paralajmërojnë që nëse situata nuk do të zgjidhet për vitin e ardhshëm shkollor, ata do t'i lënë fëmijët pa shkollë. "Ne jemi me mendjen te fëmijët kur janë në shkollë, pasi nuk e dimë nëse do ta mbarojnë të gjallë ditën e mësimit. Ju e patë edhe vetë si janë kushtet aty. Është turp që në vitin 2018 të jenë këto kushte skandaloze, është turp të luhet me jetën e fëmijëve tanë" – tha Selim Isufi, prind i dy nxënësve të klasës së pestë në shkollën "Hajrulla Tollja".

Në Bashkinë e Klosit, ka pasur probleme në shkolla nga mosfunksionimi i sistemeve të kaldajës, ku është rikthyer ngrohja me dru zjarri, siç është rasti i shkollës 9-vjeçare "Tahir Hoxha" në qytet.

Përgjegjësi i Arsimit në Bashkinë Klos, Ramazan Mjeshtri thotë se sistemi i kaldajës ka funksionuar shumë pak sepse ka pasur bllokim të tubacioneve përcjellëse. Ky problem ka nisur pak kohë pasi ka përfunduar rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Tahir Hoxha", Klos në vitin 2007. "Unë kam qenë pjesë e arsimit më parë, por edhe si ish kryetar bashkie dhe sot si përgjegjës Arsimi në Bashkinë Klos, e di shumë mirë se si qëndron problemi. Kaldaja që u vendos pas rikonstruksionit të shkollës funksionoi për pak kohë dhe më pas doli jashtë funksionit. Pas shumë përpjekjesh për ta riparuar, kostoja ishte tepër e lartë kështu që ne u detyruam që të rikthejmë sistemin e ngrohjes me dru zjarri, duke rihapur oxhaqet. Bashkia nuk i ka kapacitetet ekonomike për ta ribërë kaldajën, prandaj do të vazhdojë me këtë sistem" – tha Mjeshtri për "Porta Vendore". Në Bashkinë e Klosit mbetet urgjente edhe gjendja e gjimnazit "Shaban Çollaku", i cili ka nevojë për një rikonstruksion total që kap vlerën e 160 milionë lekëve të reja, fond i cili nuk mund të përballohet nga buxheti i Bashkisë Klos, ku kjo e fundit ka kërkuar financim nga qeveria.

Në Burrel gjimnazi "Pjetër Budi" ka pasur probleme herë pas here të sistemit të kaldajës. Përdorimi i druve të zjarrit në godina arsimore nuk është aspak komod për shkak të tymit që lëshohet nga djegia e druve gjatë orës së mësimit. Qarku Dibër ka klimë të ndryshueshme dhe temperaturat gjatë dimrit shkojnë disa gradë nën zero ndaj dhe ngrohja është e domosdoshme që nga nëntori e deri në fund të marsit.

Në Bashkinë e Matit, problem emergjent janë edhe shkollat "Ali Xhetani" Zenisht (NJA Lis) dhe ajo 9-vjeçare "Rexhep Kërtuka", e fshatit Frankth, (NJA Komsi). Shkolla 9-vjeçare "Ali Xhetani" në fshatin Zenisht të Njësisë Administrative Lis në Bashkinë e Matit, prej një viti është pothuajse pa furnizim me ujë të pijshëm, çka bën që problemi të shtrihet edhe në higjienën e saj. Nxënësit dhe stafi pedagogjik i kësaj shkolle furnizohen me ujë të pijshëm nga familjarët apo bizneset afër shkollës. Një tjetër problem madhor në këtë shkollë është edhe mosfunksionimi i shkarkuesve të ujërave të zeza. Drejtoresha e Shkollës, Bijane Mata, thotë se prej pesë vitesh që kur është rikonstruktuar rruga Shoshaj – Urakë dhe është ndërtuar ura e re poshtë shkollës, tubacionet shkarkuese nuk kanë funksionuar, duke bërë që ujërat e zeza të dalin në sipërfaqe herë pas here në oborrin e shkollës. "Ne kemi kërkuar vazhdimisht ndërhyrje, por nuk kemi gjetur zgjidhje deri tani. Gjithmonë na është premtuar që do të ndërhyhet sot e do të ndërhyhet nesër, por askush nuk e ka marrë mundimin ta bëjë një gjë të tillë" – tha Mata. Janë rreth 150 nxënës e mësues në këtë shkollë që përballen prej kaq kohësh me mungesën e ujit të pijshëm dhe mosfunksionimin e shkarkuesve të ujërave të zeza.

Një pjesë e godinës arsimore në Frankth është drejt rrënimit total, duke rrezikuar jetën e 27 fëmijëve parashkollorë. Për këtë drejtoresha e shkollës 9-vjeçare "Rexhep Kërtuka" të fshatit Frankth Miranda Bruçi, tha se është e rrezikshme që fëmijët të futen në këto ambiente, pasi ka çarje kudo në tavane, mure e dysheme. Për këtë drejtoresha Miranda Bruçi tha se është vënë në dijeni pushteti vendor, i cili megjithëse ka thënë

Pjesa dërmuese e tyre janë ndërtuar shumë dekada më parë. Në shumë shkolla; tarracat, çatitë dhe muret janë pothuajse drejt shembjes, sidomos në zonat e thella malore, ku ka pasur jo pak raste rreziku serioz për nxënësit dhe mësuesit. Mungesa e elektricitetit është një problem i vjetër, pasi instalimet kanë dalë jashtë funksionit.



Klasat jo funksionale në shkollën Hajrulla Tollja. Foto: Dritan Kurti

Për disa nga shkollat e lartpërmendura, kryetarët e bashkive, thanë se kanë dërguar projektet në Ministrinë e Arsimit për të gjetur financim pasi rikonstruksioni total i tyre është i papërballueshëm për buxhetet e bashkive të tyre.



Gjendja e mjerueshme e shkollës 9 vjeçare Hajrulla Tollja, Bulqizë. Foto: Dritan Kurti



Shkolla 4: Shkarkuesit e ujëra të zeza pranë shkollës "Ali Xhetani" Mat. Foto: Dritan Kurti



Shkolla 5: Muri i plasaritur i shkollës 9 vjeçare "Rexhep Kërtuka". Foto: Dritan Kurti

që do të ndërhyjë, nuk ka bërë asgjë deri më sot. "Është shumë e rrezikshme që fëmijët të mësojnë në këto kushte ndaj dhe ne i kemi zhvendosur në ambjente të tjera po brenda shkollës. Nëse bashkia nuk ndërhyn, atëherë do të jetë e pamundur që të vijohet mësimi" – tha Bruçi.

Në një raport për tremujorin e parë të 2018-tës, realizuar për bashkitë Mat dhe Klos, që "Porta Vendore" e disponon, Nënprefektura e Matit ka dalë në përfundimin se ; 10 shkolla kanë nevojë për ndërhyrje emergjente në këto dy bashki, si dhe duhet të menaxhohet më mirë çështja e transportit të fëmijëve në shkollë, me furgonë.

Përgjegjësja e Zyrës së Financës në Bashkinë Mat, Dea Kaziu thotë se planifikimi vjetor bëhet në një total për të gjitha shërbimet ndaj godinave arsimore. "Duke qenë se bashkia nuk ka fonde të mëdha për të bërë ndërhyrje të konsiderueshme siç është rikonstruksioni, atëherë ne përqendrohemi tek problemet më emergjente dhe me kosto të vogël. Në fakt është drejtoria e Shërbimeve ajo që evidenton problematikat në çdo fillim viti. Psh, një shkollë mund të ketë nevojë për zëvendësimin e pesë xhamave, dy dyerve, një portollambë apo një rubineti, ne nuk mund të ndajmë një fond të veçantë, por grumbullojmë të gjitha nevojat për çdo shkollë në bazë të një preventivi dhe më pas tenderojmë blerjen. Ndërhyrja në shkolla qoftë për lyerjet, apo riparimet e tjera nuk bëhet me kontraktor, por nëpërmjet punonjësve të drejtorisë së shërbimeve. Vitin e kaluar, vlera e parashikuar dhe e shpenzuar ishte 3100 000 lekë të reja. Kjo shumë normalisht që është e pamjaftueshme për 41 godinat arsimore që ka bashkia jonë, por këto janë kapacitet tona – tha Kaziu për Portën Vendore.

Investimet në shkolla

Vetëm një shkollë e re është ndërtuar gjatë këtyre dy viteve në Qarkun Dibër, bëhet fjalë për gjimnazin e Maqellarës me një fond prej 33 milionë e 505 mijë lekëve të reja, financuar nga AZHR. Ndërsa rikonstruksion total i janë bërë 3 shkollave në Qarkun Dibër, përkatësisht në Shupenzë të Bulqizës me fond rreth 86,878,744 lekë, shkolla 9-vjeçare e Fshatit Bejnë në Bashkinë e Klosit me një fond prej 61,443,512 lekë financuar nga AZHR dhe ajo "31 Korriku" e qytetit të Burrelit në Bashkinë e Matit me një fond prej 61,819,330 lekë financuar nga AZHR.

Por, sa janë buxhetet e planifikuara nga katër Bashkitë e Qarkut Dibër për vitin 2018. Nga të dhënat zyrtare të marra nga zyrat e financave në të katër bashkitë, rezulton që buxheti i planifikuar për sektorin e arsimit është shumë i vogël. Buxheti mund të mjaftojë vetëm për pak riparime në një periudhë 9 mujore, aq sa zgjat edhe viti shkollor. Me këto buxhete, bashkitë blejnë vetëm bazën materiale, ndërsa punimet i kryejnë nëpërmjet ndërmarrjeve të tyre.

Për disa nga shkollat e lartpërmendura, kryetarët e bashkive, thanë se kanë dërguar projektet në Ministrinë e Arsimit për të gjetur financim pasi rikonstruksioni total i tyre është i papërballueshëm për buxhetet e bashkive të tyre.

Bashkia Dibër ka planifikuar në buxhetin e këtij vitit për mirëmbajtje të godinave arsimore 14.370.740 lekë. Ndërkohë numri i godinave në administrimin e Bashkisë është 109 në total. Në një përllogaritje i bie që për një godinë të jenë afërsisht 131 mijë e 841 lekë. Me këtë shumë, bashkitë do të bëjnë riparimin e dyerve, dritareve, llambave të ndriçimit, çelësave, prizave, blerjen e bojës për lyerjen e korridoreve, sigurimin e detergjenteve larës, si dhe blerjen e karburantit për ato shkolla që janë me sistem kaldaje. Kujtojmë që një vit më parë, të gjithë bashkitë e Qarkut Dibër kanë krijuar brigada që merren me prodhimin e druve të zjarrit. Ndërsa lyerjet e objekteve arsimore i bëjnë me anë të ndërmarrjeve të shërbimeve, ndryshe nga sa ndodhte më parë që bëheshin me tenderime. Vitin e kaluar buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mirëmbajtjen e godinave arsimore në këtë bashki, ishte rreth 12 milionë lekë të reja.

Bashkia Bulqizë ka planifikuar për këtë vit 4.000.000 lekë dhe ka për mirëmbajtje 58 godina arsimore. Për secilën godinë buxheti për një vit arsimor është planifikuar një fond prej 68 965 lekë. Ndërsa fondi i parashikuar dhe i shpenzuar për vitin e kaluar ishte 5 milionë e 800 mijë lekë të reja, (ose 100 mijë lekë të rinj për çdo godinë arsimore). Të gjitha këto para thonë zyrtarët e Bashkisë Bulqizë kanë shkuar për përmirësimin e kushteve të nxënësve gjatë procesit mësimdhënës. Bashkia Klos, ndonëse numrin e godinave arsimore e ka më të vogël se bashkitë e tjera, sërish mesatarja për një godinë për mirëmbajtje është pothuajse në të njëjtën vlerë. Buxheti i planifikuar për vitin 2018 për mirëmbajtjen e godinave arsimore është 3.111.556 lekë, ndërsa numri i godinave është 34. Mesatarisht për një godinë arsimore janë parashikuar 91 516 lekë në një vit shkollor.

Bashkia Mat, ka një fond të planifikuar për këtë vit 3.600.000 lekë, për 41 godina arsimore. Afërsisht për një godinë arsimore janë lënë 87 804 lekë. Specialistët thotë se bashkitë duhet të gjejnë një mënyrë që të zgjidhin përfundimisht problematikat fizike të godinave. Ata propozojnë që të ndërhyhet në mënyrë të plotë çdo vit, të paktën në një shkollë, në mënyrë që vitin pasardhës të kenë një problem më pak. "Mendoj që pushteti vendor duhet të ndërhyjë në shkollat që kanë probleme të mëdha që t'i zgjidhin përfundimisht. Duhet të rikonstruktojnë të paktën një shkollë çdo vit në mënyrë që dalëngadalë të shkohet drejt një zgjidhjeje përfundimtare. Unë dikur kam qenë mësues dhe punonjës në Zyrën Arsimore dhe e di çdo të thotë të punosh apo të mësosh në kushte jo optimale" – tha Nerim Palluçi, ish Shef Kuadri në Zyrën Arsimore Mat.

* *Titulli është i redaksisë.* Titulli në *portavendore.al:* Bashkitë e Dibrës harrojnë "etjen" e shkollave për rikonstruksion

(Marrë nga portavendore.al)

Shkolla 9-vjeçare "**Katund i ri**" në **Dibër**, me kabinet të ri informatike

Ambasadori i OSBE në Shqipëri, Bernd Borchandt, i shoqëruar nga kryetari i bashkisë Dibër Muharem Rama, nga deputetë të qarkut Dibër, nga Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehi, si dhe nga drejtuesit e DAR Dibër, inauguruan një kabinet informatike me të gjitha pajisjet e nevojshme në shkollën 9-vjeçare "Katund i Ri".

Në fjalën e tij, Borchandt përshëndeti organizuesit e aktivitetit në nder të tij, dhe theksoi që në të ardhmen OSBE do të financojë edhe projekte të tjera në shkollat e Dibrës, dhe jo vetëm.

Kryetari i bashkisë, Muharem Rama, shprehu falenderimet e tij për ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri për kontributin e dhënë për këtë shkollë, duke e ftuar këtë të fundit që ta ketë në vëmendje Dibrën për financime të mëtejshme në institucionet arsimore, pasi Dibra është krahinë arsimdashëse.

Ky aktivitet u parapri nga një takim i Borchandt me kryetarin e bashkisë Rama në zyrën e këtij të fundit, ku u fol dhe diskutua mbi implementimin e reformës territoriale, gjendjen ekonomike dhe sociale, si dhe për iniciativat e ndërmarra nga bashkia në fushën e sigurisë publike.

E.Çaushi/ATSH



Çfarë vendi i mrekullueshëm. Kisha lexuar se zona ku ndodheshim ishte akoma shtëpia e arinjve të murrmë, rrëqebujve, ujqërve, kunadheve dhe kapronjve, po për fat të keq nuk pashë asnjë prej tyre. M'u kujtua shprehja e poetit të famshëm Gjergj Fishta (1871-1940): "Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë".

Nga **Peshkopia** në Fushë Lurë, rrugës nga **Grykë Noka**

187 kilometra nga Tirana dhe vetëm 20 kilometra nga kufiri me Maqedoninë, Peshkopia është qyteti kryesor i rrethit dhe qarkut Dibër. Kisha lexuar pak mbi historinë e qytetit, aq sa të dija se banorët e parë ishin vendosur që në kohët para Krishterimit. Ndërsa qëndroja në dhomën time në një hotel të thjeshtë, dëshiroja aq shumë t'u tregoja të gjithëve që dinë aq pak mbi Shqipërinë se ajo ka kulturën më të lashtë dhe më të mrekullueshme në Evropë.

Nga **Mark D. VICKERS** *



Kisha ikur për disa ditë nga Tirana për të eksploruar një pjesë të Shqipërisë që ende nuk e kisha vizituar. Kështu që u nisa nga Peshkopia për në Fushë Lurë.

Kjo zonë e vendit është padyshim e mrekullueshme, por unë nuk po udhëtoja si turist dhe, meqë kisha kohë të kufizuar, nuk mund të qëndroja askund për shumë gjatë.

Duhet ta them që në fillim se kjo histori ka ndodhur në një kohë kur shumë pak të huaj vizitonin zonat e largëta të Shqipërisë, por gjithashtu duhet të them që personalisht nuk u ndjeva kurrë i kërcënuar dhe nuk pata probleme. Ndoshta ngaqë unë në atë kohë e flisja mjaft mirë shqipen dhe kisha mësuar shumë mbi zakonet e zonës apo thjesht sepse pata fat, unë nuk e di me siguri. Mund të ishte edhe kombinim i këtyre faktorëve, por të them të drejtën në çdo vend që kam vizituar, të huajt kanë tendencën të ekzagjerojnë rreziqet dhe të fokusohen tek negativet, ndoshta për ta bërë veten të duken më interesantë. Nuk po sugjeroj që nuk kishte ose s'ka rreziqe në disa vende, por jam i sigurt që ato rreziqe zmadhohen kur udhëton me një ndjesi të pabazë vetëbesimi të tepërt, që lehtë mund të ngatërrohet ose të kthehet në pompozitet. Pikëpamja ime ishte ajo e një të huaji në një vend të huaj, prandaj ishte në dorën time të vëzhgoja dhe të mësoja sa më shumë, dhe jo anasjellas. Gjithsesi, mikpritja shqiptare më habiti përsëri e përsëri dhe më afroi në kthetrat e shqiponjës mirëpritëse, e cila më mbrojti e më udhëzoi në udhëtimet e mia.

U mrekullova nga dhe u dashurova me Shqipërinë aq shumë, saqë dalëngadalë fillova të ndjehesha sikur edhe unë kisha pak gjak shqiptari! Kjo ndjesi filloi që në muajin e parë që ndenja në Shkodër, ku u ndjeva si në shtëpinë time, dhe sa më shumë mësoja mbi traditat dhe vlerat e njerëzve shqiptarë, aq më shumë rritej ajo. Këto vlera janë shumë më të vlefshme se shtrembërimet moderne, të cilat e kthejnë bukurinë origjinale në kriminalitet që do të neveriste heronjtë e vërtetë të Shqipërisë.

Gjithsesi, po dal nga tema. Në atë kohë, harta të sakta ishte e vështirë të gjeje. Unë e kisha një, por i mungonin detajet që më duheshin për udhëtimet e mia, prandaj më duhej të përdorja një hartë të vjetër të ushtrisë shqiptare që kisha gjetur. Do të doja të kisha qëndruar më gjatë në Peshkopi, më vjen të psherëtij kur takoj turistë që e shikojnë për maksimumi një dite një vend dhe mendojnë se janë bërë eskpertë të zonës, si një gjeneral që shikon vetëm ç'i tregon oficeri dhe beson se morali është i lartë dhe gjithçka është në rregull, në prag të kryengritjes! - Por për fat të keq nuk munda. Në Peshkopi ndenja vetëm një natë.

187 kilometra nga Tirana dhe vetëm 20 kilometra nga kufiri me Maqedoninë, Peshkopia është qyteti kryesor i rrethit dhe qarkut Dibër. Kisha lexuar pak mbi historinë e qytetit, aq sa të dija se banorët e parë ishin vendosur që në kohët para Krishterimit. Ndërsa qëndroja në dhomën time në një hotel të thjeshtë, dëshiroja aq shumë t'u tregoja të gjithëve që dinë aq pak mbi Shqipërinë, se ajo ka kulturën më të lashtë dhe më të mrekullueshme në Evropë.

Jo shumë qartazi kujtoja se Peshkopia dukej edhe në hartat e shekullit të njëmbëdhjetë. Pas zgjerimit osman përmes Shqipërisë, Peshkopia ishte pothuajse e tëra myslimane në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, pavarësisht historisë së krishterë të qytetit, e cila ishte e mirëregjistruar edhe në shekullin e 11-të. Turqit ndërtuan një kazermë në vitin 1873. Më 1910 qyteti ishte aktiv në kryengritjen ndaj turqve dhe, duke kërkuar pavarësinë, qyteti u çlirua më 16 gusht 1912. Por, sië ndodhi edhe në vende të tjera të Shqipërisë, në vend që të ishin duke luftuar turqit me shtetet e tjera ballkanike si aleatë, Serbia dhe shtete të tjera donin ta shkatërronin shtetin dhe popullin shqiptar, dhe në dhjetor 1912 serbët e pushtuan Peshkopinë. Shqiptarët e rimorën qytetin më 20 shtator 1913, por bullgarët e pushtuan në janar të 1916-ës. Banorët rezistuan aq sa mundën, edhe pse kishin vuajtur në betejat kundër turqve dhe serbëve.

Por, ky nuk ishte ende fundi. Austro-hungarezët, si aleatë të bullgarëve, vendosën t'i dënojnë banorët për rezistencën ndaj aleatëve të tyre. Shtëpitë u dogjën dhe shumë dibranë u ekzekutuan, sepse u rezistuan pushtuesve. Në fund të Luftës së Parë Botërore, austro-hungarezët u larguan si humbës të luftës.

Më 1939 italianët pushtuan Shqipërinë, morën kontrollin e Peshkopisë në prill dhe qëndruan aty derisa u larguan nga Boshti më 1943, kur partizanët shqiptarë e rimorën Peshkopinë. Ende Peshkopia nuk ishte në paqe, sepse partizanët luftonin me forcat e Ballit Kombëtar dhe në korrik 1944 forcat gjermane u vendosën në qytet, por u larguan brenda muajit. Ende vazhdonin betejat, derisa zona u dominua nga Ushtria Nacionalçlirimtare dhe më pas erdhën 45 vite komunizmi të ashpër.

Do të doja të kisha shpenzuar më shumë kohë në një vend kaq të mrekullueshëm, të shikoja e të mësoja rreth këtyre banorëve dhe historisë së tyre, duhej të qëndroja shumë më shumë se disa netë, edhe nëse mundesha ta zgjasja qëndrimin tim larg Tiranës. Besoj se nuk është ide e mirë të injorohet historia, por as nuk duhet të studiohet në një zyrë të kondicionuar, pa rrezikuar rezultate të çuditshme ose të pakuptimta. Historia duhet të merret në kontekst gjeografik, me të tëra aspektet kulturore dhe kohore. Sigurisht, historianët më të mirë e bëjnë këtë, por thjesht dua të them që pa qëndruar një kohë të caktuar me banorët e një vendi, nuk mund ta kuptosh ndikimin e historisë te ta sot.



Për fat të keq, unë kisha kohë të limituar dhe shumë vende për të vizituar. Doja të vizitoja Fushë Lurën. Më kishin dhënë emrin e një doktori aty, i cili mund të më gjente një shtëpi për të kaluar natën. Ai po më priste, ndaj pas një mëngjesi të thjeshtë, por të mjaftueshëm, u rinisa.

E kisha studiuar hartën time dhe kisha gjetur një rrugë interesante. Gjithcka po shkonte mirë dhe unë po e shijoja shumë peizazhin. Pas disa kohe, rruga e ngushtë ndahej në dysh, gjë që nuk tregohej në hartën time të vjetër. Një grup të rinjsh po qëndronin aty, duke bërë çfarë vetëm një Zot e di. S'kishte gjë tjetër aty, përveçse dy rrugë, pothuajse rrugica. Asistenti im po i jepte makinës në atë kohë dhe unë i thashë të ndalonte. Ai ishte shumë më nervoz se unë mbi historitë e rreziqeve në këto anë dhe, pasi u sigurua mbi çfarë i kërkova, ai e ndaloi makinën pa shumë dëshirë. I thirra të rinjtë dhe ata erdhën me buzëqeshje të madhe. Pasi u takuam, i pyeta se nga i binte Grykë Noka.

Të gjithë më treguan njërën prej rrugëve dhe ne direkt u nisëm në drejtimin e disa shtëpive guri, disa qindra metra larg. Asistentit im dukej i tensionuar, prandaj nuk e shqetësova, duke i thënë se djemtë po qeshnin me të madhe, ndërsa ne u larguam, sepse nuk doja ta stresoja edhe më shumë.

Rruga deri në një pikë ishtë si në hartën time, por pas shtëpisë së parë, m'u në mes të rrugës, gjendej një pirg masiv drurësh. Ishtë e pamundur të kalonim. Prandaj po qeshnin ata djemtë?! Nuk kishte as rrugë për të kthyer makinën pa kaluar në tokën e shtëpisë përbri, dhe unë s'doja ta bëja këtë gjë pa marrë leje, prandaj qëndruam disa minuta aty duke parë hartën. Sipas hartës, ishte edhe një rrugë tjetër për në Fushë Lurë përmes maleve, por dukej sikur në një pikë bëhej e pakalueshme për makinat. Nuk m'u desh shumë kohë të kuptoja se në këtë rrugë që ishim, nuk mund të vazhdonim.

Ndërsa po mendoja se si mund të kthenim makinën, pronari i shtëpisë u afrua dhe na takoi. I shpjegova se ku doja të shkoja dhe nga vija dhe ai na tha që, sigurisht mund të ktheheshim në tokën e tij, por në fillim duhej ta lejonim të na jepte disa meze për rrugën. Ja ku ishim, në Grykë Nokë, pa ditur nga do të shkonim për të arritur në destinacionin tonë dhe të ftuar plot ngrohtësi në shtëpinë e një të huaji-- përsëri mikpritja shqiptare po ma ngrohte zemrën. Para se ta kuptoja ç'po ndodhte, tre gjenerata të familjes së tij po na ofronin kafe, fruta dhe raki. Kisha sjellë disa lloje të tjera frutash nga Tirana, ndaj i thashë asistentit të sillte pak dhe e ndamë me familjen, duke pushuar gëzueshëm me ta. Duke folur me të zotin e shtëpisë, mora vesh se rruga në hartën time ishte në të vërtetë shumë më e mirë se ç'dukej në hartë dhe kishte për të më dërguar drejt Fushë Lurës. Pas disa fotosh, u futëm në makinë dhe u kthyem nga kishim ardhur.

Ja ku ishin adoleshentët, duke qeshur ndërsa na shikonin neve duke u kthyer. I thashë asistentit tim të ndalonte. Ai ishte

udhëtimi

Ushqimi ishte i këndshëm dhe rakia rridhte lirisht. Natyrisht, më duhej të largohesha në pikë të mëngjesit dhe më duhej dikush që t'i jepte makinës. Edhe njëherë mikpritja shqiptare më mrekulloi. Dy të huaj në mes të një pylli të largët po trajtoheshim kaq mirë!



edhe më i pasigurt se herën e parë, por më dëgjoi. Unë ula dritaren dhe ju thashë me një ton gjysmë-serioz: "Ishte bukur të vizitonim miq të vjetër në fshat, por tani duhet të nisemi për në Fushë Lurë. Ajo është rruga apo jo?" Pastaj qesha, që ta kuptonin se nuk na ngeli hatri. Po, ata drejtuan gishtat nga kodra.

Para se ta kuptoja se ç'po ndodhte, ata kishin hapur derën e pasme dhe po fusnin brenda një prej tyre. Asistenti im po skuqej nga inati, por djali ishte brenda dhe dera ishfe mbyllur. Mes të qeshurash, djemtë e tjerë thanë që ai do të sigurohej që po iknim në drejtimin e duhur.

Iu ngjitëm kodrës, që dalëngadalë po na dukej më shumë si mal. Po i flisja pasagjerit tonë: "Si e ke emrin; ku jeton; a ishin ata shokët e tij (çfarë pyetje!). Ai e kuptonte që nuk do të ktheheshim në Grykë Nokë apo jo; e të tjera. Isha i sigurt se shqipja ime ishte e mirë, por çfarëdo të thoja, djaloshi vetëm qeshte. Provova të përdorja theksin shkodran që kisha zhvilluar, por prapë të qeshura. Vetëm një orë më parë po flisja me atë familjen e këndshme dhe gjithçka dukej sikur shkoi mirë. Prandaj, pse po qeshte djali me gjithçka që po thoja? Fillova të shqetësohesha.

Ndërsa po arrinim majën e kodrës, "guida" jonë, që s'kishte folur fare, më preku në shpatull dhe më bëri sinjal të ndaloja. Pashë rrotull me nxitim-- s'kishte gjë pranë, vetëm fusha dhe pyje pak larg makinës. Djali zbriti, u afrua tek dritarja e makinës, më shtrëngoi dorën, ende duke qeshur. Pyeta veten, ç'kishte kaq gazmore. A ishte vërtet shqipja ime kaq e keqe?

Ai tregoi veten me gisht, më pas një shtëpi të largët guri. Ndërkohë që po largohej, tregoi veshët dhe gojën e tij, qeshi me të madhe dhe iku me vrap. Edhe mua më zuri gazi, ndërsa e pashë atë duke ikur me nxitim. Djali nuk mund të fliste e as të dëgjonte, por mund të qeshte dhe atë e bënte pothuajse pa pushim! Me siguri edhe miqtë e tij, që i kishin gjetur një shofer nga Grykë Noka për në shtëpi, po qeshnin akoma! Vetëm asistenti im nuk qeshte. Ai psherëtiu dhe me shumë mundësi po më shante nën vete!

Fatmirësisht rruga e ngushtë malore vazhdoi të ishte më e thjeshtë se rruga që sugjeroi harta ime e vjetër dhe ne bëmë përparim të mirë, duke shijuar pamjet e bukura. E vetmja gjë që kisha ishte emri i doktorit, prandaj sapo iu afruam fshatit të Lurës dhe pashë një djalë të ri në anën e rrugës duke buzëqeshur, i thashë asistentit tim të hapë krahun. Ula xhamin e dritares dhe përsëri me shqipen time "më të mirë" e përshëndeta. Më pas e pyeta me mirësjellje nëse ai e dinte se ku mund të ishte doktori. Djaloshi i buzëqeshur u drejtua drejt makinës dhe, kur u afrua pranë dritares, ngriti bluzën duke treguar një shenjë të madhe në stomakun e tij. Çfarë po ndodh sot? - pyeta veten.

Asistenti im dukej përsëri i shqetësuar! Mos po më tregonte shenjën e tij për të më thënë se sa doktor i mirë ishte ai që po kërkoja apo mos po më tregonte se mundej të më ndodhte edhe mua ajo gjë? Nuk dija si të reagoja ndaj kësaj paraqitjeje të punës së doktorit, prandaj thashë: "Oh shumë mirë, Po ku mundem ta gjej doktorin?" Me më shumë buzëqeshje dhe disa përshëndetje të tjera, zbulova se shtëpia e doktorit ishte rreth kthesës tjetër. Doktori më tha që ai kishte rregulluar një vend për ne diku afër pyllit dhe më tregoi se si shkohej atje. Unë e falenderova dhe kur u larguam për të kërkuar për rrugën mes pyllit, po shpresoja që të kishim mundësinë të shikonim ndonjë gjë nga Parku kombëtar i Lurës dhe 14 liqenet e famshme të tij, të cilët ekzistonin që në Epokën e Akullit. Ne kaluam njërin prej tyre, i cili quhej "Liqeni i Luleve" dhe iu hodhëm syrin disa të tjerëve.

Rruga nga e cila ishim drejtuar ne vazhdonte lart në kodër dhe përmes pyllit, por ishte e ngadaltë dhe plot me gurë të mprehtë. Vazhduam të ecnim, por ishte e pamundur t'iu shmangeshim gurëve dhe majave të tyre të mprehta. Vetëm disa qindra metra nga mbërritja në destinacioni tonë, na u ça një gomë. Pak më parë në po këtë udhëtim, na ishte çarë edhe një gomë tjetër, por e kishim të pamundur ta ndërronim. E filluam këtë udhëtim me dy goma rezervë, por kjo e çarë tregonte që ne nuk mund të vazhdonim më tutje, pa ndërruar gomën.



Ndërsa po mendoja se si mund të kthenim makinën, pronari i shtëpisë u afrua dhe na takoi. I shpjegova se ku doja të shkoja dhe nga vija, dhe ai na tha që sigurisht mund të ktheheshim në tokën e tij, por në fillim duhej ta lejonim të na jepte disa meze për rrugën. Ja ku ishim, në Grykë Nokë, pa ditur nga do shkonim për të arritur në destinacionin tonë dhe të ftuar plot ngrohtësi në shtëpinë e një të huaji-- përsëri mikpritja Shqiptare po ma ngrohte zemrën. Para se ta kuptoja ç'po ndodhte, tre gjenerata të familjes së ti po na ofronin kafe, fruta dhe raki.

Siç thashë edhe më parë, unë nuk kam patur ndonjë problem, por unë nuk isha dhe aq naiv sa të besoja që disa zona që unë akoma doja të vizitoja, nuk kishin kaluar më parë të huaj. Por tani kishim ngecur – nuk kishim asnjë zgjedhje tjetër, përveçse të përdornim gomën e fundit rezervë dhe të shpresonim për më të mirën – në duart e Zotit.

Pronari i shtëpisë së madhe u afrua dhe erdhi pranë nesh për të parë se ç'po bënim. Në pak kohë, ne e kishim vendosur gomën rezervë dhe kishim ndaluar pranë ndërtesës së gurtë. Pronari na kërkoi të parkonim jashtë dritares, ku ai tha se do të mbante një sy për makinën tonë gjatë natës. Dukej sikur shtëpia ishte dizenjuar për të qenë një lloj hoteli, pasi kishte rreth 5 ose 6 dhoma, ndoshta më shumë. Ai na dha një dhomë me dy krevate, por mua nuk më pëlqen shumë të ndaj dhomën dhe e shmang sa herë të mundem. M'u desh ca kohë që ta bindja të na jepte dy dhoma, por ai më tha se duhej të paguaja për dy dhoma. Pas pak kohe ai u sigurua që ne e kishim kuptuar!

Na tregoi se në çfarë ore mund të hanim ushqim dhe ne sugjeruam që të hanim jashtë. I shpjegova atij që nuk haja as mish, as peshk, por çdo që tjetër përveç këtyre të dyjave do të ishte e mirëpritur.

Kishim disa orë para kohës së darkës, prandaj vendosëm që të eksploronim pyllin në këmbë. Nuk doja të rrezikoja të na çahej një gomë tjetër, të paktën derisa të largoheshim nga rruga me gurë të mprehtë. Pylli dhe kodrat ishin shumë të qeta, nuk kishte asnjë zhurmë tjetër përveç cicërimave të zogjve ose rrjedhjeve të ujëvarave. Ecëm aq sa mundëm para se të perëndonte dielli dhe filluam të ktheheshim. Mesa duket, ne humbëm rrugën nga u kthyem dhe pas disa momentesh të vogla frike, duke kthyer kokën nga njëra anë në tjetrën, pamë shtëpinë. Kishim kaluar nga një rrugë pakashumë gjysëm miljeje, pak më poshtë shtëpisë. Por çdo hap i vlente vetëm për të kaluar nën pemët e gjata të shikoje dhe të ndjeje ujin e ftohtë që kalontë poshtë kodrës, të shikoje diellin duke u larguar pak e nga pak. Ahu europian, bredhi i argjendtë, pishat e zeza dhe rrallë disa pisha boshnjake. Çfarë vendi i mrekullueshëm. Kisha lexuar se zona ku ndodheshim ishte akoma shtëpia e arinjve të murrmë, rrëqebujve, ujqërve, kunadheve dhe kaprojve, po për fat të keq nuk pashë asnjë prej tyre. M'u kujtua shprehja e poetit të famshëm Gjergj Fishta (1871-1940) "Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë".

Arritëm te shtëpia fiks në kohë për t'u ulur jashtë në tryezën e madhe të drunjtë dhe ku po shtrohej darka. Çfarë gostie. Gjithmonë kam menduar që dieta ime hap problem, por edhe pse tërë këto tre vite që kam jetuar në Shqipëri nuk kam takuar asnjë vegjetarian tjetër, gjithmonë çuditesha nga vakti që më shërbehej, pasi gjithnjë ishte i mrekullueshëm. Shpresoja që të mos kisha hapur problem për ndonjë. Na u shërbye byrek, bukë, djathë, sallatë, domate, kos, fruta, kafe dhe shumë raki e birrë nëse donim.

Para se të fillonim të hanim, një grup njerëzish arritën në fshat, bashkë me doktorin që na sugjeroi këtë vend të mrekullueshëm. Dukej se fjala ishte përhapur që një i huaj i çuditshëm fliste shqip ose ata thjesht donin të më mirëprisnin. Ndoshta të dyja.

Folëm me ta. Ushqimi ishte i këndshëm dhe rakia rridhte lirisht. Kujtoj që asistentit tim nuk i pëlqente shumë rakia dhe kjo ndoshta ishte gjë e mirë. Natyrisht, më duhej të largohesha në pikë të mëngjesit, dhe më duhej dikush që t'i jepte makinës. Edhe njëherë, mikpritja shqiptare më mrekulloi. Dy të huaj në mes të një pylli të largët po trajtoheshim kaq mirë! Isha i gëzuar, ndoshta pak i pirë, kur pashë një grua që doli nga shtëpia. Ishte veshur me të zeza, me fytyrë të mbuluar. I thirra dhe thashë: "Faleminderit, zonjë, për vaktin. Ishte shumë i shijshëm."

Qetësi. E tërë tavolina ra në qetësi dhe në moment e kuptova që kisha bërë një gabim. Pas njëfarë kohe, që mua m'u duk si një pafundësi, burri më i vjetër në tavolinë tha: "Nuk ka problem. Është i huaj, nuk i di traditat tona". Ai u kthye drejt meje dhe më tha: "Nuk duhet t'i flasësh zonjës së shtëpisë. Në qoftë se ke komplimenta, duhet t'i thuash të zotit të shtëpisë dhe e ka në dorë ai t'i thotë gruas." Çfarë gabimi. Unë krenohesha me studimin e traditave dhe mundohesha aq shumë t'i respektoja, por ja ku isha, duke u sjellë si një turist i rëndomtë. Kërkova falje dhe më siguruan që s'kisha bërë ndonjë dëm, por e kisha marrë mësimin dhe nuk do të isha kaq i pakujdesshëm përsëri.

Kjo ishtë historia e kësaj pjese të udhëtimit larg Tiranës. Ditën tjetër u nisa për në Kukës për një natë, më pas në perëndim drejt Shkodrës time të dashur dhe më pas në jug, përsëri drejt Tiranës.

** Nënkoloneli Mark D. Vickers ka qenw atashe ushtarak i Britanisw së Madhe në Tiranë në vitet 2005-2008. Ai ka shkruar me shumë dashuri disa artikuj mbi Shqipërinë dhe ka realizuar mjaft foto dhe piktura nga Shqipëria.*

Përkthyen dhe përshtatën në shqip:
DEA&KLOVIS KAROSHI

Rruga e Arbërit nr. 145

Zona e Çidhnës së Poshtme përfshihej në principatën e Kastriotëve, e njohur në historinë tonë mesjetare. Kështjella e Skënderbeut ose e Çidhnës, në lartësitë perëndimore të Çidhnës së Poshtme i përket pikërisht kësaj periudhe.

arkeologji

Të dhëna arkeologjike nga Çidhna e Poshtme

Nga Prof. dr. **Adem BUNGURI**

(vijon nga numri i kaluar)

6. PERIUDHA E HERSHME MESJETARE (SHEK. VII-XI M. KR.)

Kësaj periudhe i përkasin dy grupe gjetjesh, kronologjikisht të lidhura me fazën e hershme të periudhës mesjetare (shek. VII-IX pas Kr.) dhe atë të zhvilluar të saj (shek. IX-XI pas Kr.).

a. Faza I e mesjetës së hershme (shek. VII-IX m. Kr.)

Fazës së parë të mesjetës së hershme (shek. VII-IX pas Kr.) i përkasin dy varëse bronzi tipesh të ndryshme, me origjinë nga një pikë e panjohur e fushës së Çidhnës së Poshtme, që ruhen në pavionin arkeologjik të MHP.

1. Tab. II, 11, fig.7, 4; gjatësia: 6. 4 cm; gjerësia: 3,6 cm; nr. inv. 100. Varëse gjoksi bronzi e punuar me derdhje. Përbëhet nga dy rrathë të bashkuar, me diametrat përkatës 3,6 cm dhe 2,2 cm. Secili nga rrathët ndahet në tri pjesë nga diametrat horizontalë dhe nga një reze verikale. Në anën e jashtme, varësja është zbukuruar nga 9 shtojca sferike dhe dy protome shpendësh, të vendosura në zonën midis diametrave të të dy rrathëve. Rrethi i poshtëm i varëses, në anën e jashtme, zgjerohet në trajtën e një shtese unazore, e cila në gjysmën e poshtme e saj, është shpuar simetrikisht në çdo 0,5 cm, nga 9 rrathë të vegjël. Varëse të këtij tipi, me ndryshime të vogla stilistikore, janë zbuluar në disa varreza të mesjetës së hershme në Shqipëri dhe përfaqësojnë objekte të kulturës arbërore.

Afërsinë më të madhe tipologjke, ajo e shënon me një varëse të varrezës mesjetare të Krujës, të datuar në shek.VI-VIII pas Kr[32].

2. Tab. II, 9, fig.7, 5; gjatësia 5, 8 cm; gjerësia 3,4 cm; nr. inv. 100.

Varëse bronzi e një tipi të veçantë e të panjohur. Ka formën e zemrës me krahë të hapur, të cilët, në fundin e tyre, janë të tejshpuar nga dy vrima të vogla sferike në një aks horizontal. Në pjesën e sipërme, varësja ka një të dalë sferike të tejshpuar, ku, me anë të një thumbi, është fiksuar një mbajtëse e lëvizshme katrore, në të cilën kalonte zinxhiri. Në të dy anët, varësja është e zbukuruar me teknikën e ngulitjes. Motivi krijohet nga dy vija paralele, të vijëzuara pjerrtazi, që konturojnë skajet e varëses, ndërsa hapësira midis tyre mbushet nga dy rreshta pikësimesh rrethore. Në pjesën qëndrore, varësja ka një të dalë të lehte sferike që rrethohet gjithashtu nga një rreth pikësimesh të vogla rrethore. Megjithëse pa shembuj adekuat krahasimi, mendojmë se i përket periudhës së hershme mesjetare, kur varëset zbukurimore njohin trajta të ndryshme tipologjike e stilistike[33].

b. Faza II e mesjetës së hershme (shek. IX-XI m. Kr.)

Kjo periudhë u bë e njohur nga varret nr. 2 dhe nr. 3 të varrezës nr.2, të zbuluara në shpatin jugor të Vneshtës së Kolës. Varret kanë qenë të ndërtuara me gurë, konstruksioni i të cilëve nuk qe e mundur të kapej. Nga fragmentet e enëve të mbledhura këtu, mbizotërojnë ato me fakturë mesatare, ndërkohë që ato me fakturë të trashë janë mjaft të pakta. Enët e kategorisë së parë janë punuar me çark. Ato kanë brum argjilor, përgjithësisht të pastruar, me pak përmbajtje silici, të ngjeshur dhe të pjekur mirë. Sipërfaqja e jashtme, me lëmim mesatar, ka ngjyrë gri në të zezë dhe shumë rrallë okër në të verdhë. Enët e kësaj kategorie zakonisht janë të zbukuruara. Enët me fakturë të trashë përfaqësohen vetëm nga dy buzë tasash të modeluara me dorë. Kanë brum të përzier me rërë të pa situr e grimca gëlqerore, pjekja nuk është e plotë. Sipërfaqja poroze me ngjyrë gri të hapur është e pa zbukuruar.

Në fragmentet e enëve të kategorisë së parë ndeshen format e mëposhtme:

1. Vorba kuzhine. Është ena me përdorim më të gjërë. Kanë trup të fryrë sferik, qafë të shkurtër konike dhe grykë që hapet në trajtë hinke. Janë pa vegjë dhe me funde të sheshtë. Ndryshojnë nga përmasat dhe shkalla e përkuljes së buzëve. Diametri i grykës së tyre arrin në 15-17.5 cm (Tab. II, 12-13, III, 1-5).

Shumica e vorbave dhe pareteve të tyre janë të zbukuruara. Më i shpeshtë është zbukurimi në reliev, në trajtën e një shiriti plastik horizontal me prerje konike dhe gropëzime gishti, dhe me rrallë me shtypje oblike në trajtë litari, i vendosur në shpatullat e vorbave (Tab. II. 12, III, 13-16). Ndeshet gjithashtu edhe zbukurimi i inçizuar në trajtën e vijave të valëzuara apo lineare, të përqëndruara në zonën e shpatullave. Vijat e valëzuara në një ose në dy rreshta paraqiten në formën e tyre klasike të shtrirë (Tab. III, 5) apo të ngjeshur, duke krijuar motivin "dhëmbë sharre" (Tab. III, 3-4). Në ndonjë rast, ato kombinohen edhe me vijat rrethore të çarkut (Tab. III, 4). Vijat lineare të realizuara me majën e thikës gjatë rrotullimit të enës në çark, si rregull, janë të grupuara në breza horizontalë prej 2-4 vijash (Tab. III, 17-18).

Vegjët janë vertikale me prerje eliptike, me gjeresi 3-3.5 cm, të zbukuruara me teknikën e ngulitjes dhe të shpimit. Ngulitjet janë vezake apo të stërgjatura, të organizuara në rreshta gjatësorë, jo rigorozisht të drejtë (Tab. III, 19-20) dhe më rrallë në dy rreshta (Tab. III, 21). Zbukurimi me shpime ndeshet në dy pjesë vegjësh (Tab. III, 22-23). Shpimet janë realizuar me gjilpërë në baltën ende të njomë dhe nuk e përshkojnë tërësisht vegjën. Fundet jane gjithmonë të sheshtë dhe presin direkt trupin e enës. Diametri i tyre është 7-15 cm (Tab. III, 24-27).

Vorba me formë të ngjashme dhe zbukurime të njëjta ndeshen thuajse në të gjitha qendrat mesjetare të vendit tonë e jashtë tij[34]. Në Gradishtën e Symizës ato datohen në shek.IX-XI m. Kr[35], ndërsa në Shurdhah në shek. X-XI m. Kr[36], kohë te cilën do ta mendonim si më të mundshme për enët e Çidhnës së Poshtme. Në enët me parete të trasha përmendim vetëm dy fragmente tasash gjysëm sferikë me buzë të rrumbullakuara (Tab. III, 6-7), të ngjashëm me tasa të tillë të Shurdhahut të shek.X-XI m. Kr.[37].

2.Enë me përmasa më të vogla, me grykë cilindrike ose në trajtë hinke, të pa zbukuruara (Tab. III, 9-12). Këtu përfshihet edhe profili i një amfore me grykë të ngushtë (Tab. III, 12), e ngjashme me enë të tilla të periudhës së vonë antike të zbuluara në kalanë e Elbasanit dhe në Gradishtën e Symizës[38]. Amfora të këtij tipi, sa duket, vazhdojnë të përdoren në mesjetën e hershme, kur është më tepër në qarkullim amfora grykë ngushtë me dy vegjë të larta mbi buzë, e ndikuar nga qeramika bizantine e shek.X-XI pas Kr.

Parete enësh shumë të copëzuara dhe pa asnjë zbukurim të periudhës mesjetare, u gjetën edhe në jug-lindje të fshatit Çidhën e Poshtme, në një fushë skajore, në vendin e quajtur "Kisha e Salës". Gjithashtu, në vendin e quajtur "Kodra e Farkës", në jug të rrugës automobilistike dhe afër vendit te quajtur "Pusi", kemi gjetur me shumicë zgjyrë hekuri, gjë që flet për shkrirjen dhe punimin e këtij metali gjatë mesjetës.

3.Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fshatin Sinjë e Epërme të Çidhnës. Ruhet në MHP, nr. inv. 43. Gjatësia e përgjithshme 5 cm, gjatësia e fletës 2.4cm, gjërësia e fletës 1.2 cm, diametri i bishtit-0.6-0.8 cm (Fig. 7, 6). Është e tipit me fletë në trajtë gjethi të ngushtë, pa veshëza, me bisht konik gypor. Fleta me prerje trekëndëshe, përshkohet nga një kurriz i lehtë gjatësor. Maja shigjetash me forma të ngjashme njihen në periudhën e hershme mesjetare, të zbuluara në varrezat e kulturës arbërore të Krujës[39], kështjellës së Pogradecit[40] etj.

7. PERIUDHA E MESJETËS PARATURKE (SHEK. XIII – XIV M. KR.)

Një aspekt i jetës së kësaj periudhe, është bërë i njohur nga zbulimi rastësor i një thesari monedhash në vendin e quajtur "Pusi", afër qendrës së fshatit Çidhën e Poshtme. Thesari përmban 24 copë monedha argjendi veneciane[41], të prera nga mesi i shek.XIII (1253-1268) deri në fillimin e shek. XIV (1312-1328) (Fig. 8, Tab. IV). Ato u takojnë dozhëve të mëposhtëm të republikës veneciane:

1. Ranieri Zeno (1253-1268) (tab. IV, 1-7)
2. Lorenzo Tiepolo (1268-1275) (tab. IV, 8-9)
3. Jacopo Contarini (1275-1280) (tab. IV, 11-13)
4. Giovanni Dandolo (1280-1289) (tab. IV, 10)
5. Pietro Gradonigo (1289-1311) (tab. IV, 14-19)
6. Giovanni Soranzo (1312-1328) (tab. IV, 20)

Monedhat paraqiten të konsumuara në shkallë të ndryshme nga përdorimi, gjë që shihet në uljen e peshës së tyre kundrejt peshës fillestare standarte të emetimit prej 2.178 gr[42], në pesha që luhaten nga 1.91 gr. tek monedha nr. 2 e J. Contarinit deri në 2.16 gr. tek monedha nr. 4 e J. Gradenigos. Vetëm në një ekzemplar, të përfaqësuar nga monedha nr. 1 e G. Dandolos, është ruajtur pesha fillestare e emetimit prej 2.178 gr. Në tabelë, po japim katalogun e monedhave, ku me shkurtime jepet sasia e tyre (S), metali (M), pesha në gr (P), diametri në mm(M), figura në ilustrime (F) etj.



Tabelë përmbledhëse e monedhave të thesarit.

Në aspektin kronologjik, monedhat janë prerje të 6 dozhëve suksesivë të Venedikut, që kanë drejtuar republikën, që nga Ranieri Zeno (1253-1268) deri tek Giovanni Soranzo (1312-1328)[43]. Në këtë vijimësi, nuk ka asnjë ndërprerje për një periudhë rreth 60 vjeçare, gjë që është refleks i stabilitetit ekonomik dhe politik të rajonit ku është gjetur ky thesar. Zbulimi i tij dëshmon për përfshirjen e zonës së thellë të Çidhnës së Poshtme në marëdhëniet tregëtare me republikën e fuqishme të Venedikut, si dhe për fuqizimin e parisë feudale vendase. Fshehja e tij në tokë është bërë në ndonjë situatë të pasigurtë politike.



Fig. 8. Thesari venecian i Çidhnës së Poshtme.

8. PERIUDHA E SKËNDERBEUT

Kjo periudhë në plan arkeologjik është përfaqësuar nga dy kala tipike të Skënderbeut. E para prej tyre quhet edhe kalaja e Skënderbeut, ose e Çidhnës[44] (Fig. 9). Rrënojat e saj gjenden në një kreshtë shkëmbore me lartësi 1205 m, në thellësi të luginës së Setës, në faqen juglindore të malit të Xhaxheit, që lartësohet në perëndim të Çidhnës së Poshtme dhe kanionit të Gjalicave. Ajo ka sipërfaqe të vogël dhe një pozicion zotërues dhe shumë të mbrojtur nga natyra, në kontroll të Çidhnës së Poshtme dhe rrugëve dytësore që e lidhnin këtë zonë me Lurën (qytetin mesjetar të Livadhit të Xharrit), kalanë e Stelushit (Qafë-Murrë) dhe atë të Gurit të Bardhë (Mat). Shtegu i vetëm për të hyrë në kala kalon nëpër qafën e kalasë, në anën jugperëndimore të saj. Në pjesën më të lartë të kalasë duken gjurmët e një kulle rrethore. Trakte të shkëputur muresh mesjetare shihen vetëm në anën lindore dhe atë juglindore. Ata rrethojnë një sipërfaqe rreth 500 m^2 . Muri është ndërtuar me gurë mesatar e të vegjël, të lidhur me llaç të dobët gëlqeror, me gjatësi të përgjithshme 72 m dhe trashësi 1,50 m (Fig. 10).

Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është konstatuar edhe në kala të tjera mesjetare të vendit tonë si në Shurdhah (1.30-2.60m)[45], në Krujë (0.80-1.50 m)[46] dhe Daulë të Krujës (0.75 m, 0.90 m, 1.10 m, dhe 1.80 m)[47], në Stelush dhe në Gur të Bardhë të Matit (1.50-1.80 m)[48], në Koxhaxhik të Dibrës(1.40-1.70 m)[49] etj (Fig. 10). Në anën verilindore të kalasë, ruhet një sterë uji në trajtë katërkëndëshe, me brinjë 1.80 x 2.20 m, thellësi të matshme 2.90 m dhe vëllim mbi 11.484 m^3. Faqet e brendshme të saj kanë qenë të suvatuara me llaç shamot, i cili, edhe pse i shembur, ka lënë gjurmët e tij ngjyrë tulle mbi faqet e murit (Fig. 11).

Në sipërfaqen e kësaj kalaje janë gjetur edhe disa fragmente enësh të periudhës mesjetare, kryesisht vorba dhe tasa, me formë dhe dekor të ngjashëm me ato të kalasë së Stelushit, të Koxhaxhikut etj, të lidhura me shek. XV m. Kr[50] (Fig.12, 1-3). Kjo kala shërbente si pikë vrojtimi dhe lajmërimi me anë sinjalesh dhe si vendstrehim në rast rreziku, jo vetëm brenda mureve mbrojtëse, por edhe në grykat dhe lugjet e shumta përreth saj.

Kalaja e dytë, e përdorur kryesisht si pikë vrojtimi, është ajo e Kepit të qytetit në hy-

kulturë

Vera Laçi arriti të fitojë disa mirënjohje e çmime. Krijimet e saj vazhdojnë. Asaj më tepër se kujtdo i takojnë meritat e respektet nga gjithë shoqëria jonë.

VERA LAÇI, duke u stërvitur soliste, u bë **mjeshtre e artit dibran**

Nga **Arsim KOLARI**



Nuk ka fjalë të përshkruhet se sa e vështirë është të këndohet në skena me mijëra artdashës, sidomos kur ke përpara publik të edukuar ndër breza për domethënien e vlerave të mirëfillta artistike. Për çudi, artistja jonë popullore Vera Laçi, nuk u lëkund nga shikimet e publikut edhe si e vogël, sepse talenti dhe krenaria i qëndronin vazhdimisht pranë. Përmes tekstit të shkrimtarit, melodisë së muzicientit dhe zërit të saj cilësor, u krijua trinomi i quajtur këngë e pastër popullore, e cila dominoi thellë në emocionet e popullit, të cilit krenarinë ia shtoi në çdo kohë.

Vera Laçi u lind në Kastriot të Dibrës në vitin 1968, karriera e së cilës lulëzoi që në moshën 15 vjeçare. Ishte viti 1983 kur rregjistroi këngët puro dibrane "Na çeli prap thana, djalin e pret nana", baladën "Dimën-o, dimën-o" dhe "Këngën e Haxhi Zekës". Këngët morën jehonë në rrethin e Dibrës, më shumë ngase kjo artiste e vogël me moshë dhe "e madhe" me talent, akoma s'kishte mbaruar shkollën e mesme të muzikës. Në vitin 1985 u përzgjodh të bëhet pjesë e Ansamblit dhe Estradës së Peshkopisë, e cila deri në këtë periudhë kishte krijime apo këngë të pakëta, për t'u plotësuar me ardhjen e Vera Laçit dhe një grup artistësh të tjerë. Kështu, Vera filloi të rregjistrojë këngët dibrane dhe atë: "O moj cuc' syzezë", "Or mullixhi", "Këngën e Vehbi Dibrës", "Zemra zemrës seç i flet", "Përgjon djali ke lajthia", "Dri o Dri, i ziu Dri", "Cucat e fshatit" (këngë e cila fitoi tek anketat muzikore të asaj kohe, me tekst të Naim Plakut, e me muzikë të Përparim Tomçinit), etj. Vitin 1988, bashkë me grupin e rrethit të Dibrës, marr pjesë në Festivalin e Gjirokastrës me këngët "Seç m'u dogj kjo zemër e shkreta" dhe "Dri o Dri, i ziu Dri". Me ardhjen e vitit 1990, Vera merr vlerësime nga specialistët më të mirë muzikor shqiptar si artiste me inçizime perfekte, duke ia cilësuar këtë vit si kulmin e karrierës së saj artistike, mbi të gjitha për promovimin e këngëve "të harruara" e autoktone dibrane.

Dekada e fundit e shekullit të njëzetë, për shqiptarët u kthye në periudhë të "palakmuar" falë goditjeve që iu dhanë atij. Vitin 1993 ndodhën dy fatkeqësitë e rrëzimit të avionëve në Shkup e në Ohër, duke u marrë jetën rreth 300 shqiptarëve, nga e cila rrodhën vargjet e Naim Plakut, "Derdhen lotët mbushin Drinin, treqind nëna shkulin gjinin", të cilave Përparim Tomçini u përgjigjet me melodi dhe i besohet Verës që të derdhë emocionet artistike të saj në këndimin e kësaj balade me mision sensibilizues. Pastaj, masakra e helmimit të fëmijëve shqiptarë në Maqedoni, inicioi krijimin e këngës "Stop helmimet", ndërsa kënga "Ku po shkon ky varg i gjatë" me tekst të Naim Plakut dhe muzikë të Edmond Zhulalit, mori shkas nga ikjet masive të shqiptarëve nëpër vendet evropiane, përfshirë këtu tragjeditë e ndodhura nëpër brigjet e bregdetit shqiptar. Kjo, si të thuash, e nxiti popullin që figurën e Vera Laçit ta vendosë në një vend të veçantë brenda zemrës së tij, për ta kujtuar si "artiste të ndjenjave të tyre shembullore". Pastaj, "Kënga e Ymer Agës" u popullua shpejt, dhe atë se trajtonte një temë të veçantë të ndodhur rreth trevës dibrane, sepse Ymer Aga, si djalë trim e bukurosh, u zu rob nga vajza e mbretit të Spanjës, duke u bërë shembull në rajon si një rast unik. Kënga e "Sulçe begut", këngët me motive të dasmave dibrane, bënë bujë kur u kënduan nga Vera Laçi, falë së cilës këto krijime popullore, fituan pavdekësinë. Në vitin 2004, po prapë në Festivalin e Gjirokastrës, por tashmë me baladën e moçme dibrane "I hypa pamporit, javash e javash-e", Vera mori vend meritor mes artistëve më të shquar të muzikës së mirëfilltë shqipe. Gjatë përmbledhjes së albumit "Oj Xhemile", botuar në vitin 2009, Vera Laçi përzgjodhi për t'i përfshirë disa krijime të vjetra dibrane, siç kemi: "Oj fusha e Korabit", " Pjergull-o mori pjergull-o", "Oj Xhemile", "Plot me yje, na është mbush havaja", "A ia din rendin burrnisë", por edhe krijime të reja nga Jorgo Papingji, e kompozime të reja nga Edmond Zhulali.

Debutoi nëpër qindra e mijëra skena e festivale, brenda dhe jashtë vendit, me një krijimtari prej qindra këngësh e tre albume të suksesshme artistike, me dhjetra videoprojekte cilësore, Vera Laçi arriti të fitojë disa mirënjohje e çmime nga persona eminentë të artit e të kulturës. Krijimet e saj vazhdojnë, ndaj nga gjithë këto që u përmendën, asaj më tepër se kujtdo i takojnë meritat e respektet nga gjithë shoqëria jonë.



Fig. 9. Pamje e përgjithshme e kalasë së Skënderbeut.



Fig. 10. Rrënoja muresh të kalasë së Skënderbeut.



Fig. 12. Fragmente enësh mesjetare nga kalaja e Skënderbeut.

rje të Çidhnës së Poshtme, e shfrytëzuar si fortesë në periudhën e bronzit të vonë, në atë helenistike dhe atë antike të vonë (Fig. 2-3). Rrënoja muresh të kësaj periudhe nuk gjenden, por në anën veriperëndimore të saj, në fushën e Shasharit, shihen gjurmë banesash, që mendojmë se mund t'i përkasin të njëjtës periudhë historike[51]. Në shek. XV Çidhna e Poshtme, së bashku me Çidhnën e Epërme (sot Grykë-Nokë) dhe fshatrat Sinjë e Epërme dhe Sinjë e Poshtme, Gurrë, Arras, Shashari i Ruse, në përbërje të Kidhnës[52] së famshme mesjetare, luajti një rol të rëndësishëm në epopenë skënderbejane kundër superfuqisë otomane[53].

Megjithë karakterin rastësor të gjetjeve, nga kjo tablo e shkurtër evidentohet banimi



Fig. 11. Pamje e sterës së ujit të kalasë së Skënderbeut.

thuajse pa ndërprerje i kësaj zone, duke filluar që nga eneoliti e deri në mesjetën paraotomane e atë otomane. Një vazhdimësi e tillë banimi, padyshim është favorizuar edhe nga kushtet mjaft të përshtatshme për jetesë që gëzon fusha e Çidhnës së Poshtme. Gjurmët më të hershme të jetës i takojnë eneolitit, kur vendbanimi ka qenë vendosur në fushën e Macdhovës, përballë fortesës së "Kepit të qytetit". Në periudhën e vonë të bronzit, në mbrojtje të Çidhnës së Poshtme dhe rrugëve që e lidhnin atë me pellgun e Drinit të Zi në lindje dhe atë të Fanit në perëndim, përtej malësisë së Lurës, ndërtohet në këtë fortesë një fortifikim prehistorik i tipit Gajtan. Kjo fortesë do të rifortifikohet në periudhën helenistike, kur banimi i kësaj zone është më intensiv dhe mund të konsiderohet si porta mbrojtëse e Çidhnës së Poshtme. Gjithashtu ka të dhëna edhe për rifortifikimin e saj në periudhën e vonë antike, kur kalaja e Kepit të Qytetit ose e Çidhnës, përfshihet në listën e kalave të ndërtuara në provincën e Epirit të Ri nga Justiniani me emrin "Kithinas", prej nga rrjedh edhe emri i sotëm i Çidhnës. Intensiteti më i madh i banimit të kësaj zone rezulton në periudhën e vonë romake (shek. III-IV m. Kr.), atë të hershme mesjetare (shek. IX-XI m. Kr), si dhe në atë paraotomane (shek. XIII-XIV m. Kr). Tiparet e kulturës së saj në këto periudha janë të njëjta me kulturën e zonave të tjera të vendit.

Të dhënat e fundit arkeologjike i përkasin fillimit të shek.XIV- XV m. Kr., periudhë kur ishin formuar dhe fuqizuar principatat feudale. Zona e Çidhnës së Poshtme përfshihej në principatën e Kastriotëve, e njohur në historinë tonë mesjetare. Kështjella e Skënderbeut ose e Çidhnës, në lartësitë perëndimore të Çidhnës së Poshtme i përket pikërisht kësaj periudhe. Disa ndërprerje të vogla, të theksuara më lart, me sa duket, janë pasojë e zhvendosjes horizontale të vendbanimit në periudha të ndryshme historike, të cilat, deri tani, nuk janë bërë të njohura nga zbulimet e rastit.

(Marrë nga revista Candavia, 3/2011, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë)

REFERENCA

32 S.ANAMALI – H. SPAHIU, Varreza arbërore e Krujës, Iliria, IX - X, 1979 - 1980, f .171 - 172, tab. X, 13; H. Spahiu, Elemente të traditës antike në kulturën e varrezave të mesjetës së hershme shqiptare, Iliria, 1986, 1, f. 263, tab..I, 13.
33. H. SPAHIU, Elemente të traditës antike ...f.263, tab, I, 13.
34. D KOMATA, Disa tipare të qeramikës mesjetare në Shqipëri, Ilirët dhe gjeneza e Shqiptarëve (13-14 mars 1969), f. 226.
35. Gj. KARAISKAJ, Gradishta e Symizës në periudhën e vonë antike dhe mesjetë... f. 180- 181, Tab. IX – X.
36. H. SPAHIU- D. KOMATA, Vep.cit. f. 295 - 296, Tab. IV.
37. Po aty.
38. Gj. KARAISKAJ, Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit, Monumentet, 3, 1972, f. 149, tab. II, 6 – 7; Po ai, Gradishta e Symizës në periudhën e vonë antike dhe mesjetë, Iliria, IX-X, 1979-1980, f 177, tab. III, 7, IV, 5.
39. S, ANAMALI-H. SPAHIU, Varreza arbërore e Krujës, Iliria IX-X, 1979-1980, f. 57, tab. IV, 7.
40 S. ANAMALI, Kështjella e Pogradecit, Iliria IX-X, 1979-1980, f. 231, tab. XI, 5.
41Monedhat ruhen në Muzeun Historik të Peshkopisë, nr. inv. 875. Ata janë blerë prej tij në konkursin e antikiteteve të vitit 1978. Katër prej tyre janë të ngjitura në vitrinën e pavionit arkeologjik të këtij Muzeu, prej ku nuk mund te hiqen dhe për këtë arësye nuk janë paraqitur në këtë katalog. Sipas informacioneve të viteve të fundit, zbuluesi i tyre u ka shitur koleksionistëve privatë edhe shumë monedha të tjera nga ky thesar, gjë që tregon se kemi të bëjmë me një thesar të konsiderueshem monedhash veneciane.
42. Po aty, f. 106.
43. N.PAPADOPULI, Le monete di Venezie, Venezia, 1893, f. 106, tab. VI, 11, f .112, tab. VII, 3, f. 118, tab. VII, 9, f, 137, tab. VIII, 3, f. 144, tab.VIII, 9, f. 154, tab. IX, 6.
44. Vizita në këtë kala është realizuar së bashku me z. S. Mëziu, të cilin e falenderoj për ndihmën e dhënë. Kalaja quhet ndryshe edhe kalaja e "Sheut të thatë" (e përroit të thatë). Emri "Sheu" ka kuptimin "përrua" dhe mbahet si fjalë mjaft e vjetër e leksikut të shqipes së kësaj zone. Toponime të tjera të lidhura me këtë kala janë: Qafa e kalasë, Arat e kalasë, Gurra e Skënderbeut, Rrafsha e topit etj. Shih edhe A. Hoxha, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, Studime Historike, 1979, 3, f. 236; Po ai, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, Studime për epokën e Skënderbeut, II, Tiranë, 1989, f. 571.
45. H. SPAHIU - D. KOMATA, Shurdhahi-Sarda, qytet i fortifikur mesjetar shqiptar, Iliria III, 1974, f. 263.
46. S. ADHAMI, Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës, Monumentet 1971, 1, f. 87.
47. Gj. SARAÇI, Kalaja e fshehtë e Skënderbeut pranë fshatit Daulë (rrethi i Krujës), Iliria1987, 1, f. 205.
48. Sipas vrojtimeve të autorit në terren.
49. A. BUNGURI, Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër), f. 3, Studime Historike 2009, 1-2, f. 31. 50S. ANAMALI, Stelushi, qytet i Skënderbeut në Mat, Studime Historike, 1967, 4, f. 95- 112; Po ai, Stelushi, qytet i Skënderbeut në Mat, Studia Albanica, 1967, 2, f. 105-112;
50. A. BUNGURI, Kalaja e Koxhaxhikut...f. 3.
51 Në fushën e Shasharit, përballë Kepit të qytetit, deri vonë dukeshin gjurmët e një rruge të shtruar me kalldrëm. Kjo rrugë kalonte nëpër luginën e quajtur "fusha e qytetit" dhe të çonte në brendësi të Çidhnës së Poshtme. Fshati i Shasharit rezulton i regjistruar edhe në defterin osman të vitit të 1583, kur duhej të paguante detyrimin vjetor prej 500 akçesh. Shih për këtë: Dr. A. STOJANOVSKI, Turski dokumenti drzhaven Ahrid Republika Makedonija, Matica Makedonska, Za Istorijata na Makedonskijot sanèak od 1583 godina, Tom, VIII, Knjiga 1, Prevod Redakcija i Komentar, Skopje 2000, f. 490, nr. 40.
52 H. INALÇIK, Krahina e Krujës dhe e Dibrës rreth vitit 1467, Konferenca II e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969, f. 188.
53 Në gusht të vitit 1466 populli i saj u përball me masakrën çnjerëzore të sulltan Mehmetit II, i cili, pas dështimit të rrethimit të II të Krujës, gjatë tërheqjes për në Stamboll, kthehet nga Elbasani dhe masakron 8000 gra, pleq e fëmijë, të strehuar në Çidhnën e Poshtme, si hakmarrje kundër Skënderbeut dhe njerëzve të trojeve e gjakut të tij. (Shih: G. BIEMMI, Historia de vita et gestis Scander-Begh, Brescia, 1742, f. 453; F. S. NOLI, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1962, f. 111). Kjo shpjegon edhe arsyen që në defterin turk te vitit 1467 Çidhna e Poshtme kishte 8 shtëpi dhe Çidhna e Epërme (Grykënoka) 16 shtëpi (Shih: A. HOXHA, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, Studime Historike, 1979, 3, f. 236; Po ai, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, Studime për epokën e Skënderbeut, II, Tiranë, 1989, f. 572.). Për intensitetin e lartë të banimit në periudhën paraturke, dëshmon edhe ekzistenca në hapësirën e këtij fshati e rrënojave të 3 kishave katolike me përmasa të vogla.

Qëllimi kryesor është të ketë një pikëtakim ku dibranët brenda dhe jashtë vendit, të kenë mundësi të gjejnë Dibrën, për të mos e harruar atë, për t'u mësuar të rinjve për traditat dhe për të bërë diçka që dikush më parë nuk e kish bërë.

TIKU që çdo ditë mbledh dibranët!

Nga **Samet ZAGRADI**

Të mbledhësh dibranët në ditët e sotme nuk është shumë e lehtë, sidomos në këtë kohë, për të mos thënë e vështirë, sepse situatat e ndryshme kanë bërë që njerëzit të lëvizin anekënd botës.

Mijëra dibranë ndodhen larg vendlindjes, duke ndërtuar një jetë më të mirë, por pa e harruar kurrë vendin ku u lindën dhe u rritën. A ju mungon këtyre njerëzve Dibra? Ju mungojnë bukuritë e rralla, traditat, vendet, njerëzit, gatimet e mrekullueshme të gjysheve, odat dibrane, dialekti karakteristik, përse jo, dhe problemet e hallet që çdo ditë i jetojmë? Teknologjia ka bërë që këto gjëra të mos i harrojmë, madje t'i shohim çdo ditë, edhe pse virtualisht.

Faqja e rrjetit social *Facebook* "Këtu mblidhen Dibranët", që padyshim pjesa më e madhe e kanë në profilet e tyre, çdo ditë sjell, me një cilësi të lartë, atë që ndodh në Dibër. Tiku, siç njihet nga banorët e qytetit të Peshkopisë, ka ndërtuar faqen e tij që në fillimet e saj, duke e bërë atë sot një vend ku mblidhen me të vërtetë dibranët. Sot faqja numëron mbi 56.000 ndjekës, të cilët "ushqehen" çdo ditë me foto profesionale, video, muzikë etj., të cilët sadopak të heqin mallin për vendlindjen.

Kjo punë e madhe bëhet vullnetarisht nga Tiku, me një kënaqësi të madhe për Dibrën, të bukurën, fotografinë. Çdo ditë, pas një kafeje mëngjesi, pasioni i tij e çon anekënd Dibrës, për të sjellë gjithçka të mirë që ndodh.

Adriatik Vehap Sula lindi në vitin 1979 në fshatin Trenë të njësisë administrative Melan dhe njihet ndryshe si Dj Tiku, një prej Dj më të parë, që ushtroi veprimtarinë në Peshkopi. I pasionuar pas të bukurës dhe mendimeve pozitive, ky i ri udhëton për të sjellë foto të realizuara nga bjeshkët, malet, fshatrat e gjithçka të veçantë nga Dibra, për t'i reklamuar e për t'i bërë të njohura për publikun. Tiku është i dashuruar pas fotografisë dhe natyrës, pasion që e mban gjallë çdo ditë, duke vrapuar për të na e sjellë mjeshtërisht pranë nesh.

I pyetur se përse vendosi që ta krijonte këtë faqe, ai thotë se "qëllimi kryesor është të ketë një pikëtakim, ku dibranët brenda dhe jashtë vendit të kenë mundësi të gjejnë Dibrën, për të mos e harruar atë, për t'u mësuar të rinjve për traditat dhe për të bërë diçka që dikush më parë nuk e kish bërë".

Ai beson se dibranët duke u bashkuar diku, edhe virtualisht, ndajnë mendimet dhe opinionet në një faqe, duke u bërë më të vlefshëm dhe më produktivë, duke mos pranuar pasivitetin.

Secili ka të drejtë të paraqesë përvojën, idenë për të bërë diçka të mirë për Dibrën, sepse ajo ka nevojë për gjëra të mira. Ndjekësit e faqes gjejnë një mori të madhe fotosh, informacionesh dhe videosh, të cilat vlejnë shumë për ata dibranë që janë larg vendit. Qëllimi është i qartë, është një ide që i mban njerëzit e informuar.

Një qëllim tjetër dhe jo pak i rëndësishëm është fakti që kjo faqe tashmë shërben si vend ku prezantohen dhe reklamohen biznese, lajme, njoftime, festa, ceremoni e shumë veprimtari të tjera.

"Këtu mblidhen dibranët" është një faqe me nivel, falë një pune të palodhur dhe vullnetare të këtij djaloshi, që çdo ditë ne shohim realitete të ndryshme, të sjella mjeshtërisht nga Tiku, përmes aparatit fotografik, që shkrep kudo bukuri.

Të punosh vullnetarisht është një vepër për t'u vlerësuar, aq më pak kur punon për t'u shërbyer një numër aq të madh njerëzish.



"Unë nuk kam fituar asgjë monetare, përveç kënaqësisë që më japin njerëzit, duke më uruar dhe më mbështetur çdo ditë.

Kam shpenzuar para që të mirëmbaj faqen, pasi kur jetoja në Norvegji, nuk isha i identifikuar si administrator, por pasi faqja filloi të pëlqehej, vendosa që t'i kushtohem tërësisht asaj. Tregu i reklamave dalëngadalë po lulëzon edhe në Dibër dhe të vetmet të ardhura, të vogla sigurisht, vijnë nga ato. Bizneset po kuptojnë se sa e rëndësishme është marketingu për suksesin e tyre.

"Këtu mblidhen dibranët" gjendet edhe në rrjete të tjera sociale si *Instagrami*, ku fotot dhe videot shikohen çdo ditë. Kjo punë mua më bën të ndihem mirë, pasi përcjell te çdo ndjekës Dibrën, që u mungon aq shumë.

Do të vazhdoj të punoj fort në promovimin e vendit tonë. Marr shumë mesazhe edhe nga të huajt, të ciët kërkojnë informacione për Dibrën. Por kjo nuk mjafton, sepse duhen shumë faktorë që të mund të promovojmë vendlindjen, ashtu siç bëni ju, siç bëjmë ne, siç bëjnë edhe shumë të tjerë që punojnë në heshtje", thotë Adriatik Sula.

"Këtu mblidhen dibanët" gjendet edhe në rrjete të tjera sociale si Instagrami, ku fotot dhe videot shikohen çdo ditë. Kjo punë mua më bën të ndihem mirë, pasi përcjell te çdo ndjekës Dibrën që u mungon aq shumë. Unë do të vazhdoj të punoj fort në promovimin e vendit tonë.





Gjatë kampionatit të mundjes në Gollobordë.

Agim Deva, dibrani që prezanton falas Shqipërinë në SHBA

Agim Deva dhe bashkëshortja e tij, Suela, për katër ditë me radhë prezantuan Shqipërinë në Festivalin e Kombësive, që u mbajt në Minnesota të SHBA më 3-6 maj 2018.

Agimi i veshur me një kostum tradicional dibran dhe Suela një kostum të punuar shumë bukur të Tiranës, ngjallën interesimin e shumë vizitorëve në këtë panair, ku marrin pjesë 42 shtete.

Një baner me foto nga Shqipëria, Shkodra, Butrinti, Tirana, Kruja, si dhe portretet e Skënderbeut, Ismail Qemalit e Ahmet Zogut ishin vendosur në krye të stendës, ndërsa më poshtë objekte që tregojnë trashëgiminë tonë kulturore si çiftelia, fyelli, çajniku dhe objekte në miniaturë të një pusi apo punime me dorë të çantave, mbulesave, zbukurojnë stendën, ndërsa në krahun tjetër të stendës një flamur shqiptar me mbishkrimin "Albania", janë gjithçka ku tregohet Shqipëria e sotme dhe historia e saj. Ndërsa në një ekran shfaqen vazhdimisht foto dhe informacione nga rajonet e ndryshme të Shqipërisë, me theks mbi turizmin dhe historinë.

Ajo që e bën të veçantë këtë prezantim është fakti se gjithçka është bërë në mënyrë vullnetare, pa asnjë mbështetje shtetërore ose ambasada jonë në SHBA.

"Rreth një muaj përpara se të zhvillohej aktiviteti bëmë një mbrëmje në shtëpinë tonë dhe ftuam shqiptarët e interesuar. Aty secili solli, sipas mundësive, objekte për të ekspozuar. Një pjesë e rëndësishme janë të familjes time, por ka mjaft nga Shqiptarët e tjerë, madje një numër i vogël edhe nga miq amerikanë", tregon Agimi përmes emailit.

Ai tregohet mjaft entuziast pas përfundimit të panairit, duke vënë në dukje interesimin e madh të amerikanëve për Shqipërinë.

"Edhe pse kishim vullnetarë shqiptarë, si dhe dy amerikanë, përsëri nuk ishin mjaft, pasi, për çudinë tonë, interesimi i amerikanëve për Shqipërinë ishte i jashtëzakonshëm. Do të doja të kisha më shumë botime mbi Shqipërinë dhe vendet ku turistët mund të shkonin në Shqipëri", tregon Agimi.

Stenda, rreth 9 m2, ishte falas, por Agimi dhe miqtë e tij kanë paguar për banerat, printimet e ndryshme, ekspozimin dhe materiale të tjera për përgatitjen e stendës.

"Edhe pse Stenda ishte, sipas mendimit tonë modeste, nga përshtypjet e vizitorëve doli një nga më të mirat. Interesimi për Shqipërinë, është i jashtëzakonshëm, dhe ndoshta duhet menduar më seriozisht për turizmin e organizuar. Shqipëria, edhe sikur vetëm turistike, do ishte një minierë floriri për banorët e saj".

Festivali vjetor i Kombeve të Institutit Ndërkombëtar është festivali multikulturor më i larmishëm, më i vjetër dhe më i gjatë në Midwest. Që nga viti 1932, qëllimi i tij ka qenë të frymëzojë njerëzit për të zbuluar më shumë për botën tonë dhe për të përqafuar diversitetin e pasur kulturor në komunitetin ku jetojnë. Pothuajse 100 grupe etnike vijnë së bashku për një eksperiencë unike 4-ditore që feston trashëgiminë kulturore përmes vallëzimeve, shfaqjeve, ekspozitave, demonstratave dhe kuzhinës. Festivali është një departament i Institutit Ndërkombëtar të Minesotës, misioni i të cilit është "të ndihmojë amerikanët e rinj të arrijnë vetëmjaftueshmërinë dhe anëtarësimin e plotë në jetën amerikane".

Agim Deva prej më shumë se 10 vitesh jeton dhe punon në Minestora, së bashku me bashkëshorten Suela dhe dy djemtë, Erosin dhe Klevisin. Ai ka studiuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe ka qenë një ndër botuesit e parë në Shqipëri pas rrëzimit të komunizmit. Gazeta e tij "Eros" ka qenë një ndër më të shiturat pas viteve '90.



Një grup shqiptarësh nga Kosova gjatë vizitës në stendën e Shqipërisë.



Robert Granbeck (në mes), qytetar amerikan, dhëndërr Tirane, së bashku me bashkëshorten Ludmilla dhe djalin e Agimit, Eros Deva



Suela dhe Agimi gjatë gjithë ditëve të Panairit e prezantuan Shqipërinë me një kostum popullor të Tiranës dhe Dibrës.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Rruga e Arbërit nr. 145

reportazh

14 maji për shkollën qe i veçantë, shëndriste më shumë mes atij ambienti të bukur, rrethuar me gjelbërim e lule.

100 vjet shkolla e Allajbegisë

Nga **Zabit LLESHI**



Festa e shkollës në Allajbegi të Maqellarës u kthye në një manifestim të bukur popullor. Në lëndinën para shkollës, erdhën banorët e fshatit të veshur mirë e pastër, lanë punët e përditshme e bashkë me fëmijët atë ditë ia kushtuan shkollës së tyre. 14 maji për shkollën qe i veçantë, shëndriste më shumë mes atij ambienti të bukur, rrethuar me gjelbërim e lule. Çdo vizitor që vjen në këtë fshat nuk mund të mos mahnitet me bukuritë e këtij fshati buzë Drinit me rrugë të pastra,shtëpi të reja lyer me gëlqere me pastërti ku shendrit gjithçka dhe kurdoherë. Fëmijët, nxënësit e shkollës 9-vjeçare, të rinjtë e fshatit me vallet nën tingujt e muzikës, e bënë më të këndshme e interesante festën. Në sytë e të gjithëve shkëlqente gëzimi i ligjshëm për shkollën, të gjithë sjellin ndermend kujtime per mësuesin, klasën, bangën e shkollës, nëpërmjet së cilës kanë kaluar më shumë se tre breza.

Allajbegia është vendbanim 7000-vjeçar, në krah të djathtë të rrjedhës së Drinit Zi, në një pozicion të përshtatshëm, me një bukuri të rrallë e të begatë, një nga fshatrat më të pasur të Dibrës. Aty jeton një popull punëtor, patriot, me kulturë e shumë arsimdashës. Zbulimet akeologjike kanë vërtetuar se fshati është një vendbanim i lashtë Ilir në trevën e Dibrës. Institucioni më i vjetër është xhamia, ndërtuar në vitin 1585, ndër më të vjetrat në Ballkan, e cila u ruajt pjesërisht si monument kulture, nga prishjet e vitit 1967. Pranë xhamisë, në kohën e osmanëve u hap një shkollë turke.

Ka më se një gjysëm shekulli që fshati njihet me emrin Burim, një gjetje që i përshtatet këtij vendi, ku toka, natyra, kushtet klimaterike,pozita gjeografike, janë burim i të mirave materiale për njerëzit që banojnë aty. Prej shekujsh ata janë mjeshtër të punës, bujq të dalluar , blektorë e kultivues të perimeve e të pemëve frutore me një kulturë të hershme e tradicionale. Atje buron bujaria, pastërtia shpirtërore, besimi, mikpritja, patriotizmi i transmetuar nga njëri brez në tjetrin. Shkolla e Allajbegisë u hap zyrtarisht më 1916-1917, në kohën e pushtimit austro-hungarez 102 vjet më parë. Ishin të pranishëm banorë të fshatrave të Maqellarës, mësues veteran, ish-nxënës e ish mësues që kanë mësuar e punuar në këtë shkollë, mori pjesë kryetari i Bashkisë Peshkopi z.Muharrem Rama, drejtoresha e Arsimit zj.Margarita Markja, punonjës të administratës së Bashkisë, Njësisë Administrative Maqellarë e të ftuar të tjerë.

Sipas programit, klasa e parë e shkollës ishte përgatitur për Festën e Abetares. Nxënësit tashmë kanë mbaruar mësimin e shkronjave, lexojnë vjersha e libra. Emocione krijuan recitimet, këngët, skeçet, e valet e bukura të fëmijëve.Mesazhi i tyre ishte amaneti I Rilindasve " Ruani Abetaret në çdo shtepi e familje." Mësuesja Fatbardha Xhili kishte punuar me kujdes jo vetëm për repertorin e shfaqjes, por edhe për veshjen e fëmijëve në bashkëpunim me prindërit. Materiali figurativ i bollshëm, reklamuar në hyrje të shkollës, bashkë me përgatitjen e shkronjave e mjeteve të tjera, ishte mjaft I gjetur ,përgatitur enkas për Festën e Abetares.

Midis nxënësve u shquan Ejona Asllani, Ajdin Xheleshi, Mira Asllani, Armanda Dançe etj. Nxënësit e klasës parë morën çertifikata për mbarimin e Abetares, ndërsa shkolla e Burim) mori Çertifikatë Nderi nga Bashkia Dibër, të cilën e dorëzoi drejtoresha e Arsimit. Ajo përshëndeti pjesëmarrësit, uroi Festën e Fëmijëve, mësuesit e nxënësit, komunitetin e fshatit të gjithë ata që punuan pa u lodhur për zhvillimin e mbarëvajtjen e arsimit në zonën e Maqellarës. Për përmirësimin e punës me librin, shkollës iu dhuruan disa libra me përralla e lexime për fëmijë nga Bashkia Peshkopi dhe Zamira Xheleshi, mësuese bijë e këtij fshati.

Ramazan Ilnica, ish drejtues shkolle, studiues i Arsimit në Maqellarë, foli për historikun e shkollës Allajbegi. Ai u ndal kryesisht në të dhënat e burimeve arkivore për mësimin e shqipes, që trgojnë se aty nga viti 1891, sipas raporteve të Ministrisë Arsimit të Perandorisë Osmane, në fshatin Allajbegi kishte shkollë turke. Aty shërbenin klerikë muslimanë shqiptarë, qe ndihmuan fshehurazi të mësohej alfabeti dhe gjuha shqipe. Në Allajbegi kanë punuar mësues nga Shkodra, Gjirokastra, Kukësi, Dibra e Madhe etj, si Jahe Demnori, Shemsi e Drita Zhulali, Hasan Palushi. Qemal e Nebi Agolli, Haki Sharofi, Halil Golja, Jonuz Shehu. Shumë mësues vendës kanë kontribut jo vetëm në këtë shkollë, por edhe më tej, si Haki Pahumi, Baudin Strazimiri, Skënder Sala, Tefta Shehu, Demir Osmani, Ramazan Ilnica, Ramazan Piku, Rremzi Sala, Hajri Xhili etj. Këtu kanë punuar mësiesit e Merituar Jahe Demnori e Haki Sharofi, kanë qënë nxënës të kësaj shkolle mësuesit e merituar Shefki Shehu e Skënder Pahumi.Gjithë fshati ka kontribut për shkollën, në mënyrë të veçantë Kadri Demiri e Azem Markja. Nga Allajbegia kanë dalë 40 mësues, 51 kuadro me shkollë të lartë të specialiteteve të ndryshme etj.

Referuesi u ndal në detyrat që i dalin shkollës sot, duke bërë me dije se pas pak ditësh do botohet ky historik, që u prit me dorëtrokitje nga të pranishmit. Me mendimin se fëmijët dhe rininë e fshatit mund t'i bënte të lumtur, Arbana Osmani, si bijë me origjinë nga Allajbegia, ishte ftuar për të marrë pjesë në këtë gëzim. Babai i saj, Demir Osmani u premtoi se Arbana do jetë e pranishme në një të ardhme të afërt .Demiri falenderoi organizatorët për ftesën, si bashkëfshatar dhe mësues, në shkollën e mesme të Maqellarës. Gjithashtu ai tha se fshati ynë ka njxerrë akademistë si Shehat Tonuzi, (kreu studimet në Itali), Mjeshtin e Madh, shkencëtarin e pemtarisë Aqif Xheleshi, normalistin Mexhit Asllani e shumë kuadro të tjerë qe punuan në katër anët e atëdheut .

Gjallëri i dhanë festës këngët vallet si ajo e Tropojës dhe të krahinës , interpretuar nga nxënësit e shkollave të mesme Peshkopi e Maqellarë. Me interes e kureshtje për të pranishmit ishte shfaqja që dha cirku i Peshkpoisë, që drejtohet nga Agron Strazimiri, (nga Pucesti i Maqellarës). Agroni është akrobat i apasionuar i cirkut, e ka nisur këtë profesion në vitet 1970 në Bulqizë. Për më shumë se një gjysëm ore numrat akrobatike, ushtrimet individuale dhe në grup, tërhoqën vëmendjen e ngjallën emocione, duke u dorëtrokitur gjatë.

Vizita në shkollë ishte pjesë e programit të veprimtarisë . Në Kopësht ishte edukatore Violeta Xhemali, 33 vjet në profesionin e mësues dhe edukatores, pastaj në klasë të parë takuam mësuesen Fatbardha Xhili, Brikena Fikun, të klasës II dhe III, Evangjeli Mullameti, te klases se katërt. U njohëm me shumë mjete mësimore, të përgatitura nga vetë mësueset, çdo gjë në vendin e vet, të vendosura me kujdes. Materialet e ilustruaratë afishuara me rregull, nga hyrje e shkollës. Kudo mbizotëronte rregulli dhe pastëria. Një shkollë model me një eksperiencë shumë të mirë në proçesin mësimor edukativ në rrethin e Dibrës. Sot në shkollë frekuentojnë rregullisht 25 fëmijë në kopësht dhe 65 nxënës nga klasa I-IV.

....

Për mësuesit, të ftuarit artistët e cirkut të ardhur nga Peshkopia, u dha një koktel. U bënë përshëndetjet dhe urimet për festën, për organizatorët etj. Mësuesi veteran Neki Osmani, ish drejtor i shkollës mesme në Maqellarë, tha: Allajbegia ka nxjerrë burra e gra kuadro që kanë shërbyer ne gjithë Shqipërinë. Këtu ka ardhë Abdyl Frashëri, Bajram Curri, Vebi Agolli, Elez Isufi, Ismail Strazimiri, Haxhi Lleshi, Abaz Kupi, Aleksader Meksi etj. Në Allajbegi janë organizuar kuvende me rëndësi locale e kombëtare. Ne mësuesit veteranë ndjejmë kënaqësi kur tradita vazhdon. E vlerësoj punën e Osman Xhilit, si organizator i festës së shkollës, si veprimtar e punëtor i palodhur, shkruan e boton, deri tani ka botuar tetë libra. Gjithashtu vlerësoj Ramazan Ilincën shumë aktiv në veprimari të ndryshme"

Me shume konsiderata folen Ahmet Qushi e Murat Koltraka. Aqif Ademi-regjizor dhe aktor i njohur, recitoi pjesë nga krijimtaria e Haki Sharofit.

Osman Xhili falenderoi të ftuarit, të gjithë bashkëpunëtorët për ndihmën që dhanë në pasqyrimin sa më mirë të 102-vjetorit të shkollës dhe uroi që festa të tilla të organizohen sa më mirë e më shpesh. Ndonëse festa zyrtarisht përfundoi, diskutimet mes shokësh e miqsh vazhduan deri në orët e mbrëmjes. Me përshtypjet më të mira të një dite të bukur Maji, u larguam nga Allajbegia, duke marrë me vete respektin, dashurinë e kolegëve, njerëzve të mirë, bujarë e fisnikë të Allajbegisë, për të cilët jemi mirënjohës.

Allajbegi, 14 maj 2018





profil

Ahmet Balliu është i fortë si guri, i kuq si thana, i njomë si bari. Ky është Ahmeti: Njeriu që rron me muzikën. Ndonjë që nuk e njeh, le ta njohë e le ta takojë.

Ahmet Balliu një jetë mes tingujve muzikorë

Nga prof.dr. **Hajri SHEHU**



Sopoti, fshat i zonës së Zerqanit – Dibër është i njohur për bukuri të rralla. Në krye ngrihet shpatmali Shkozë, i veshur i gjithi me drurë. Poshtë zgjatet një brez i tërë arrash shumëvjeçare. Mu në rrëzë të malit burojnë tri gurra, që i japin jetë gjithë fshatit. Livadhet përreth gjelbërojnë deri vonë në vjeshtë. As borën nuk e mbajnë. E, prandaj edhe në dimër aty sheh tufa zogjsh, si rosa, pata etj.

Në krye të fshatit, pranë burimeve me ujë të pastër si kristal, në një lëndinë të vogël ngrihej kulla trekatëshe e Ismail Balliut, babait të Ahmetit. Nga kulla me dritare të vogla dukej si në pëllëmbë të dorës i gjithë fshati. Ishte një kullë që priste çdo ditë mysafirë, të njohur e të panjohur. Pas darke, zoti i shtëpisë i kënaqte mysafirët me çifteli dhe në kullë jehonin këngët e trimërisë deri natën vonë.

Në këtë familje lindi Ahmet Balliu. Më 25 dhjetor 1937. Ahmeti u rrit në një mjedis shumë frymëzues. Në pranverë, - tregon ai, - sapo hapja dritaren, para meje shpalosej tablo fort e bukur natyrore. Mbi tapetin e gjelbëruar të livadheve ngriheshin kurora lulesh shumëngjyrëshe të pemëve frutore. Gurgullimës së ujit dhe tingujve ritmikë të mullirit pranë shtëpisë u shtoheshin këngët e bilbilave. Unë ulesha pranë dritares, - vijon Ahmeti, - dhe me orë të tëra dëgjoja këtë simfoni në skenën natyrore. Kjo natyrë kaq frymëzuese, si edhe këngët që ai dëgjonte çdo natë në kullë bënë që zemra e tij të rrihte fuqishëm për muzikën. Ai pati ëndërruar të studionte në liceun artistik në Tiranë, por nuk e pati këtë privilegj. Ai vazhdoi shkollën pedagogjike në Peshkopi.

Në shkollën pedagogjike ai qe me fat. Lëndën e muzikës e jepte violinisti i talentuar, Mynir Shehu. Dhe qe Myniri ai që i dha Ahmetit bazat e mësimit të fizarmonikës. Pasi mbaroi pedagogjiken, Ahmeti u emërua mësues në shkollën 7-vjeçare "Demir Gashi", Peshkopi. Me nxënësit e saj ai formoi grupin artistik të shkollës, me këngë solo, duete korale dhe numra baleti. Dhe grupi dha me shumë sukses koncerte në Peshkopi, Bulqizë, Burrel etj. dhe gjatë pushimeve të verës, në të gjitha postat kufitare të Dibrës. Me shumë respekt Ahmeti kujton kolegët Xhelil Kulemani, Kadri Zhulali, Genc Bardulla, Selaudin Trepça, Gjyzel Hasani dhe Tanush Kaso (drejtor i shkollës së natës).

Në shtëpinë e kulturës në atë kohë erdhi nga Tirana pianisti i moshuar Skënder Frashëri, i sapoliruar nga burgu. Ai qe nga familja e frashërllinjve, ish-ambasador, njohës i disa gjuhëve. Edhe kësaj here Ahmetit i buzëqeshi fati: Nga ai pianist i talentuar Ahmeti mori bazat e pianos.

Në vitin 1957 u formua Estrada Profesioniste e Peshkopisë. Ahmeti u emërua dirigjent i orkestrës. Ai luante kryesisht në fizarmonikë, por jo rrallë, edhe në piano. Fillimisht, regjisor ka qenë Qerim Mato. Më pas, Tefë Krroqi. Në çdo dy muaj përgatitej një numër i ri estrade. Punonim me pasion, - thotë Ahmeti, - paradite dhe pasdite, madje edhe të dielat. Jepeshin shfaqje në qytet, në të gjitha fshatrat e Dibrës, - thotë Ahmeti, - por edhe në shumë qytete të tjera të vendit. Ahmeti bënte orkestrime, mblidhte këngë folklorike dhe tri herë në javë drejtonte kursin e fizarmonikës. Të lodhshme për Ahmetin ishin edhe mbrëmjet e vallëzimit, që organizoheshin mjaft shpesh në shkollën pedagogjike, në ndërmarrje të qytetit etj.

Një ditë, - tregon Ahmeti, - më erdhi fletëthirrja për ushtar – në marinë, 4 vjet. Dhe kur? Kur ai ëndërronte të vazhdonte studimet për muzikë jashtë vendit. Fati do të bënte të pamundurën. Atë e shpëtoi ndërhyrja e Jashar Menzelxhiut, ish-sekretar i parë i rrethit, tek ish-ministri i Mbrojtjes. Por studimet e larta i nisi vetëm pas katër vjetësh. Dhe ku? Në Moskë.

Në Moskë Ahmeti studioi për dirigjent. Të gjitha provimet e vitit të parë i mori shkëlqyeshëm. Por kësaj here nuk i priu fati. Të gjithë studentët u kthyen në Shqipëri. Këtu vazhdoi studimet e larta për gjuhë ruse. Ato do t'i mbaronte dy vjet më shpejt. Konservatori parashikohej në atë kohë pesë vjet.

Pas studimeve universitare, Ahmeti u emërua pedagog në gjimnazin e Lezhës, në një kolektiv të shkëlqyer pedagogjik, me drejtor Mësuesin e Popullit, Mark Vuji. Edhe këtu Ahmeti përgatiti një grup artistik me nxënësit e gjimnazit. Koncerti u dha disa herë me sukses në qytet dhe në fshatra.

Në vitin 1966 Ahmeti emërohet në Radio "Tirana", në drejtorinë e gjuhëve të huaja – redaktor në sektorin e gjuhës ruse. Që në fillim nuk iu duk se ishte në vendin e duhur. Dhe arriti të kalonte në sektorin e ilustrimeve muzikore. Ai përcaktonte muzikën për çdo emision. Por edhe ky vend nuk e kënaqte. Ëndrra e tij ishte muzika klasike. Ëndrra e tij ishte të shkruante për muzikën klasike. Dhe Ahmeti hapi ciklin e emisioneve "Të njohim kompozitorët e mëdhenj". Emisioni kishte tekst letrar, dramatizime dhe analiza veprash muzikore, çka do të thotë se duhej përgatitje e lartë. Vetëm për Bethovenin, - thotë Ahmeti, - u realizuan 8 emisione. Për këtë kompozitor, - vijon ai, - kam lexuar 10 libra në gjuhën ruse. Për uverturën me program *Egmont* të Bethovenit ftuam në studio Çesk Zadenë. Me partiturë në dorë, ai përcaktonte përmbajtjen e frazave muzikore: lufta e heroit, kapja e tij, torturat, qëndrimi heroik, vrasja e heroit. Në këto emisione flitej edhe për interpretuesit, dirigjentët, këngëtarët, instrumentistët etj.

Në këtë cikël emisionesh prej 60 minutash është folur për rreth 40 kompozitorë, si Bah, Bethoven, Brams, Belini, Rosini, Verdi, Puçini, Paganini, Bize, Debysy, Ravel, List, Çajkovski e shumë të tjerë. Numri i tyre shkon rreth 40, ndërsa numri i emisioneve, mbi 100. Besojmë që lexuesi mund ta nxjerrë vetë përfundimin për këtë punë vigane në 35 vjet. Dhe të gjitha këto emisione janë shkruar jashtë orarit të punës, në shtëpi, pa pagesë. Këto emisione janë vlerësuar si më të mirat në Radio, krahas *Teatrit në Mikrofon* dhe *Heroizmit të popullit tonë në shekuj*. Ato incizoheshin dhe ritransmetoheshin çdo vit.

Më 1992 Ahmeti fillon emisionin "Shekulli XX dhe muzika". Dëgjuesit njiheshin me një muzikë të re, të panjohur. Ky emision, me 60 minuta transmetohej çdo javë. Më vonë, ai çeli emisionin "Një CD për ju". Për të siguruar CD me muzikë, ai ka shkuar në ambasada – gjermane, austriake, italiane etj., të cilat janë treguar të gatshme për të ndihmuar. Më 1993, në Radio ka ardhur edhe një gazetar i BBC për të ndihmuar RTVSH. Dhe miku anglez kishte mbajtur shënim kërkesat tona, - thotë Ahmeti, - dhe pas disa javësh BBC na dërgoi 4 enciklopedi muzikore dhe thuajse çdo muaj na vinin kaseta dhe CD me muzikën, që ne kishim kërkuar. Tani, Ahmeti bënte një punë të pavarur, pa bashkëpunëtorë, pa përkthyes, madje, pa daktilografist. Tani ai do të punonte vetë – në fillim, me makinë shkrimi e më pas, me kompjuter.

Në vitin 1992 PD hoqi nga puna simpatizantët e PS. Më 1998, kur PS erdhi në pushtet, hoqi simpatizantë të PD. Ahmeti, si gjithmonë qëndronte larg partive. Partia ime, - thoshte ai, - është muzika. Dhe Ahmet Balliu punoi deri në qershor të vitit 1999, kur doli në pension.

Fati të ndjek, - thotë Ahmeti, - kur e ke ndërgjegjen të pastër. Dhe ai është i lumtur që të dy fëmijët i ka jashtë, në vende të preferuara, në shtete sociale. Vajza, Albana, sapo mbaroi Akademinë e Arteve për dirigjim orkestre në vitin 1993, shkoi në Danimarkë. Ajo është martuar me mjekun gjinekolog, Negjyp Sopa, nga Kosova. Negjypi ka pasur rezultate shumë të mira me gratë që nuk lindin. Ai përfaqëson Danimarkën në kongreset botërore të gjinekologjisë. Albana është nga shqiptaret e rralla, të cilave u është njohur diploma e Akademisë së Arteve. Fillimisht e emëruan pedagoge muzike në shkollë të mesme. Por, e pakënaqur, ndoqi Fakultetin Ekonomik. Pasi e mbaroi me rezultate të shkëlqyera, e emëruan në Kopenhagë, në Ministrinë e Ekonomisë, në sektorin e tregtisë së jashtme. Ajo komunikon mjaft mirë në anglisht me përfaqësues të firmave të huaja. Është një nga punonjëset më të vlerësuara në këtë sektor. Albana ka botuar në Shqipëri tre libra: *Fjalor muzikor Enciklopedik* (i pari i këtij lloji në Shqipëri); *Kush e vrau Moxartin* (përkthim); *Muzika dhe shëndeti*.Djali, Spartaku, shkoi në vitin 1998 në Kanada me dokumente të rregullta. Në Toronto, mbaroi kolegjin për elektromekanikë. Tani punon në këtë kolegj. Spartaku ka talent për gjuhë të huaja. Përveç anglishtes, flet lirshëm italisht e greqisht.

Unë dhe Liria, - thotë Ahmeti, - kemi rreth 20 vjet që tre muajt e verës i kalojmë në Albertslund, në periferi të Kopenhagës. Liria është e shoqja – një ish-mësuese e shkëlqyer, një amvisë e shkëlqyer dhe një familjare e shkëlqyer. Me një prejardhje familjare të shkëlqyer. Atje, - thotë Ahmeti, - ka parqe pa fund, me plot pemë frutore, si qershi, mollë, dardhë, gështenja, lajthi etj. Në hyrje të parkut lexon në anglisht: *Shijoni frutat, merrni me vete, por lutemi mos dëmtoni degët*!

Është e habitshme: Vetë danezët, - shpjegon Ahmeti, - nuk i prekin këto fruta në parqe, madje, as pemët që kanë në oborrin e shtëpive të tyre. I kemi për bukuri, - thonë ata. Dhe frutat i blejnë në markete. Parqet ndahen nga breza pyjorë. Është kënaqësi të ecësh në ato rrugë përmes pyjeve kaq të dendura, sa as rrezet e diellit nuk depërtojnë. Për ta plotësuar shpjegimin e tij, Ahmeti thotë: Danimarka është shtet social. Shëndetësia dhe arsimi janë falas. Madje, studentët paguhen. Taksat progresive bëjnë që të mos ketë miliarderë e milionerë. Nuk ka qytetar që të mos paguhet. Asistenca sociale është kaq e lartë, sa disa arabë, turq, etj., jo rrallë nuk tregohen të gatshëm për të punuar. Fëmijët, që kur lindin e derisa bëhen 18 vjeç paguhen nga shteti. Danimarka është shpallur disa herë *Vendi ku jetohet më mirë*.

Fizarmonika ka qenë përherë pasioni i Ahmetit. Ai ka luajtur kryesisht pjesë klasike, si uverturën *Berberi i Seviljes* të Rosinit, uverturën nga *Norma* e Belinit, *Marshin Turk* të Moxartit, *Fluturimin e Brumbullit* të Rimski Korsakovit, *Vallen e Shpatave* të Haçaturjanit, pjesë nga *Liqeni i Mjelmave* të Çajkovskit etj. Edhe sot e ka pasion fizarmonikën. Edhe pianon. Është pasioni për muzikën. Edhe sot Ahmeti rron me muzikën. Këtë e mëson po të rrish me të qoftë edhe për pak kohë. Me kënaqësi të flet për jetë kompozitorësh, për ngjarje, për momente dhe për suksese të jashtëzakonshme njerëzish të mëdhenj. Dhe ti vetëm e dëgjon dhe e dëgjon. Ahmeti flet bukur.

Dhe vishet bukur. Gjithnjë i qetë. Gjithnjë i paqmë. Gjithnjë dashatar i natyrës dhe i shëtitjeve në natyrë jashtë Tiranës. Dhe gjithnjë nostalgjik për fshatin e lindjes, për Sopotin. Por, edhe për Bulqizën e për Peshkopinë. Ahmeti, njeriu i muzikës, ka nostalgji edhe për festimet në fshat. Për Ditën e Verës, - kujton Ahmeti, - shumë herët në mëngjes, shkonin vajzat e fshatit te burimet dhe merrnin guralecë, degë thanash (te burimet kishte shumë thana) dhe barëra. I vinin në shtëpi në vende të caktuara dhe thoshin: Forcë, forcë si guri; kuq, kuq si thana; njomë, njomë si kullosa!

Ahmeti është i fortë si guri, i kuq si thana, i njomë si bari. Ky është Ahmeti: Njeriu që rron me muzikën. Ndonjë që nuk e njeh, le ta njohë e le ta takojë. Unë për vete e kam njohur që para 50 vjetësh, në kohën studentore, nga afër. Pak më përpara, por disi nga larg, në shkollën pedagogjike, kur te sheshpushimi i shkallëve nga oborri, Ahmeti argëtonte me fizarmonikë konviktorët pedagogjikas. E shihnim me respekt e me lakmi. Dhe që atëherë e kam mik. Sepse miku zgjidhet më i mirë se vetja.

Dhe tre nga 460 urime dhe 416 pëlqime
që më ngallën respekt e dashuri dhe ma shtuan jetën

"DY SHTATAT" E JETËS SIME...



Redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" i uron bashkëpunëtorit të saj, z.Abdurahim Ashiku edhe 100 vite, me mendjen e freskët dhe lapsin e "mprehur". Kontributi i tij në median e shkruar, sidomos atë që pasqyron ngjarjet në rajonin e Dibrës, do të mbetet një pikë referimi në të ardhmen. Shkrimet e tij janë plot fakte, ngjarje e ngjyra, përshkruar me realizëm dhe dashuri. Është një shembull dhe një shkollë që duhet të ndiqet nga brezat e rinj.

Atë vit jeta ime fillonte me "Dy njëshat" e një viti që gjëmonte në luftë dhe me "dy njëshat" e një muaji mbushur me lule, 11 Maj 1941...

Në "Dy njëshat" që erdhën, 11 vjeç (1952), jepja provimet e para të jetës sime, provime që do të mbyllnin ciklin e parë të hapave të mia drejt dijes, mbarimin e shkollës fillore në fshatin Brezhdan të Dibrës, një fshat i madh, me "treqind shtëpi" siç e quanin, fshat tokat e begata të të cilit zbrisnin brezareve drejt Drinit ku mësova të notoj...

Midis "dy njëshave" dhe "dy dyshave", më 8 maj 1957, vura emrin në një shkrim faqes të një gazete të kohës. Këtu do të niste jeta ime faqeve të mëdha të shtypit...

Në "Dy dyshat", 22 vjeç, vazhdoja studimet në Institutin e Lartë Shtetëror të Bujqësisë, Universiteti i Bujqësisë, siç quhet sot, shkollim që më dha një profesion jete dhe kënaqësinë për të punuar e jetuar në vendlindje...

Në "Dy treshat", 33 vjeç, 1974 i hyra me zell e dëshirë një pune që do të kthehej në profesionin e dytë të jetës sime, gazetar. Fillova punën në Agjencinë Telegrafike Shqiptare si korrespondent i saj për rrethet Dibër e Mat...

Në "Dy katrat", 44 vjeç, 1985, vazhdoja të "prashisja" në arën e madhe të gazetarisë. Gjithnjë në Dibër, bukuria dhe dashuria e jetës sime...

Në "Dy pesat", 55 vjeç, 1996 "Mora rrugën për Janinë", rrugë me një dhimbje të madhe në shpirt, me një mall që rritej për vendin ku kisha lerë, ku kisha bërë hapat e para në jetë, ku kisha vrarë gishtërinjtë gurëve të rrugës, ku kisha varrosur nënë e babë e kisha lënë vëllezër e motra...

Në "Dy gjashtat", 66 vjeç, 2007 vazhdova të "prashis" në një arë të madhe, vazhdova të shkruaj për mërgimtarët, jetën e vështirë në një tokë të huaj, për mësuesit vullnetarë që DritëroAgolli mi quajti "Rilindës të kohës sonë" e unë i përjetësova në 4 libra me rreth dy mijë faqe e më se 600 fotografi, nisa për të vazhduar serinë e 7 librave të mi me një titull të përbashkët "Njerëz që i dua"...

Në "Dy shtatat", sot 11 maj 2018, jam në këmbë, kam mall e dashuri për vendlindjen, për të gjithë, por në veçanti për dy djemtë dhe vajzën time, Altinin, Erblinën dhe Indritin, për nipërit dhe mbesat: Gurjonin, Ebin, Eralin dhe Ivonin e vogël 7 muajsh që më "flet" me buzëqeshje e unë fluturoj me të në krahë.

I vogli, Indriti, më 27 maj 2018 kurorëzohet në dasmë me bukuroshen nga Kuçova JonadaGjergo...

Me Natashën, shoqen time të jetës e të shpirtit, bijë e Hakiut dhe e Merjemes (Shehu), dibranë të qendrës së Dibrës së Madhe, më 11 gusht 2018 shënojmë 50 Vjetorin e Martesës. "Martesë e artë" e quajnë. Vërtet, MARTESË E ARTË ka qenë jeta me bashkëshorten time Natasha Ashiku, Shehu...

...

Mbase do të shkruaj edhe për "Dy tetat", rrethuar nga djemtë dhe vajzat, nga nipërit dhe mbesat, nga bashkëshortja ime e dashur, nga miq e dashamirë...

Abdurahim Ashiku
Athinë, 11 maj 2018

Përshëndetje

ME ATË TEMP E PËRKUSHTIM QË KA TË MOS RESHTË PËR ASNJË MOMENT KRIJIMTARINË E TIJ...

Me shumë kënaqësi dëshiroj të përcjell urime të sinqerta e pafund për shokun, kolegun e mikun Tim të kahershëm Abdurahim Ashiku për jetë të gjatë, të mirë e të shëndetshme me Natashen e mirë e familjen e shtrenjtë. Do të dëshiroja që me atë temp e përkushtim që ka të mos reshtë për asnjë moment krijimtarinë e tij në fushat që ai i ka aq shumë për zemër e që i zotëron me mjaft mjeshtri,si analizat,komentet,portretet e sidomos punën e lavdërueshme për dekada me artin e fotografisë.

Abdurahimi është i pashembullt për aktivitetin e tij, si intelektual me një krijimtari të pasur e me përfshirje të shumanshme, është i pashembullt për reagimin shpejt, në kohë e me thellësi për problemet e dukuritë që shqetësojnë shoqërinë tonë.

E falënderoj se po na sjell pandërprerë në memorie copëza të jetës tonë,me foto, me shkrime,me portrete njerëzish të punës e të përkushtimitqë bën gjithçka e më të mirën e mundshme në shërbim të popullit e Atdheut tonë. Me ta edhe ne të atij brezi. Ne nuk ndamë boten, nuk bëmë izolimin,tufëzimin e kooperativat. Ne u përpoqëm të bënim mirë ato që kishim në dorë në ato kushte qëvërtet ishin të vështira, të punonim me angazhim e përgjegjësi të lartë,me ndershmëri e seriozitet në shërbim të zhvillimit, përparimit e prosperitetit të vendit.

Abdurahimin e urojmë dhe e falënderoj edhe për ato përpjekje të mëdha që bën në mbështetje e inkurajim në përpjekje për mbajtjen gjallë e mësimin të gjuhës shqipe nga fëmijët e emigrantëve deri në ishujt më të largët të Greqisë,punë kjo që nuk po bëhet mirë këtu në Itali. Në mbështetje të kësaj pune ai i është përkushtuar e vazhdon përkushtimin me tërë forcën e pathosin patriotik e atdhetar që e karakterizon.

Jeta e Abdurahimit është mjaft aktive me një krijimtari të pandërprerë, një jetë intelektuale, më gjithëse në emigrim ndjen me merak e përgjegjësi fatet e Atdheut e tëpopullit të tij kudo ku jeton.

Shkrimi e urimet janë PA fund por më mbetet që edhe një herë t'i dërgojmë shume urime.

Përshëndetje!

NDUE KOLA, KOLEG PUNE
MË TË GJATA RRESHTAT NË INTERES TË DIBRËS DHE DIBRANËVE

Urime, vetëm gëzime paçi gjithmonë në jetën dhe familjen Tuaj.

Të përgëzoj për përpjekjet e pareshtura që bëni për të mbrojtur interesat e kësaj krahine dhe promovimin e vlerave të saj .

Një përgëzim për dashurinë pa kushte që i dhuroni Dibrës dhe dibranëve.

Një përgëzim tjetër se kurrë nuk dorëzoheni së shkruari dhe vepruari. "Duajeni dhe mbrojeni vendlindjen tuaj" megjithëse ata që duhet të dëgjojnë dhe veprojnë e kanë shurdhërinë në zemër.

Një përgëzim të fundit për qytetarinë dhe vlerësimin që keni për bashkëshorten dhe familjen Tuaj .

Dhe për mbyllje, jetë të gjatë të dhëntë Zoti, shtoji më të gjata rreshtat në interes të Dibrës dhe dibranëve, një ditë do të vlerësoheni si duhet, puna nuk humb kurrë.

LULZIM HOXHA
GJOVALIN LUMAJ, MIÇIGAN

ÇDO MOT,
ME ZEMRËN PLOT,
TË URON SË LARGU NXËNËSI JOT!

I nderuar profesori im,
Pranoni prej meje një urim.
Gëzuar ditëlindjen, jetë të gjatë,
Me shëndet 77.
Lexova me vëmendje 11, 22, 33, 44, 55, 66, 77,
Një jetë e bukur, dhe shumë e begatë,
Si bashkëshort, prind, edukator, gazetar,
I njohur në publikun Dibran e mbarë-Shqiptarë

Mirënjohje, respekt, nderim,
Mbetesh gjithmonë në kujtim,
Nga kujtime të pashlyeshme kohën mbrapa kthej.
Uroj të jetoni ku bashkohen dy 9-ta, e përtej..!

Çdo mot,
Me zemrën plot,
Të uron së largu nxënësi jot!

Atëherë ishim vetëm 15 vjeç

Nga **Destan RAMA**
Ish nxënës i Shkollës Pedagogjike

Tek po rrija atë mëngjes të 23 marsit pranë dritares së shtëpisë sime shihja se si fjollat e borës, jashtë fluturonin e silleshin vërdallë në ajër, në oborr dhe ashtu palë-palë binin në tokë.



Nuk kaloi më shumë se një gjysmë ore dhe ata ashtu duke rënë mbi njëra-tjetrën e zbardhën vendin, ia ndërruan pamjen natyrës, e veshën të gjithën në të bardhë. Ndërkohë mua mu kujtua ajo kohë e largët e maturës e viteve 1962-1963, kur ishim në shkollën e mesme pedagogjike "8 Nëntori" në Peshkopi. Edhe atëherë binte borë, bënte dimër, paçka se në kohën e vet. Bora binte njashtu si sot dhe ne rrinim të strukur pranë dritareve të konviktit, më së shumti, dhe atyre të klasës. Kur bënte ndonjë natë e ftohtë xha Veseli na ftonte të ngroheshim në mangallin e zjarrit që ai mbante vetë tek rrinte roje tek dera e shkollës. Konvikti është shtëpia juaj bijtë e mij,- na thoshte xha Veseli dhe na ftonte vazhdimisht te shkonim për tu ngrohur aty me ato thëngjij gjysmë të ndezur e të mbuluar me atë prushin e bardhë. Sa herë merrte mashën për ta trazuar ngriheshin ne ajër fjolla të bardha si ata të dëborës. Sonte bën ftohtë,- thoshte Latifi,- duhet t'i bashkojmë krevatnat dhe ne kështu bënim dhe i kalonim netët e ftohta. Të nesërmen ngriheshim, bënim tualetin e mëngjesit dhe shkonim në mensë e hanim bukën me atë qumështin e ngrohtë që na kishte përgatitur xha Shukriu me kolegët e tij. Pastaj me libra në duar shkonim në klasë. Në një kohë me ne vinin edhe shokët e shoqet që nuk ishin konviktorë. Disa prej tyre vinin nga jashtë qytetit. Kështu vinte Fadili nga Sohodolli, Samiu nga Brezhdani, Fatmiri nga Dohoshishti, Mensuri, Menduli e Xhevdeti nga Tomini dhe të tjerë nga qyteti. Në këto kushte dimërore ishim gati për mësim. Ne ishim matura e pesëmbëdhjetë e shkollës dhe si të tillë duhet të dalloheshim në këtë përvjetor shkolle. Dhe kështu bënim. Matura jonë dallohej në atë kohë jo vetëm në mësime, ku të gjithë u diplomuam si mësuesë të fillores, por shumica prej tyre dhanë mësim në ciklin e lartë të 8-vjeçares, biles dhe drejtues shkollash. Kontrubuti i tyre për mësimin dhe edukimin e brezit të ri qe në lartësinë e duhur. Asnjëri nga ne nuk e refuzoi vendin e punës, ku u emërua, qoftë edhe në zona të thella, apo dhe jashtë rrethit.

Krahas punës mësimore matura jonë u dallua edhe në veprimtaritë kulturore-artistike, sportive, gjë që e pati vazhduar gjatë gjithë viteve të shkollimit. Mbrëmjet e vallëzimit që zhvilloheshin atëherë ishin shumë mbresëlënëse e për të mos u harruar kurrë. Këto organizoheshin më shpesh në rang klase, po edhe shkolle, aty poshtë në sallën e mensës, në katin e nëndheshëm. Nuk mbaronin kurrë këtu barcoletat, ora gazmore, batutat recitimet etj.

(Vijon në faqen 22)

cyan magenta yelloë black

portret

Izet Dema, portreti i një njeriu që banorët e thërrasin "Doktor"

Nga **Osman XHILI**

FAMILJA DEMA, KONTRIBUTI ATDHETAR

Shumëkush do të donte ta kishte të vetën historinë e familjes së nderuar Dema. Rrënjët e saj shtrihen e marrin jetë në thellësi të shekujve, bile doktor Izeti ka bërë një pemë të familjes, të cilën e mban në murin e studios së tij. Ka shumë e shumë breza më parë, ku çdo brez u shqua për dhuntitë, vlerat, këmbënguljen dhe ndjenjën e patriotizmit, në shkallën e tij më të lartë, por si pikënisje të këtij mbiemri, ata i referohen Met Demës. Thuhet se Met Dema ishte njeri me shumë influencë dhe në kohën e Ali Pashait të Tepelenës, shkoi tre muaj, bashkë me treqind dibranë të tjerë. Në krye të tre muajve, pashai refuzon tu japë pagesën dhe Meti vetë futet te ai. Miqtë e tij besnikë, prisnin jashtë për çdo situatë. Më së fundi, Ali Pashai, kur sheh që dibrani nuk shqitej lehtë, detyrohet ti japë paratë e premtuara, bile ca më tepër. Ali pashai i thotë: "Metë qenke, Metë qofsh, vetëm gjatë mos rrofsh".

Por duket që duaja e Pashait nuk e zuri Metën, pasi ai rrojti mbi 100 vjeç. Me paratë e fituara bleu katër çifligje, në Shushicë, në Allajbegi, në Kurbeg dhe në Cankë. La pas katër djem, ndër ta Hazis Demën e parë. Ky burrë trim, bashkë me Cen Lekën dhe Sali Markën, morën peng Hysni Pashën në vitin 1844. Veprën e të atit e pasoi Hazis Dema i dytë, apo i riu. Ai mori pjesë bashkë me parinë dibrane dhe u shqua në luftën ndaj forcave turke, në vitin 1878, në mbrojtje te trojeve kombëtare. Kënga popullore hiperbolizon veprën e tij trimërore: Hazis Dema, i shkurt', i zi / Shembi malet, ra në Dri.

Kontributi patriotik i familjes Dema, vazhdon e nuk ka të sosur. Hazis Dema i dytë, la Izet Demën, i cili ndoqi rrugën e të parëve të tij, duke i çuar më lart vlerat e brezave pararendës. Në luftërat e vitit 1912, kundër shovinistëve, që donin të copëtonin Shqipërinë, Izet Dema bie heroikisht në Follorinë të Greqisë. Varri i tij nuk dihet, por kënga e përjetëson dhe e ngre në altarin e njerëzve, që aq shumë e deshën atdheun, duke i falur gjakun dhe jetën e tyre.

Thajri Izeti dhe njëherë, /çohuni burra, se u bëmë sejr / s'kemi ardhë'me u turpëru' / po kemi ardhë për me luftu / e prej hasmit, ja me vdekë, ja me shpëtu.

Ai vdiq dhe la vetëm një djalë, Zabitin. Ai ishte i pasionuar pas bujqësisë. E





donte dijen dhe shkollën. Ndiqte rrugën e të parëve dhe ishte besimtar në rrugën e Zotit. Ai planifikonte projekte të reja në mendje, por dhe regjimi komunist, që sapo ishte instaluar bënte planet e tij, të godiste familjet e mëdha. Në vitin 1946 Sabit Dema arrestohet dhe dënohet me 20 vjet, nga të cilat vuajti gjysmën e dënimit. Akuzat diheshin, sabotim i pushtetit popullor. Ishte kjo një çertifikatë mirënjohje për shërbimet e paçmuara, që familja Dema i kishte bërë këtij vendi. Ishte ky shpërblimi, për luftërat e bëra, për pasurinë e harxhuar dhe gjakun e derdhur. Kjo hije, kjo "njollë" në biografi, do ta shoqëronte familjen për gati një gjysëm shekulli.

DOKTOR IZETI, GJITHMONË NË SHËRBIM TË NJERËZVE

Sabiti pati tre djem, Hazizin, Baudinin dhe Izetin. Në vitin 1965, më i vogli, Izeti, mbaron politeknikumin mjekësor, në Tiranë. Ndoshta ishin vite të hershme dhe pak njerëz i kishin sytë te shkolla, ndoshta ishte miqësia e babait me Selim Alliun dhe Haki Pahumin, që e bënë të mundur shkollimin e djaloshit. Në atë kohë ndihmës mjekët duhej të bënin dy vjet stazh në terren, për të shkuar më pas në shkollën e lartë. Doktor Izeti filloi punë në Selishtë, për një vit. Më pas transferohet pak më afër, në Fushë Alie. Kur po mbaronte viti i dytë i punës, bëri dokumentet për shkollën e lartë. Nuk u aprovuan. I përsëriti pas një viti, po e njëjta gjë. Sa herë mbaronte një vit, ai bënte dokumentet e shkollimit, deri në vitin 1988, për mbi 20 vjet dhe përgjigja ishte gjithmonë e njëjtë: nuk fiton.

Kështu rrugëtoi doktor Izeti, në ato vite të vështira, afër katër vite në Fushë Alie, një në Melan, dy në Maqëllarë, 18 vite në Dovolan dhe 20 të tjerë në pikën doganore të Bllatës, si inspektor i karantinës. Në vitin 2011 del në pension, duke shërbyer jo pak, por në një total prej 46 vitesh.

Gjatë gjithë këtij rrugëtimi të gjatë, ai pati e vazhdon të ketë një aleat, pa të cilin shumë gjëra do të kishin mbetur të mangëta. Kur hija e biografisë i qepej nga pas, si hija në ditë me diell, kur qielli i shpirtit rëndohej nga retë e së keqes, kur ai frikej se nuk kishte mjaft të ardhura për të shkolluar fëmijët, Shpresa, bashkëshortja e tij i gjendej pranë, si balsami qetësues. Ashtu të dy bashkë ishin më të fortë, si dy duar të bashkuara, që ndihmojnë njëra-tjetrën. Shpresa mbaroi të njëjtën shkollë si doktor Izeti, Politeknikumin mjekësor në Tiranë. Njësoj si i shoqi shërbeu, për mbi dyzetë vjet dhe tani që të dy janë në pension. Ata kujtojnë ato vite të lodhshme, kur për ta nuk kishte një minutë të lirë. Nuk kishte natë, kur pas punës së lodhshme të ditës, porta trokiste dhe njerëz hallexhinj të zonës, tregonin problemet që kishin. Nuk ishte në natyrën e doktor Izetit të thoshte jo. Ai vishej e mbathej, merrte çantën në dorë dhe zhdukej në errësirën e natës, bashkë me njeriun që e kish kërkuar. Nëse ishte problem për gratë do të shërbente Shpresa. Sa e sa bekime dhe urime të pafund dilnin nga gojët e njerëzve që përfitonin shërbimet e tyre. Dilnin nga gojët e tyre, por në fakt buronin nga zemrat e tyre.

Kështu, me shumë lodhje e përpjekje të panumërta, ata rritën dhe shkolluan më së miri, tre fëmijët e tyre, dy djem e një vajzë. Arta mbaroi dy fakultete, për biologji dhe ekonomi. Sot punon e jeton në Tiranë, bashkë me familjen e saj. Almiri ka mbaruar për ekonomi dhe prej vitesh punon në doganën e Bllatës. Më i vogli, Sabiti, që mban emrin e gjyshit, jeton e punon në Tiranë. Ka mbaruar, si motra dy fakultete, për biologji dhe mjekësi. Ka punuar në kolegjet turke si mjek dhe si profesor i biologjisë. Aktualisht është nëndrejtor i medreseve të Tiranës. Ja kështu Sabiti i ri, që mban emrin e gjyshit, e çoi në vend dëshirën e tij, dëshirën dhe dashurinë e gjyshit për shkollën dhe diturinë.

Doktor Izeti trashëgoi shumë gjëra nga i ati, Sabiti, krenarinë, sedrën, dashurinë për punën, për dijen, për besimin në Zot. I ati kishte një dëshirë të madhe për pemët. Ai pati marrë që nga Serbia fidanë të llojeve të ndryshme dhe i mbolli pranë shtëpisë së tij. Mollë, dardhë, ftonj, qershi, si dhe një dynym vreshtë, me kultivarë të zgjedhur. Pas viteve nëntëdhjetë, kur toka u muar në pronësi, doktor Izeti, mendoi ta ndjekë traditën e bukur të babait, duke filluar me tre dynymë mollë. Shumë shpejt i mori frutet e tyre, duke u bërë një ndihmesë e çmuar për familjen.

PASIONI PËR PEMËT

Doktor Izeti trashëgoi shumë gjëra nga i ati, Sabiti, krenarinë, sedrën, dashurinë për punën, për dijen, për besimin në Zot. I ati kishte një dëshirë të madhe për pemët. Ai pati marrë që nga Serbia fidanë të llojeve të ndryshme dhe i mbolli pranë shtëpisë së tij. Mollë, dardhë, ftonj, qershi, si dhe një dynym vreshtë, me kultivarë të zgjedhur. Pas viteve nëntëdhjetë, kur toka u muar në pronësi, doktor Izeti, mendoi ta ndjekë traditën e bukur të babait, duke filluar me tre dynymë mollë. Shumë shpejt i mori frutet e tyre, duke u bërë një ndihmesë e çmuar për familjen. Vite më vonë, një sëmundje, ajo e zjarrit bakterial, preku bllokun e mollëve dhe ai mendoi ti zëvendësojë. Në vend të tyre, sot gjen gështenja greke, të shartuara, që tashmë kanë hyrë në prodhim.

Një hektar me arra, doktori i ka mbjellë, vite më parë dhe sot janë në fillimet e prodhimtarisë. Vite më vonë dhe në një vit të mbarë, prodhimi i tyre mund të shkojë mbi 100 kv, duke qenë një burim i konsiderueshëm të ardhurash për familjen. Në pronën e doktor Izetit gjen lajthi, që janë mbushur plot me boçe frutash, ka perime të ndryshme, domate, kastravecë e bostan. Aty para shtëpisë, nën hijen e blinave, ka dhe një park me rreth 25 bletë, që i japin gjallëri e bukuri të veçantë gjithë oborrit.

Ja kështu, të ngarkuara me punë, rrjedhin ditët, në jetën e doktor Izetit, që i ka kaluar të shtatëdhjetat. Në disa raste përmenda për të titullin e doktorit, kur thamë që nuk u lejua për mbi 20 vite të vazhdojë shkollën e lartë. Unë do të vazhdoj ta thirri në këtë mënyrë, gjithë komuniteti e quan kështu. Puna, vepra, sjellja, shërbimi gati 50 vjeçar, ia kanë dhënë plotësisht këtë titull, që disa u përpoqën t'ja mohojnë për shumë kohë.



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Rruga e Arbërit nr. 145

“Ishte nga gjaku i shqiptarëve dhe ishte i gatshëm ta derdhte atë gjak për tokën shqiptare”.

shënime

Shënimet e kronistëve *dhe historianëve osmanë,* *për Skënderbeun* **dhe FAMILJEN KASTRIOTI**

Nga **Ilmi VELIU**

Veprat e kronistëve dhe historianëve të hershëm osmanë, ndonëse janë shkruar nga autorë që në shumicën e tyre ishin historiografë zyrtar e që mbanin një pozitë armiqësore ndaj shqiptarëve, jemi të detyruar të pranojmë se në shumë drejtime ata na japin të dhëna me një vlerë shumë të madhe sa i përket Skënderbeut, Kastriotëve dhe origjinës së tyre shqiptare, të cilat te dhëna nuk i hasim në burimet e autorëve tjerë jo osmanë. Autorët e këtyre veprave, megjithëse nga njëra anë vënë në dukje sulltanët dhe komandantët turq si figura që kanë luajtur rolin vendimtar në zhvillimin e ngjarjeve, nga ana tjetër duke shkruar në bazë të kujtimeve të veta ose të tregimeve të atyre që i kanë jetuar ngjarjet, zgjerojnë rrethin shoqërorë të pjesëmarrësve në këto ngjarje dhe japin njoftime shumë të sakta edhe për heroin kombëtar të shqiptarëve Skënderbeun, po edhe për masat popullore shqiptare.

1. ORUÇ BIN ADIL.

Është autor i njërës nga historitë më të vjetra të shtetit osman “Tevari el Osman”, (Historitë Osmane). Dorshkrimet e Oruçit, të gjetura në Oksford dhe në Kembrixh janë botuar nga Franc Babinger “Die Fruhosmanicshen Jaherbucher des Urudsch”, Hanover 1925. E para është një histori në formë të përmbledhur (Icmai tarihi), kurse e dyta është e hollësishme (Mufassal tarihi).

Uruç bin Adil kur shkruan për betejat e shumta kundër Skënderbeut, në faqe 96 të veprës së tij nuk e përmend Rumelinë, si që quhej pjesa evropiane e Perandorisë Osmane por potencon shumë kjartë se sulltani shkoi të luftonte kundër Iskendert që kishte ngritur krye në tokat shqiptare, ose vendin e shqiptarëve (Arnavud ilinden) dhe jo në Greqi, Maqedoni ose në Serbi.

Në faqe 115, tokat shqiptare Oruç i përmend edhe si Vilajeti i Shqiptarëve (Arnavud Vilajetine). Ai thotë se “Ali Beu, i biri i Evrenoz Beut mblodhi ushtrinë dhe akinxhinjtë e Rumelisë dhe hyri në vilajetin e shqiptarëve, për të luftuar kundër Iskenderit…”. Në faqe 121 thotë se “Sulltan Murati II dërgoi akinxhinjtë kundër vilajetit të shqiptarëve për të pushtuar kështjellën e Sfetigradit. Sundimtari shqiptar Iskenderin nuk e gjetën…”. Në origjinal është “Arnavud begi Iskender” ku potencohet shumë qartë se Iskenderi ishte sundimtari i shqiptarëve dhe jo i serbëve, bullgarëve, grekëve, boshnjakëve, hungarezëve, popuj të cilët po ashtu ishin në luftë me sulltanin në kohën e Skënderbeut. Në faqe 123, Oruç potencon se “Sulltan Murati II zbriti në Vilajetin e Juvanit (Gjon Kastriotit), e plaçkiti Vilajetin shqiptarë, dhe sulmoi Krujën (Akçe Hisar), por nuk mundi ta pushtonte atë”. Nga kjo kuptojmë se përveç “Juvan Ili” (tokës së Gjonit ose vilajetit të Gjonit) ka pasur edhe principata tjera shqiptare e që përmenden si Vilajeti i Shqiptarëve (arnavud vilajeti).

2. KRONIKAT ANONIME OSMANE.

Është fjala për veprën me titull “Tevarih El Osmaan” e cila përmbledh një numër të shumtë kronikash anonime të shkruara në fund të shek. 15 dhe fillimi i shek. 16. Këto kronika janë analizuar dhe botuar nga Franc Giese, me titull: “Die altosmanischen anonymen Chroniken”, 1922, Bruksell. Në faqe 65 të kësaj vepre përmendet principata e Gjon Kastriotit si tokë shqiptare ku thuhet se: “Sulltan Murati II… bëri një luftë të shenjtë dhe të madhe ku sulmoi tokat dhe kështjellat e Gjonit. (Endene Juvaan Ilerin ve kahlerin fetëhun Etedin).



Portret i Skënderbeut gjetur në Bibliotekën Universitare të Leipzig i periudhës 1551-1750

Në vazhdim ne faqe 66 thuhet se Ali Beu, djali i Evrenoz Beut sulmoi dhe grabiti Vilajetin e shqiptarëve. Edhe kronikat anonime osmane, Skënderbeun e quajnë si “Sundimtar shqiptar”. Ja se çka thonë kronikat në faqe 70: “Sulltan Murat Hani kreu një fushatë kundër tokave të Juvanit (Gjonit) dhe vilajeteve tjera të shqiptarëve. Ai pushtoi kështjellën e Sfetigradit. Pushtoi pastaj edhe dy kështjella tjera. Sundimtari shqiptar- Iskenderi nuk u pa se ku ishte”. Kronikat kur flasin për sulmet e viteve1450, 1466, 1467 dhe rrethimet e Krujës , janë shumë decide dhe të qarta se lufta është bërë kundër shqiptarëve të udhëhequr nga sundimtari i tyre shqiptar – Iskenderi.

Në faqe 125 thuhet se “shqiptarët në tokat e tyre kishin ngritur kulla në vendet e thepisura dhe në majat e maleve. Rrugët ishin aq të pakalueshme sa edhe sorrat nuk mund të fluturonin mbi to. Bile edhe djalli me shkop nuk do të mund të hynte në tokat e tyre”. Qëllimi im është që të hedh poshtë pohimet e disa historianëve sllavomaqedon, serbë e grekë, se Skënderbeu ishte me origjinë sllave. Autorët që unë i kam analizuar e potencojnë qartë origjinën e tij dhe se ai ishte komandant shqiptar dhe mbret i Shqipërisë.

3. ASHIK PASHA ZADE.

Është një nga kronistët e hershëm osman i cili jetoi gjatë shekullit 15. Veprën e tij e ka botuar Ali Beg , me titull “Ashik Pashazade tarihil Osman”, Istambull 1332 hixhri.

Për këtë kronist ka shkruar edhe Sami Frasheri në Kamusul al-lam, vl, IV. Në faqen 63 të veprës së tij Pasha Zade thotë se njeriu që e vrau Sulltan Muratin I – quhej Milush Kuble ose Bilush Kuble, e jo Milosh Obiliq

Ata që e kanë parë vendin e shqiptarëve e kanë ndjerë fortë ashpërsinë e ati vendi… Ndërsa për ata që nuk e kanë parë, mjafton që të dinë se në atë vend plotë rebelë, me shtigje të fshehta dhe gryka hyrjeje e daljeje të vështira për tu kaluar, nuk ka mundur të depërtojë si që thonë as Aleksandri i Madh.

si që e kanë emëruar serbet dhe nuk e cek përkatësinë kombëtare, por thotë se ishte një i pa fe nga tobori kundërshtar i osmanëve. Faqe 124-125, thotë se: “Isa Beu hyri në vendet e padepërtueshme të shqiptarëve dhe prej andej bënte sulme. Ndërkaq ata i ja bllokuan rrugët. Një arnaut i pa fe me emrin Iskender që ishte ‘i biri i sundimtarit shqiptar’, që kishte qenë ‘içogllan’ i sulltanit dhe tash kishte ngritur krye kundër tij, dhe ua kishte bllokuar rrugën akinxhijëve”.Pra, Ashik Pasha Zade jo që e dokumenton në kronikën e tij se Iskenderi ishte shqiptar, por ai informon se ai ishte i biri i një sundimtari të shqiptarëve. A ka argumente më të forta historike se sa këto të dhëna që na jep Pasha Zade e që Petar Poposki dhe disa autorë tjerë serbë që shkruajnë për përkatësinë kombëtare të Skënderbeut, nuk i kanë lexuar ose nuk dëshirojnë ti lexojnë dhe të binden se ai ishte shqiptarë dhe bir shqiptari. Argumentet janë edhe më të forta kur kihet parasysh se këto fjalë i thotë një autor osman dhe nuk i thotë nga dashuria që ka pasur ndaj Skënderbeut por nga urrejtja.

4. MEHMET NESHRI.

Ka qenë një poet shumë i njohur i kohës së Sulltan Selimit I. Vepra e tij e shkruar në vargje titullohet “Cihan Numaa”, (Treguesi i Botës), analizuar dhe botuar nga Franc Taechner, me titull “Die altosmanischen Hroniken des Mevlana Mehmet Neschri”, Lajpsig 1951. Në faqe 71 të veprës së tij, Mehmet Neshri tregon për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës. Ai thotë se: “Llazarit i shkuan në ndihmë hungarezët, vllehët, çekët shqiptarët dhe bullgarët.

Faqe 79: …ndër ta ishte një i pa fe me emrin Jorgji (Gjergji i II Ballsha) i cili kishte 90 mijë ushtarë. Kur Lazari tha që turqit të sulmoheshin natën ai tha: “O zotëri, më mirë ti sulmojmë në mëngjes dhe të gjithë ti kapim të gjallë”. Ushtria e Llazarit kishte pirë aq shumë raki sa që të gjithë ishin të dehur kur hynë në luftë. Shumica e dijetarëve mendojnë se këtu është fjala për Gjergjin e II Balsha, kurse Johan Von Hammer mendon se është fjala për gjyshin e Skënderbeut ose babain e Gjonit sipas të cilit, emrin e ka pasur “Gjergj Kastriori” dhe jo “Pal Kastrioti” si që e përmendin disa autorë, dhe se emri “Gjergj” që e ka pasur Skënderbeu ka qenë emri i gjyshit të tij. Në kapitullin e veprës së Neshriut “Lufta me shqiptarët” (gazaul arnevud) faqe 201 thuhet se Iskenderi, sundimtari shqiptar (Iskender arnavud begi oglu idi) e tradhtoi padishahun. Pastaj, truri i tij i brumosur me djallëzi e bëri atë që të jepej pas ngatërresave. Ai si hakmarrje, shkoi dhe grabiti shumë bagëti të osmanëve në malet e Tetovës (Kallkandelen). Kur sulltani iu drejtua vendit të shqiptarëve, Iskenderi u arratis nga Durrësi në drejtim të frengut (Italisë). Është fjala kur Skënderbeu shkoi në Itali për të kërkuar ndihmë dhe disa burime osmane atë e paraqesin si ikje të tij që të shpëtonte kokën. Më duhet të potencoi edhe njëherë thënien e Neshriut “Iskender arnavud begi” Skënderi, begu shqiptar.

5. DURSUN BEG.

Ka jetuar gjatë sundimit të Mehmetit II. Vepra e tij titullohet “Tarihi ebul Feth” (Historia e Babait të pushtimeve) e botuar nga Mehmet Arif, Istambull, 1914. Në faqe 123, ai thotë: “…Nga një anë tjetër popullsia mosmirënjohëse shqiptare u hodh vende-vende në kryengritje dhe guxoi të hynte në luftë, e udhëhequr nga kryeneçi Iskender. Pastaj vazhdon duke thënë se shqiptarët gjithmonë janë shkelmuar prej potkonjve të kuajve të kalorësisë perandorake.

Faqe 132: “Mbasi sulltani u hakmuar kundër frengjëve dhe hungarezëve, u preokupua të zhdukte nga rrënjët shqiptarët mosmirënjohës të udhëhequr nga arnauti Iskender…” Por ata zunë shtigjet e maleve dhe të luginave të rrezikshme. Nga që ishin tepër të këqij, ata rezistuan me kokëfortësi dhe me tërbim të madh…”

Faqe 135: Ata që e kanë parë vendin e shqiptarëve e kanë ndjerë fortë ashpërsinë e ati vendi… Ndërsa për ata që nuk e kanë parë, mjafton që të dinë se në atë vend plotë rebelë, me shtigje të fshehta dhe gryka hyrjeje e daljeje të vështira për tu kaluar, nuk ka mundur të depërtojë si që thonë as Aleksandri i Madh.

Faqe 136: Arnauti, Iskender tradhtari i cili qysh si fëmijë ishte rritur në pallatin mbretëror, iku dhe pëlqeu rrugën e kryengritësit. Ai shkoi dhe u tha shqiptarëve, “unë jam djali i sundimtarit tuaj…”.

Pra ky është edhe një kundër-argument për ata që thonë se Skënderbeu ishte me origjinë sllave. Kjo që përmendëm është e shkruar nga penda e kundërshtarit të Skënderbeut, dhe ai nuk thotë serbi, bullgari, sllavomaqedoni, por thotë “Arnauti, Iskender tradhtari”. Dhe emri Arnaut përdorej nga turqit vetëm për shqiptarët, e që rrjedh nga emri arbër. Pra grekët nga Arbër- Arvanitis, serbët nga Arbër-Arbanas dhe osmanët nga Arbër-Arnavut.

6. IDRIS BITLISI.

Në vitin 1501 emigroi nga Persia dhe u punësua në oborrin osman ku ndenji gjatë gjithë jetës. Vepra e tij titullohet “Hesht Bihisht” (Tetë parajsat) dhe është e shkruar në Persisht. Për këtë autor kanë shkruar Hoxha Sadedini, në veprën e tij “Tacut tevarih”, Sami Frashëri, në veprën e tij ” Kamusul Allam dhe Katip Qelebi në “Keshfys-zunun”. Idris Bitlisi në filim përmed tokat e Karlit (Karli Ili) pra tokat e Karl Topisë. Pastai kur permend sundimtarin e serbëve, Llazarin ai në faqe 188 të veprës së tij përmend edhe sundimtarin e Shkodrës shqiptare, Jorgji (Gjergji i II Ballsha) i cili në një rast thotë se “Jorgji i kishte vrarë komandantit osman, Lala Shahinit 10-15 mijë ushtar.

Në vazhdim autori në mënyrë të drejtpërdrejt thotë se : “Shqiptari Iskender, i cili qe ngarkuar me detyra nga sultani, ishte një nga më të besuarit e më të shquarit, ndër personat



Portret i Skënderbeut në "Historia de Vita et Gestis Scanderbegi" botuar në Romë më 1510. Autor i veprës letrare është Marin Barleti ndërsa autor i këtij portreti është Bernardino Vitali/

e zgjedhur, që mbaheshin në shërbim të sulltanit. Do të thotë se ka qenë e njohur se Iskenderi ka qenë shqiptarë edhe në kohën kur ai ishte në oborrin e sulltanit, para se të kthehej në Krujë dhe qëndronte në krye të shqiptarëve. "...Kurse ata shqiptarët si shpendët grabitës, domosdo janë nga natyra trima e guximtarë sa s'ka se ku të vejë më". Faqe 127: Një nga shërbëtorët e sulltanit arnauti Iskender, që kish qenë rritur që fëmi me të mirat e Padishahut që kish gëzuar gjithmonë kujdesin, shpirtmadhësinë dhe ledhatimin e pakufizuar, i shtyrë nga lakmia që të bëhet mbret i Shqipërisë, bashkë më një grup intrigantësh u larguan nga selia e lumturisë. Si që shihet këtu autori na jep të dhëna direkte se vetë Iskenderi ka pretenduar se ka origjinën nga ajo tokë shqiptare dhe se ati i ka takuar që të kthehej atje dhe të bëhej mbret dhe udhëheqës i tyre.

7. KEMAL PASHA ZADE.

Ka qenë i biri një komandanti të njohur të sulltanit, Sulejman Celebi, i cili komandant ka marrë pjesë në pushtimin e Konstantinopolit. Edhe vepra e tij titullohet "Tevarih el Osman" (Historitë Osmane) Për këtë autor shkruan edhe Sami Frasheri në Kamusul Allam, vl.V. Në faqe 279, autori thotë se: "Në vendin e shqiptarëve doli në skenë një njeri prej një fisi të vjetër mbretërorë, një ngatërrestarë dhe turbullues i njohur me emrin, i biri i Juvanit, emri i të cilit ishte Iskender.

Autorët sllavë që kanë shkruar bashkë me disa gazetarë shqipfolës, që edhe sot shkruajnë se Skenderbeu ishte me origjine sllave duhet ta kuptojnë se ai i hoqi nga krahu të gjitha gradat osmane dhe iku e shkoi në Shqipëri, ose shkoi dhe u ba mbret i Shqipërisë dhe i shqiptarëve e nuk thonë se iku dhe shkoi në Serbi Greqi ose Bullgari që të bëhet mbret i tyre. Është e natyrshme që secili kthehet për të luftuar dhe për ti dalur zot tokës që e ka lindur dhe as-sesi në tokë të huaj. Vetë autorët osmanë e vërtetojnë se ai ishte nga gjaku i shqiptarëve dhe ishte i gatshëm ta derdhte atë gjak për tokën shqiptare.

Faqe 280: tradhtia e tij kriminale u bë e famshme kudo dhe të gjithë ne (Perandorinë Osmane) e thirrnim me emrin tradhtari arnaut Iskenderi. Ai shkoi dhe me lehtësi hyri në vilajetin e të atit të tij, i cili në vendin e shqiptarëve njihet me emrin nahija e ashpër e tokave të Juvanit. Populli i atij vendi e pranoi dhe iu nënshtrua, duke thënë së ky është djali i sundimtarit tonë. Në këtë mënyrë pushtoi vendin e sipërpërmendur dhe u bë mbret i shqiptarëve.

8. HOXHA SADEDINI.

Është një nga historianët më të dëgjuar osman, i cili ka marrë pjesë edhe në punët shtetërore. Vepra e tij titullohet "Tacuttevarih" (Kurora e historive) dhe më së shumti përmendet si "Hoca Tevarihi". Ajo që neve na lë përshtypje është shkrimi i tij për Skënderbeun në faqe 351, ku thotë se: "Sundimtari shqiptar kishte një djalë të pashëm që quhej Iskender, figura trupore e të cilit të frymëzonte dashurinë, ndërsa fytyra e tij tërheqëse ishte shprehëse e bukurisë dhe e hirësisë së tij. Ai e dërgoi Iskenderin në kryeqytet për të konfirmuar nënshtrimin e tij ndaj sulltanit. Është shumë interesant dhe rast shumë i rrallë që dikush nga autorët osmanë ta përshkruaj në këtë mënyrë pamjen fizike dhe bukurinë e Skënderbeut. Jo se ky autorë ka pasur ndonjë simpati por ai e ka thënë të vërtetën, pra ashtu si që është dukur Skënderbeu.



Portreti i parë zyrtar origjinal i Gjergj Kastrioti Skënderbeut në një miniaturë të vendosur në kodin "De Romanorum Magistratibus" të shkruar nga Andrea Domenico Fiocco publikuar më 5/11/1465.

9. ALI MUSTAFA BIN AHMED

.

Ka shërbyer si sekretar i këshillit (Divan Katibi). Vepra e tij historike titullohet "Kunhul Ahbar" (Bërthama e lajmeve) Se Skënderbeu ishte me origjinë shqiptare, Ali e dokumenton në faqe 76 kur flet për Hamza Kastriotin dhe thotë se: Hamza beu ishte i nipi i Iskenderit të shqiptarëve." Pra ai vërteton se Iskenderi ishte i shqiptarëve dhe jo i ndonjë kombi tjetër si që pretendojnë disa nga të ashtuquajtur historianë serbë ose sllavomaqedonë. Në vazhdim Ali tregon se: "Nga prijësit e vjetër kokëfortë e inatçi, me trupa divash, që ishin grumbulluar në disa kodra e vende të çuditshme, të pa depërtueshme...."

Në faqe 124 , Ali e përsërit edhe njëherë se Iskenderi ishte shqiptarë dhe thotë: "Një njeri i pa vlerë nga fisi shqiptar (arnaut) i quajtur me emrin tradhtari Iskender, i cili pasi u rrit dhe edukua në oborrin e sulltanit, doli jashtë dh mori rrugë të shtrembët..Ky djalë që ushqeu tradhtinë dhe intrigën ishte i biri i njërit prej banditëve të famshëm të asaj popullsie të keqe. Këtu e ka fjalën se ai ishte i biri i sundimtarit të më hershëm të shqiptarëve Gjon Kastriotit ku autorët osmanë e shënojnë si Juvan Kastrioti, ose principatën e Kastriotëve si "Juvan Ili" që do të thotë toka e Gjonit.

10. SOLKZADE.

Është njëri nga historianët osmanë të shek. XVII. Vepra e tij titullohet si "Fihrist Shahan" , por sot më së shumti njihet si "Tarihi Sollakzade" (Historia e Sollkazades).

Ai në faqe 43 përmend pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës, por në faqe 168 ai e përshkruan edhe pamjen fizike të Skenderbeut ku thotë se "...Pamja fizike e këtij njeriu të bukur të çlodhë sytë, kurse fytyra e tij tërheqëse të jepte një kënaqësi të madhe. Pastaj më poshtë vazhdon ndryshe: "Ai sojëkeq dhe fatëzi i harroi mirësitë e padishahut dhe i kthehu shpinën atij. Kur ky lajm u muar vesht nga mbreti, ai dërgoi ushtri kundër tij dhe vendit të shqiptarëve, nën komandën e Isa Beut. Kryengritësi i lartpërmendur nuk u kap dot dhe një kohë të gjatë u fsheh nëpër male të egra të Shqipërisë".

11. MYNEXHIMBASH.

Është historian i shek. XVII. Vepra e tij titullohet "Sahaful ahbar", e botuar nga Nedim Ahmet, me titull "Mynexhimbashi Sahaful ahbar", Istambull 1285 h.

Në faqen 352 autori i përsërit të dhënat që i përmendëm edhe tek autorët tjerë më lartë. Me siguri se ai gjatë shkrimit të historisë së ti është mbështet tek këta autorë. Ai përsërit se Iskenderi ishte i biri i Juvait, sundimtarit shqiptar dhe se ishte rritur në oborrin e sulltanit. Kishte qenë i emëruar nga sulltani si zëvendës i të atit në tokat shqiptare. Pastaj e tradhtoi sulltanin dhe iku në Shqipëri dhe ngriti krye kundër sulltanit.

* * *

Pra, autorët sllavë që kanë shkruar bashkë me disa gazetarë shqipfolës, që edhe sot shkruajnë se Skenderbeu ishte me origjine sllave duhet ta kuptojnë se ai i hoqi nga krahu të gjitha gradat osmane dhe iku e shkoi në Shqipëri, ose shkoi dhe u ba mbret i Shqipërisë dhe i shqiptarëve e nuk thonë se iku dhe shkoi në Serbi Greqi ose Bullgari që të bëhet mbret i tyre.

Pra është e natyrshme që secili kthehet për të luftuar dhe për ti dalur zot tokës që e ka lindur dhe as-sesi në tokë të huaj. Vetë autorët osmanë e vërtetojnë se ai ishte nga gjaku i shqiptarëve dhe ishte i gatshëm ta derdhte atë gjak për tokën shqiptare.

BOTIMET HISTORIKE TË STUDIUESIT DHE HISTORIANIT MATJAN



Po të shfletosh ne gazeta të ndryshme gjen emrin e autorit dhe studiuesit z. Ferit Këputa. Megjithëse aktualisht 83-vjeç ai nuk e ndjen fare plakjen por vazhdon të jetë një studies i zellshëm i historisë krenare të Matit e me gjerë. Në çdo kohë, po t'i shkosh për vizitë në shtëpi, e gjen duke studiuar dhe me shumë dokumente mbi tryezë. Ai është mikpritës dhe bujar dhe për në çdo pyetje që mund t'i bësh mbi fushën e historisë, është i gatshëm dhe i pasionuar të japë një përgjigje të saktë.

Botimi i tij i parë është "Mati në shekullin e XX", botuar në vitin 2000. Po këtë libër e riboton në vitin 2002, duke e plotësuar me të dhëna dhe fakte të reja. Po në këtë vit boton librin "Ismail Terziu Shqipe Mali" dhe një vit më vonë "Arsimi e kultura në Mat".

Të gjitha botimet e tij janë të lidhura me Matin, nga të gjitha fushat. "Shërbimi Shëndetësor në Mat" (2005), "Vëndorigjina e Kastriotëve është Mati" (2007), "Matjanët në Luftën e Dytë Botërore" (2007), "Mati dhe Skënderbeu" (2010), "Mati në kulmet e historisë Kombëtare" (2012). Në 2015 përgatiti sesionin shkencor me rastin 610 vjetorit të lindjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeut. Këtë viti botoi librin e 11-të, "Laçi, Bruçi dhe Uraka" ku tregon historikun e krahinës së ti, ku lindi dhe u rrit.

Së fundmi, i urojmë jetë të gjatë dhe shëndet të plotë, mendja dhe dora e tij mos pushofshin kurrë në dobi të historisë dhe trevës se popullit të Matit dhe më gjerë.

Renato Totraku

Ky takim dhe promovim u bë një kujtesë për Naim Plakun, si një poet, mësues dhe folkloristi më i njohur, që fali gjithë jetën për kulturën dibrane.

Promovohet libri **“Dritëhijet e një poeti”,** monografi për Naim Plakun

Ditën e shtunë meë datë 19.05.2018, në Pallatin e Kulturëa Kamëz, u mbajt veprimtaria promovuese, e librit Dritëhijet e një Poeti, të shkruar nga shkrimtari Shaqir Skarra. Kjo monografi i kushtohet Poetit të këngës dibrane, shkrimtarit, kluturologut dhe folkloristit Naim Plaku, në prag përvjetori të katërt të ndarjes së tij nga jeta.

Fjalën e parë përshëndetëse e hapi redaktori i librit dhe studiuesi, Dr. Fejzullah Gjabri. Ndër të tjera Gjabrit shpreh vlerësimet për poetin dhe për librin në tërësi, si një vlerë e shtuar e jona. “Tashmë kemi një libër për Naim Plakun, ku janë zhvilluar një pjesë e krijimtarisë së tij, jeta me zigzaget e kohës, me kujtimet, vlerësimet e miqve dhe kolegëve të tij, si poet I këngës, si mbledhës i këngës popullore, si ish drejtues i Kulturës në Peshkopi pas viteve ’80 dhe si gjuhëtar, si njëri i sjellshëm me miqtë.”, tha ai në fjalën e tij.

Gjithashtu ai vuri në dukje prejardhjen historike dhe patriotike të Naim Plakut, e cila ndikoi në formimin e identietit dhe stilit të tij të krijimit. Gjabri u mor gjatë me jetën dhe bbigrafinë e Naimit duke sjëllë vlerësimet dhe sfidat e Poetit.

Fjalën më tej e pasoi Dr. Hajri Mandri, bashkëpunëtor me Naim Plakun. Ai vuri thkesin mbi çështjet e krijimit estetik të Naimit duke i mëshuar faktit dhe aftësisë së Poetit që gjërat e zakonshme ti kthente në gjëra të jashtëzakonshme. Ai ndër të tjera vlerësime thotë: “Naimi i përket panteonit të vlerave dibrane”. Mandri vlerësoi stilin dhe mënyrën e shkrimit te Naimit, duke e cilësuar si të papërsëristshëm.

Ndërsa shkrimtari dhe studiuesi dibran, Xhafer Martini, vlerësoi seriozitetin që kishte në arsim Naimi, thjeshtësinë që e karakterizonte, mënyrën se si fliste dhe se si sillej me kolegët. Mungesën e tij, Martini e quan një humbje kombëtare, duke e krahasuar me Naim Frashërin: Siç ishte Naim Frashëri për Shqipërinë, ishte edhe Naim Plaku për Dibrën.

Këngëtari, Mjeshtër i Madh Arif Vladi, shprehet se këngëtarët dhe të gjithë ata që bashkëpunuan më Naim Plakun ishin njerëz me fat. Gjatë fjalimit ai, këndoi disa vargje të Naimit duke entuziazmuar sallën.

Autori i librit, Shaqir Skarra, shprehu nostalgji për kohët më Naimin dhe pranoi përgjegjsinë e madhe që kishte marrë për të shkruar një libër mbi Naim Plakun. “Kur nisa të shkruaj një libër për Poetin e Këngës dibrane, isha vërtet në dilemë, më dukej se kisha marrë mbi supe një lis të madh, që nuk besoja se ishte një barrë për mua”. Ai falenderoi biznesmenin Latif Miha për mbështetjen dhe inkurajimin për të shkruar këtë libër, këngëtarin virtuoz Qerim Sula. Shaqiri falenderoi botimet M&B për punën dhe mbështetjen.

Më tej kënduan zërat e ëmbël dibranë, Lirie Rasha, Arif Madana dhe Dritan Jashari.

Ky takim dhe promovim u bë një kujtesë për Naim Plakun, si një poet, mësues dhe folkloristi më i njohur, që fali gjithë jetën për kulturën dibrane.



Dritan Qoku - Poezi

Dritan Qoku ka lindur në Kërçishtë të Epërm të Dibrës më 30 qershor të vitin 1975. Pasi kreu arsimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, përfundoi edhe studimet e larta në Fakultetin e Shkencave të natyrës, Tiranë. Ai sot është i martuar dhe ka dy fëmijë. Një aksident në vitin 2011, e detyroi të ulej në karrige me rrota, gjë që ndoshta e shtyu në rrugën e krijimtarisë aritstike. Dritan Qoku, ka punuar punë nga më të ndryshmët, duke nisunr ndërtimi e deri te gazetaria.

“Shqiptari në gri e zi” është vëllimi i dytë me poezi, pas të patit “33+33+33”. Që në parathënien e librit, Dritani, merret me sëmundjen tij duket fare qartë se kjo e ka bërë poet. Si gjithmone poet bëhesh kur vuan, kur rrin gjatë me veten, kur je kundra rrymës dhe të gjitha këto nuk të japin tjetër gjë vetëm se forcë. Kjo force dallohet qartazi rresht më rresht të këtij vëllimi poetik. Me forcën që i karakterizon këto vargje, vërtetohet se Perëndia, ia çon vështirësitë atij që mund ti mbajë dhe t’iu bëjë ballë. Këtu del në pahë metazicizmi i poezisë dhe lidhja e saj e fortë me njeriun, qoftë si ndjenjë e qoftë si nje formë arratisjeje apo kthimi në realitet. Ky vëllim i dritanit ndahet në dy kapituj, ku i pari titullohet “Apel”, dhe vjen si një për Shqipëtarët se si mund të ndyshojnë anët e tyre negative, duke i “gjuajtu” apo “thumbuar” ato pika të zeza që gjenden në vetet tona. Ndërsa kapitulli i dytë titullohet “Alla shqiptarçe”, ku nxjerr në pahë veset duke i kritikuar ato.

I gjithë libri karakterizohet nga një poezi e thjeshtë dhe e butë, pa u futur nëpër përsiatje filozofike. Kryesist poezite janë katrena me rimë AB, AB, pa përjashtuar edhe forma të tjera si distiku AA, BB.

Me këtë vëllim, i shtohet edhe një gjë tjetër e vyer poezisë dhe lëtërsisë dibrane. Kësaj kulle ku secili po kontirbuon në mënyrën e vet duke rritur lartësinë dhe cilësinë e saj.

PESHA E FJALËS

Mendoje fjalën, kur ta gjesh,
Ajo është armë dhe mund të vret,
Por fjala kurrë nuk fiton peshë,
Pse e ngre zërin edhe bërtet.

Ndaj thuaja vetes atë më parë,
Mendueshëm edhe qetë-qetë,
Vlerë e peshë do merr ajo fjalë,
Vetëm ashtu do bëjë tërmet.

RRJETET SOCIALE

Rrjetet sociale i duam shumë,
Me Instagram e Facebook,
Pak i përdorin për info e punë,
Shumë për reklamë e për t’u duk.

Një darkë, kur e hamë jashtë,
Ulur ngeshëm në kolltuk,
Pjata që kemi le të jetë dhe me kashtë,
Por mjaft të jetë e bukur për facebook.

FEJA E SHQIPTARIT

Muslimanë e të krishterë,
Harruan se çfarë ishin,
Politika po i verbon,
Besimin po braktisin.

Atdheut, por edhe fesë,
I largohen për çdo ditë,
I përulen politikës,
Dhe besojnë veç partitë.

Po harrojnë dhe Zotin,
Fatkeqësisht e dita-ditës,
Po fallen dhe betohen,
“Për kokën e politikës”!

Kjo feja e shqiptarit,
Ishte dikur shqiptaria,
Sot, për fat të keq,
Feja është bërë partia...!

O EMIGRANT!

Kur të kthehesh këtu në Atdhe,
Mos u nis pa të mësuar ne.

Ka plot gjëra, mësoji t’i dish,
Mos i harrosh, kur këtu të vish.

Këtu ka shtet e nuk është kot,
Këtu nuk vihet pa xhepin plot.

Nuk del dot që nga trageti,
Pa mësuar se ç’është rryshfeti.

Dhe në ardhsh me aeroplan,
Të njëjtën gjë edhe ata e kanë.

Xhepin plot, por do e bësh bosh,
Tridhjetë kontrolle kur t’i kalosh.

Në s’ke lekë, Zoti të dhashtë,
Se rrugorët të presin jashtë.

As te familja mos i lër gjithë lekët,
Se këtu nga qafa t’i heqin brekët.

Mbaji mend, vend për vend,
E njëjta gjë, kur të lësh Atdhenë.

RINIA, ... SOT...!

Kështu nisin ditën, pa mend e pa lekë,
Zgjimin e mëngjesit e bëjnë në drekë.

As mësimi, as puna, asgjë nuk u vlen,
Se rinia edhe shkollën, mezi po e gjen.

As libra e as lapsa, ata nuk mbajnë kurrë,
Në klasë të rrinë, vetëm si figurë.

Kërcet aty gallata, gjoja se shakara,
Se mendjen e kanë vetëm për belara.

Një temë aty ka, i gjithë muhabeti:
“Kështu është celulari, ashtu interneti”.

Me i ngritë në mësim, rrinë si të shkretë,
Se s’dinë të shkruajnë saktë as emrin e vet.

Flasin për biznes edhe për shumë miliona,
Por me zero lek i ke nëpër telefona.

Për një cigare duhan, kapen fyt me fyt,
Me këto vese të liga, duan me u rrit.

Disa pinë dhe “mall”, ca dhe heroinë,
nga surrati me lesh e vula,tamam stërvinë!

Për rininë e sotme, ç’fluturon dhe hahet.
Por jeta kështu, është vështirë që të çahet ...!

LIGJI I NATYRËS!

Gjithë jetës në ring,
Jeta me vdekjen përleshen,
Jeta fiton ca raunde,
Por kurrë s’fiton ndeshjen ...!

Vdekja mund të humbasë,
Ca beteja në jetë,
Por ajo do triumfojë,
Fund tjetër s’mund të ketë.

Sepse rrudhat kot s’u shtohen,
Syve dhe fytyrës,
Ajo që s’ndryshojmë dot,
Eshtë ligji i Natyrës .

Jeta kundër vdekjes,
Luajnë dhe SHAH, shumë gjatë,
E para ‘’luan’’ më fort,
Por në fund, do zihet MAT ...

Njerëzit e kësaj Bote,
Figura shahu, në tabelë,
Në fund, gjithë do zbrazen,
Asnjë, nuk ka me ngelë.

..është koha për t’u pagtuar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

Cikël me poezi
nga HALIL TEODORI

Vetëm s'më lë dot vetmia

Cikli poetik i Halil Teodoir "Vetëm s'më lë dot vetmia" është një tjetër hap në rrugën plot yje të ligjerimit poetik të këtij autori. Në këtë cikël ajo që pikas është një nevojë e shpirtit të poetit për të thurur vargje për vetminë, këtë gjëndje plotësie dhe boshi, këtë sprovë të ndjenjave dhe emocioneve të ndryshme. Vetminë, shpirti i poetit e ndjen si një zbrazje, e cila është me thellë dhe më e trishtë kur atë e gërryen braktisja e dashurisë. Nuk ka vetmi më të dhimbshme se sa ajo që ikën duke lënë pas kujtime dhe plagë. Por shpirti i poetit nuk jepet, ai është sfidues i të gjithë dhimbjeve dhe asaj të vetmisë. Sepse vetë jeta është një vetmi që kërkon shenjtërimin e vetmisë së vet në një betejë afrie dhe bashkëjetimi me njerëz, gjendje, emocione, dëshirime. Një vetmi që vjen për ta shuar vetminë e poetit është një vetmi që vjen për t'i mësuar atij se si s'mund ta lërë atë vetëm asnjë vetmi që i qaset.



Errësirë, jam shkrepëtimë vrufeje

E thellë,
e ftohtë,
e zezë dhe ngjethëse.
Perde prej terri që i hidhet syve prej drite.
Mjegull, që peshon mbi drurë dhe ajër,
heshtje që struk frikën,
lëshohet kah me sy vizatoj,
duke marrë të përpjetën.
Majëmalesh si pishtar i Prometheut
shihen me qiellin;
me retë e yjet,
më flutirimet dhe horizontin

Poshtë;
rrënjët dhe trungjet,
rrugët dhe gjurmët,
ikjet dhe shastisjet,
rënkojnë nën peshën e territ.

Në ditë me borë,
në bardhësinë që nderet si vello,
gjurmët si pend korbi,
një mesazh pikëllues më sjelli,
një krisje në zemër më çelin,
dhe..
kruspull mblidhem me dhimbjen,
me mallin dhe plagën.

Sa herë që i jepem lartësive,
epjes së kreshtës,
kaplimit të thirrjes,
ngasjes së gjakut dhe ashtit,
beh si një shkrepëtinë,
atje ku limfa dhe loti,
qumeshti dhe dëshirimi,
jepen.

Jo i them errësirës,
unë jam prej drite dhe jehonash,
jam prej plagësh dhe sralli,
prej amaneti dhe plisi, jam.
Jam dhe do të jem,
ai zë dhe ajo prekje
që peshon në gurin e pragut,
dheun e varrit.
Jam,
në çdo britmë dhe prehje
në çdo kryengritje dhe theror,
shkrepëtimë rrufeje.

I vetmuar nuk jam

Vetminë e njoh,
ajo nuk e di se kush jam unë,
nuk di asgjë për heshtjen dhe braktisjet,
nuk e mësoi kurrë rrugën e kthimit tek unë
mbeti vetëm në vetminë e vet,
unë...
jam gjithnjë atje ku gumëzhin,
ku zërat dhe sytë preken,
ku duart dhe buzët puthen.
Nuk jam asnjëherë vetëm,
as nuk e di se çfarë është vetmia.
Iki dhe vij gjithnjë me veten,
me kujtimet e mija,
me pëshpërimat e zërave.
...
Edhe kur dua vërtetë të rri vetëm,
s'më lë zëri i nënës,
vështrimi i atit,
dhe heshtja ime që kuvendon me ta.
Jo, i vetëm nuk jam,
edhe nëse dua,
s'më lënë...
vajzat dhe gruaja
gjaku dhe miqt
... poezia.

Vetëm nuk jam me ty

Shkojnë e vijnë udhëve të mia
rrugët ,
me baltë dhe kujtime të pluhrosura.
Ikin dhe rivijnë ,
në sytë që mallin i vadit me lotë
e dora jote e bardhë si re i shpalon,
siç era ta shpalosi petkun tënd,
e unë u mrekullova,
viseve tua prej drite dhe zjarri.

Iki dhe kthehem.
aty ku më pret një heshtje.
aty ku zëri yt vjen me zogjt çdo pranverë.
e ikën më gjethet çdo fillimdimri.

Ndërsa nata ka kapluar e dritat vezullijnë si yje,
hëna është strukur pas një reje,
e pema ku jam ulur me veten time,
gurron si guvë taftin e freskët të mbrëmjes.

Asnjë zë nuk vjen ti bëjë shoqëri vetmisë sime,
veç një bulkthi që zhubros heshtjen,
errësirën që ka mbuluar gjithçka.
Vërshoj mendimet me vështrimin rrethe e qark
vijnë tek ti dhe ikin gjithashtu.

Ti nuk je as sonte,
të mi bësh shoqëri vetmisë dhe mua,
pas një drite që pluskon diku tej,
ndoshta fshihesh.

Po, atje,
atje ku nata pikon drita,
shkëndi shkëlqimtare je ti,
duke numëruar yjet dhe frymëmarrjet,
duke prekur buzët e kafshuar puthjet.

Atje,
ku vetmia ime nuk vjen dot je ti,
këtu,
këtu ku vetmia jote s'më gjen dot,
unë prek në gishta trupin tënd,
ndjej në puls gjakun tënd.

Mbetëm larg duke i bërë shoqëri,
vetëmisë së njëri-tjetrit,
duke heshtur në pëshpërimën e zërave tanë,
duke u epshur në flakët e zjarreve
që na dogjën.

Ikëm ku një vetmi na priste,
sytë e tu mbeten të ngulur në mua,
puthja jote plagë la tek unë,
ikëm me vetmitë tona,
larg, atje ku vetmia s'të lë vetëm
ishim dhe mbetëm.

Të duash

Po te kesh pasuri, unazë më blej
Po je i varfër,
një puthje më jep,
një zjarr më ndez,
diell mu bëj ti çast shkëndijash,
dhe do të shohësh,
dhe do ta ndjesh,
dhe do të...
shkrehesh në mua si dëshirim.
Do të harrohesh,
në rreze do të shndërrohesh.

Ndalo në gjoksin tim,
prehje kërko në gjëmimin e atij kraharori,
e kokën struke në atë prush,
buzën ngjyje në atë zjarr,
trokthin e asaj zemre kalëro,
shko atje ku jetohen ëndrrat,
atje ku pranverat nuk shterrin,
dhe diejt nuk perëndojnë,
kur zogjt nuk ikin,
dhe fluturat të çojnë te aromat.

Shko dhe mos u kthe,
aty ku kishe ikjen,
askush nuk mund të të presë.
Rri te kafazi i kraharorit tim,
e jeto dhe këndo si zog,
dëshiro dhe ndjej si ajri,
fryma ime në ty fryn.

Le të shuhet kjo natë
ky cak që të solli tek unë,
të fiket si drita që na ndezi e na dogji.

Në agim

Kur vesa te ketë dehur diellin,
dhe gjithçka që ngjyhet me ar,
kur flokët e tu të rrëzohen nga gjoksi,
e kurmi yt të shkrehet në dritë,
bashkë me ditën,
një zgjim na thërret
një zgjimi i jepemi.

E dëgjojmë këtë zë,
në heshtjen,
që nderet mbi çarçaftë e bardhë
në të purpurten,
që kaplon trupat tanë.

Marrim gjithçka të bardhë,
vetëm çarçafët lëmë këtu e ikim,
ikim ku ajri na rrok me tërbim,
e drita na sheh me kureshti.
Ikim ku nuk ka sy që na ndjekin,
as heshtje që na vihet nga pas.
Ikim ku na çojnë këmbët,
ku vetëm frymëmarrjet,
dhe tik-taket e zemrave dëgjojmë,
e fëshfërimën e barit të njomë,
që na ngjitet për trup,
afshin e ditës që na eshket në buzë,

Ikim për tu shkrehur te njëri-tjetri
për të ngjizur një yll
atë që na ndezet në sy.

Në atë mëngjes

Në atë cak ku dielli vesh me dritë gjithçka,
kur nata...
dhe heshtja reshtin si të lehurat e qenve,
unë dhe ti,
i jepemi një zgjimi të bardhë,
një përqafim strallë,
në gjokse na ndez.
Syve pijmë dhe dehim agimin,
e zërave që flasin me heshtjen,
u pëshpërijmë ninulla netësh të largëta.

Gumëzhin jeta përtej kësaj dhome,
tej kësaj perde bota luan në skenë,
në të dy shihemi,
puthemi dhe presim,
do tregojmë se çfarë nata na tha,
çfarë heshtja na çuçuriti në heshtje,
çfarë dita është gati të na japë,
çfarë sublime kemi ne të japim.

Rruga e Arbërit nr. 145
kujtesë

Haki Pahumi bën pjesë në elitën e mësuesve të Dibrës, ndër më të vlerësuarit për kohën që punoi e jetoi.

Mësuesi orator **Haki Pahumi**

Nga **Zabit LLESHI**

Haki Pahumi lindi më 1915, në një familje të varfër qytetare të Dibrës Madhe. Fëmijëria e trishtë dhe e zymtë, nëna ndërroi jetë në moshë të re, duke lënë dy jetima të mitur, Hakiun pesë dhe Nazmiun tre vjeç. Abdullai, babai, mori djemtë dhe erdhi në Maqellarë, në familjen e Zabit Demës, daja i Hakiut. Për pak kohë familja u transferua përfundimisht në Vojnikë. Hakiu dallohej mes moshatarëve, ishte më i shkathët, i vëmendshëm, fliste rrjedhshëm, i kujdesshëm për veshjen, përpiqej të imitonte mësuesit, shoqërohej me më të mëdhenjtë. Shkollën fillore e mbaroi në Maqellarë, ndërsa atë unike në Internatin e Kastriotit me rezultare të shkëlqyera. Disa fëmijë të Internatit, midis tyre Hakiu, vizitonin shpesh pilotët italianë, që vinin në Kastriot me dëshirë të mësonin e komunikonin italisht. Internati i Kastriotit ishte fat për ato pak nxënës që vazhdonin në atë kohë. Shkollën e mesme e zgjidhi ndryshe Haki Pahumi.

Pothuajse çdo ditë ai me përshëndetje përcillte për Tiranë qiraxhinj, që vinin nga Dibra e Madhe dhe anasjelltas. Ëndërronte të bashkohej me njërin prej tyre për të ardhur në Tiranë. Me një karvan tregtarësh, herë në këmbë e herë në kalë në gjurmët e vjetra të rrugës së Arbërit erdhi në Kryeqytet. Ishte 13 vjeç, takoi ministrin e Arsimit dhe i kërkoi që t'i jepte mundësinë për të vazhduar shkollën e mesme. Ministri, i habitur për guximin dhe zgjuarsinë e djaloshit nga Dibra, i akoordoi bursë në gjimnazin e Shkodrës, të cilin e përfundoi me rezultate mjaft të mira. Në shkollë mësoi gjuhët frengjisht dhe italisht.

Pas shkollës së mesme, filloi punë si mësues në fshatin Shën-Pal të Mirditës, ku shpalosi njohuritë e fituara në shkollë të mesme, dolën në pah vendosmëria, puna e madhe edukative me nxënësit e prindërit, dashuria për profesionin e mësuesit. Dallohej për marrëdhënie korrekte e miqësore me fshatarët, duke dhënë një ndihmë të madhe për kulturën e jetesës, higjenën, ambientin në familjet mirditore e tjere.

Pasioni për profesionin e mësuesit e nxiti Hakiun të vazhdonte shkollën Normale të Elbasanit, të cilën e përfundoi më 1937. Përgatitja teorike- praktike për marrjen e provimeve të maturës, ra në sy të pedagogëve dhe drejtorisë së shkollës, prandaj i propozuan që të punonte si kujdestar konvikti në Normalen e Elbasanit. Detyrën e re e pranoi me kënaqësi, punoi aty deri më 1940.

Në vitet 1945-1947 emërohet n\prefekt i Qarkut të Dibrës dhe drejtues për arsimin në këtë qark. Haki Pahumi si një ndër kuadrot më të rëndësishëm të rrethit të Dibrës, dha një ndihmesë për luftën kundër analfabetizmit, shtrirjen e arsimit fillor, 7-vjeçar, përgatitjen e kuadrit arsimor, sidomos në kurset e kualifikimit professional e metodik, hapjen e shkollës pedagogjike në Peshkopi etj.



Hakiu ishte bashkëpunëtor i Mësuesit të Popullit Selim Alliu, mësues i dashur për qindra nxënës, shok e mik me dhjetëra mësues kolegë, prindër e drejtues të pushtetit të kohës, duke gëzuar respektin e tyre. Në gjurmët e tij punuan si mësues nipi Skëndër Pahumi (Mësues i Merituar), mbesa Myzejeni dhe vajzat Teuta në (Peshkopi e Durrës), Sanie (Batku) - një mësuese e dalluar, veprimtare e Organizatës së Gruas në rrethin e Dibrës.

Me kërkesën e tij, erdhi në Vojnikë pranë familjes, filloi punën mësues në Maqellarë. Më 1942-1943 punoi metodist në zonën e Tetovës. Më 1943-1945 rikthehet në Maqellarë dhe Alajbegi si mësues. Gjatë kësaj kohe u aktivizua si veprimtar i Luftës Nacional-Çlirimtare në Frontin Demokratik, duke u zgjedhur në forumet më të larta të kësaj organizate. U martua me Nexhmije Adem Sharofin. Ademi ka punuar mësues në disa fshatra të Dibrës së Sipërme dhe të Poshtme. Tre fëmijët e Hakiut, djali Hekurani (merceolog) punoi në Durrës, ndërsa vajzat plotësuan dëshirën e të atit, u bënë mësuese të vlerësuara nga shkolla dhe Shoqëria.

Në vitet 1945-1947 emërohet n\prefekt i Qarkut të Dibrës dhe drejtues për arsimin në këtë qark. Haki Pahumi si një ndër kuadrot më të rëndësishëm të rrethit të Dibrës, dha një ndihmesë për luftën kundër analfabetizmit, shtrirjen e arsimit fillor, 7-vjeçar ,përgatitjen e kuadrit arsimor, sidomos në kurset e kualifikimit professional e metodik, hapjen e shkollës pedagogjike në Peshkopi etj.

Gjithnjë interesohej për kulturën në përgjithësi e veçanërisht për kulturën popullore, kujdesej për mblodhjen e materialeve folklorike. Dallohej për një kulturë e formim të gjithanshëm, komunikonte bindshëm me të gjitha kategoritë e moshave, shquhej për oratori të ëmbël, që tregonte nivelin e tij kulturor e të gjithanshëm.

Në kohën kur Haki Pahumi kishte përveshur mëngët për të dhënë maksimumin e energjive në fushën e arsimit, papritur e ndërprenë, iu desh të përballej me disa akuza, si "qëndrim të butë ndaj elementëve të deklasuar", shpërdorim fondesh në ndihmat për arsimin etj, që i kushtuan jo pak, por dy vjet privim lirie.

Me oratorinë dhe kurajon të tij, i rrëzoi akuzat, sa prokurori u detyrua të pohojë para gjyqtarëve se : "Hakiu ka një logjikë dhe një oratori të addmirueshme, prandaj nuk ka marrë as avokat". Megjithatë ai u dënua. Në burg drejtoi disa kurse kundër analfabetizmit për të burgosurit. Pas daljes nga burgu, do të merrte pafajësinë, por ato vite lufte e përpjekje për të drejtën, lanë gjurmë në jetën e oratorit e mësuesit të apasionuar.

Më 1949 deri në vitin 1951punoi si mësues e drejtor shkolle në Maqellarë. Më 1952 deri më 1955 ishte drejtues i Arsimit në rrethin e Dibrës, ku konributi i tij ishte i madh. Tashmë pikësynimi i tij ishte dërgimi i sa më shumë nxënësve në shkolla të larta. Në biseda me prindërit e nxënësve, me strukturat në bazë e në rreth, Shumë të rinj e të reja shkuan në shkollë të lartë, prandaj i ishin mirënjohës Hakiut. Ndër ta ishin Nuri Abdiu-Mësues i Popullit, Tosun Xhemali, Allaman Isaku-pilot, Pervis Maksuti-avokat, Qamil Rama, Myrteza Rema etj.

Më 1955-1956 emërohet drejtor i shkollës 8-vjeçare "Demir Gashi" Peshkopi. Më 1957-1958 u ngarkua me detyrën e formimit të kooperativës bujqësore Vojnikë, detyrë që e realizoi me sukses. Më 1958 deri në mesin e vitit 1961 punoi në Kabinetin Pedagogjik të Peshkopisë. Gjatë kësaj detyre, njëkohësisht mbulonte atë të drejtuesit të shkollës së lartë të korespondencës në rrethin e Dibrës.

Burgosja dy vjet, përballja me ligësitë e disa personave, ishte një dukuri e injorancës, për të përbaltur intelektualët. Si një njeri me karakter por dhe I ndjeshem një sëmundje e pashërueshme ndikoi shumë në përkeqësimin e shëndetit. Brengat dhe stresi i vazhdueshëm krijuan efekte negative. Atij i krijohet një tumor, që nuk do kalonte pa pasoja. Shenjat u dhanë pas daljes nga burgu, që dalëngadalë do të gërryente organizmin e mësuesit patriot.

Në fillim të vitit 1961, sëmundja kishte avancuar, aq shumë, sa humbi shikimin.

Njohuritë që kishte, sidomos gjuhët e huaja frëngjisht e italisht, i kishin dhënë mundësi të studiojë dhe vet ekzaminojë sëmundjen, që u vëretua me analizat e dërguara në ato vite në Gjermaninë Lindore. Shteti e dërgoi në Gjermani, por gjendja e tij shëndetësore nuk e përballoi dot operacionin. Këtu u ndal zemra e mësuesit Haki Pahumi. Ai u nda nga jeta në moshë të re, duke lënë një trashëgimi të pasur dhe eksperiencë të përparuar në fushën e mësimdhënies në shkollë, në zgjerimin e Arsimit në rreth etj.

Hakiu ishte bashkëpunëtor i Mësuesit të Popullit Selim Alliu, mësues i dashur për qindra nxënës, shok e mik me dhjetëra mësues kolegë, prindër e drejtues të pushtetit të kohës, duke gëzuar respektin e tyre.

Në gjurmët e tij punuan si mësues nipi Skëndër Pahumi (Mësues i Merituar), mbesa Myzejeni dhe vajzat Teuta në (Peshkopi e Durrës) , Sanie (Batku)- një mësuese e dalluar, veprimtare, e organizatës se Gruas në rrethin e Dibrës.

Haki Pahumi bën pjesë në elitën e mësuesve të Dibrës, ndër më të vlerësuarit për kohën që punoi e jetoi. Do të ishte në nderin e organeve lokale, që të përjetësohejt, duke i vënë ndonjë shkolle, emrin e mësuesit orator Haki Pahumi.

Atëherë ishim vetëm 15 vjeç

(vijon nga faqja 16)

Të shumta ishin veprimtaritë sportive si: futboll, volejboll, shah, basketboll, gjithmonë në garë me klasat e tjera. Ne kishim ekipin e futbollit të klasës që drejtohej nga i talentuari i klasës Esat Shehu. Po kështu mjaftë mirë ishim me grupin artistik të klasës, si ai i skeçeve, i teatrit, i recituesëve, grupi i violinës, i mandolinës etj. Shumë aktivë ishim në marshimet apo pikniket që organizonte shkolla në natyrë, në Sohodoll, në Kastriot, Melan etj. Atje si klasë nuk ndaheshim kurrë, organizonim lojëra a veprimtari të ndryshme. Uleshim, hanim drekën së bashku, ku i këmbenim sipas dëshirës edhe ushqimet që u kishte dhënë nëna me vete të jashtmeve me konviktorët. Në darkë ktheheshim në konvikt pak të lodhur, por të kënaqur se kaluam një ditë plot mbresa e kujtime të pashlyera. Kalonim një natë me gjumë të rehatshëm e me ëndrra.

Po kush ishim ne mësuesit e ardhshëm?

Dëshiroj t'i kujtoj sot pas 55 vitesh: Ahmet Mersini, Lik Berisha, Sami Reçi, Fadil Merdini, Fadil Manjani, Latif Manjani, Qemal Rusi, Fatmir Deshati, Menduh Lusha, Mesur Hoxha, Xhevdet Hoxha, Esat Shehu, Fiqirete Shehu, Fatmira Zenuni, Burbuqe Musaraj, Sanije Pahumi, Meriban Spahiu, Rakip Allushi, Destan Rama, Musa Likalla, Dedë Doçi, Destan Visha, Nexhbedin Shehu, Bajazit Shehu, Qani Përtafi, Xhavit Kurti, Agim Basha, Urim Spahiu, Iljaz Palushi (u kërkoj ndjesë shokëve nëse kam harruar ndonjë emër.) I përshëndes të gjithe shokët ku janë dhe u uroj të gjithëve jetë të gjatë.

Por nuk mund të fitohet profesioni i mësuesit pa mësues, ndaj dua të kujtoj me mjaft repsekt dhe dashuri ata që donin të na bënin si vetja e tyre që edhe ne në të ardhmen të bëheshim si ata, të mësonim dhe te edukonim brezin e ri. Kujtoj: Ismail Erebara (mat-fizikë), Veiz Karagjozi e Lutfi Hanku (gjuhe-letërsi), Jorgji Sinjari e Riza Manjani (histori), Nevrez Manjani (gjeografi), Moiz Cami (kimi), Hasan Kaduku e Kadri Zhulali (gjeometri, steriometri), Sabri Vraniçi (biologji, zoologji), Anton Lakuriqi e Bujar Elmazi (vizatim, bukurshkrim, p. praktike), Zenel Sula e Uruç Beqiri (rusisht), Munir Shehu (muzikë), Hamza Spahiu (edukim fizik), Sotir Greku e Kol Nikaj (pedagogji, psikologji), Xhetan Strazimiri (edukatë morale).

Kam adhuruar gjithmonë korrektësinë e Ismailit, këmbënguljen e Veizit, shpjegimin e Lutfiut, urtësinë e Sabriut, seriozitetin e Nevrezit, shprehjen e bukur të Hasanit me atë shkodrançen E F EM, veshjen dhe elegancën e Zenel Sulës, ecjen karakteristike të Hamzait, apo atë të folurën e veçantë, me dialektin gegë të Kol Nikaj.

Të gjitha këto bashkë kanë qenë për mua një udhërrëfyes dhe model në profesionin tim të mësuesit. Të nderuar profesorë ju kishit atëherë një moshë jo shumë të largët me ne, ndaj edhe silleshit të dashur e komunikues me ne e kështu gëzoni edhe sot respektin tonë.

Mirënjohje edhe për mësuesit e ushtrimores tek të cilët ne kryenim pedagogjinë praktike; Remzi Prapaniku, Jolanda Rada, Hava Hoxha.

Sa do të dëshiroja që në një ditë në këtë 70-vjetor të çeljes së shkollës të mblidheshim në Peshkopi ne si maturë e të kujtonim ato vite të bukura mbresëlënëse ku ne u rritëm, u burrëruam dhe u profesionuam.

portret

Në udhët e dijes e të jetës, intelektuali Elmaz Murati tregoi zotësi dhe pasion dhe kreu më së miri të gjitha detyrat.

Provat e jetës e të përkushtimit të Elmaz Muratit

Nga **Mevlud BUCI**

Jeta,përkushtimi,provat dhe rrezatimi i shpirtit përmes tyre,janë dhe mbeten përjetësia e njeriut.Sigurisht,që jo shpesh njerëzit vlerësojnë provat, përkushtimin,por këto lënë gjurmë dhe madhështojnë cilindo që shembëllen në rrugët e jetës.Figura e inxhinierit të talentuar dhe demokratit të shquar të Kalisit,Elmaz Murati, është skalitur ndër vite përmes shembujve përkushtues ndaj punës dhe drejtësisë dhe mirësisë. Kushdo që jeton atyre anëve,po edhe më gjerë, ka dëgjuar për të parët e tij,kullën shekullore,traditat,për vëllezërit e vet,për gjurmët që kanë lënë në përballje me vështirësitë,pasionin,dritën e nderimit,vlerat e diturisë, të çmuara prej tyre.Historia e gjyshërve dhe xhaxhallarëve si: Bajram e Shuaip Zita(Murati),e babait, Enver Murati,gjurmët e punës dhe të jetës si: Zita,Ramazani,Shehati dhe Hajriu,bujaria dhe traditat e të parëve të kullës Zitë e Dullë Rexha,përbëjnë një epope qëndrese dhe fisnikërie.Të tre vëllezërit :Bajrami,Enveri e Shuaipi ishin dhe mbeten qëndrestarë kundër diktaturës e sistemit të pabesisë së luftës së klasave.Për kullën e Zitës me tre poda, në Zall –Kalisin e qëndresës, mund të shkruhen me dhjetra shkrime,poezi,poema e reportazhe, libra,triologji.Për traditat dhe gjurmët e gdhendura në histori të këtij fisi kanë shkruar gazetarë e studiues si:Fatos Mehdi Daci,poeti i talentuar Naim Plaku,studiuesi dhe botuesi që jeton në Amerikë Hysë Xhemali Hasa e disa të tjerë,por, për këtë familje të nderuar, ende ka vend për të shkruar, se bëmat e brezave të saj u ngjajnë galerive të thella me plot minerale,apo livadheve luleshumë me plot kurora të blerta përreth Korabit e Gjallicës,peizazheve plot bukuri të anëve të Drinit të Zi e Veleshicës plot gurgullimë.”Ku rrjedh,pikon”,thotë populli.Geni i Elmaz Muratit vjen nga kulla qendrestare;ai është pasardhës i burrave të fisnikërisë e të shumëvuajtur nga diktatura mizoriste e lufta përbindshërore e klasave, që nuk kursente asgjë.Nga kjo luftë e paprinciptë, xhaxhallarët Bajrami e Shuaipi dhe babai Enver Zita(Murati)nuk u mposhtën. Sidoqë, Bajrami,më 13 gusht 1946 u akuzua për agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor dhe se kishte strehuar Cen Elezin,kur ky ishte në arrati,bazuar në nenin 273,datë 21 gusht 1946 në një gjyq special nga gjykata e Elbasanit,u dënua me 10 vjet heqje lirie,ku 5 vjet dhe3 muaj i kreu në burgun famëkeq të Burrelit.Edhe xhaxhai tjetër i Elmazit,Shuaip Zita(Murati),ka lënë gjurmë të pashlyeshme në provat e jetës dhe të martirizimit.Shuaipi kishte kryer kursin ushtarak në Itali në vitin 1938-1939.Në kohën e mbretërisë, shërbeu si oficer xhandarmërie.Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare kreu detyrën e komandantit të kompanisë në brigadën 24 sulmuese.Pas çlirimit, punoi si oficer policie në Iballë të Pukës,dhe pastaj në Tiranë si oficer,shef garnizioni, gjersa, më 8.04.1947 , u arrestua si i akuzuar se”ka krijuar një grup reaksionar kundër pushtetit popullor,ka bërë sabotime,atentate e lirim të burgosurish dhe pastaj ka tentuar të arratisej”.Për këto akuza, me vendim nr.176,dt.9.07.1047 ,nga një gjykatë ushtarake u deklarua fajtor dhe u dënua me vdekje,kur ishte në lulen e rinisë, në moshën 26 vjeçare, dhe u ekzekutua më 4 nëntor 1947 në orën 16.30.Qëndroi siç u ka hije bijve të kullës,mbeti i paharruar si martir i demokracisë,në altarin e kohërave dhe të breznive,në kujtime,këngë, si demokrat i qëndresës,nacionalist ,martir dhe antikomunist.



Besatim lirie, krenari brezash për qëndrestarët, rrezatim demokratik me prova jete e përkushtimi, kjo është deviza e inxhinierit, intelektualit të fisnikërisë, demokratit të shquar, Elmaz Murati. Urimet në brezni sjellin gjithnjë jehonën e viteve të kësaj familje fisnike, bukurinë, madhështinë e të djeshmes dhe të së sotmes, por edhe provat e përkushtimit të një jete me dinjitet e të lartësuar.

DRITA E PASIONIT

Elmaz Enver Murati u lind më 14.02 1951 në Zall Kalis.Ai u rrit dhe u edukua me traditat e vyera të bujarisëdhe urtësisë,me kararet e fisit,të mikpritjes dhe respektit për shokët miqtë dhe të afërmit.U dallua në të gjithë ciklet e shkollimit për talent dhe mprehtësi dhe për dritë pasioni për dije.Ky pasion shënohet, kur ai, shkollën tetëvjeçare e përfundoi në Sllovë të Dibrës duke udhëtuar 2 orë në këmbë;se asaj kohe nuk e kapte rrezja e veprimit.Me tipare të larta të karakterit, me dëshirë e vullnet të rrallë ai, më 1969 ,u diplomua gjeometër për ndërtim në Tiranë,kurse më 1979 përfundoi me rezultate të larta UT, i diplomuar për ing.ndërtimi. Në udhët e dijes e të jetës, intelektuali Elmaz Murati tregoi zotësi dhe pasion dhe kreu më së miri të gjitha detyrat. Punoi si profesor në shkollën e ndërtimit në Kukës, përgjegjës sektori në ndërmarrjen e bonifikimit Dibër (kantieri Kukës),përgjegjës i nvestimeve në kooperativën bujqësore në Zall Kalis, projektues në preventivë objektesh.Kurdoherë me sedër dhe aftësi,me kompetencë e drejtësi, shërbeu dhe si drejtor në kantierin e ndërtimit në Lezhë për zhdukjen e pasojave të tërmetit(drejtor për rrethin e Kukësit, kryetar i degës teknike,firma sh.p.k”Rifel”,Tiranë,drejtor teknik i firmës”Genci Bici”sh.p.k.).Nga 2009 e në vazhdim,ing.në Zyrën e Urbanistikës,projektim dhe administrim në bashkinë Kamëz.Me këtë pasion rrezatojnë punët që ka kryer dhe drejtuar.Kërkues ndaj vetes,me takt e durim dhe dashamirës ndaj shokëve dhe i papërtuar.Peng i ka mbetur fakti që të vëllanë Shehatin,që mbaroi shkollën me dhjeta, e la për pedagog. Sidoqoftë ai është krenar me vëllezërit e thjeshtë e të talentuar,të urtë e ballëdjersitur.Vërtet Elmazi mban dekoratën”Medalje e Punës”,por dekorata më e madhe është puna që ai ka kryer,shpirti demokrat,përkushtimi për atje ku e kërkon koha ,detyra.

BARDHËSIA E SHPIRTIT

“Inderuari të nderon ,shoku që të dinvlerën,ta jep atë,mbetet ortak me malin e me pranverën”.Kjo sentencë mbetet një dëshmi e fortë e pakontestuar kur duhet të flasësh dhe ta përkufizosh portretin e tij.Prind shembullor,intelektual fjalëpeshuar,i mprehtë,durues,mjeshtër në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët,fjala e matur,zgjuarsia natyrale,nderimi për familjen,miqtë,mbeten cilësi të vyera të këtij intelektuali të formuar.Në gjurmët e bashkëshortëve Elmaz e HumieMurati(Ukëlala) ,bijë e Reçit ,ecin edhe fëmijtë e kulturuar e të ditur.Djali,Kujdesiu, ka mbaruar UT për mësues gjeografie,specializuar në Itali për antidrogë,ka dy fëmijë si yje;Majlinda është martuar tek fisi i nderuar Istrefi,ajo ka kryer gjimnazin dhe ka tre fëmijë;Fatosi ka shtatë vjet që është emigrant në Angli,i specializuar për ing.duralumini,Fëmijtë e tjerë Enver Elmaz Murati, që mban emrin e gjyshit(të cilit i është derdhur shtatore para vilës në Laprakë) kujtim ky i djemve;Enveri i Ri,Nekiu ,djalë i katër i Elmazit(fëmija I pestë) ecën në gjurmët e traditave të të parëve e të punës,i urtë e i përkushtuar,ai ka mbaruar për menaxhim biznes.Elmazi dhe gruaja e tij rrinë me Nekiun dhe Nekiu ka një djalë.Secili e ndjen dhe e justifikon peshën e provave prindërore.Dy prindërit, Enver e Humie.Së bashku me dy fëmijtë e dy fëmijtë e Fatosit e dy të Enverit,dy të Kujdesiut e tre të Majlindës dhe të Nekiut kanë djetë nipër dhe mbesa,të cilët janë në udhët e dijes.Krenaria e jetës për Elmaz Muratin, janë shokët e miqtë,fisi dhe traditat. Ai flet me respekt të madh për Xhelal Mziun ,siç e quan “Arkitekt të Kamzës së Re e të Paskuqanit”,i rrallë në artin e drejtimit,në ecjet e përkushtimit demokratik. Ky bir i Reçit historik, jo vetëm që është një nga kryebashkiakët më të nderuar në Shqipëri,por gjithnjë mbetetet një ikonë e veprave që sjellin zhvillim duke u votuar unanimisht disa herë dhe, po disa here, duke sjellë gjithnjë efekte dhe risi në bashkinë ku drejton, që mbetet një nga bashkitë më të mëdha në Shqipëri; ,flet për të nderuarit Hysni Gjoçi,Ali Elezi,Fatos Daci,Shaqir Shehu,Bashkim Kaçi.Lidhjet e kullës së së Zitës e Dullë Rexhës janë edhe me kullën e Misim Ahmetit të Reçit e Ibrahim Gjoçit të Lurës.Tek familja dhe shokët,tek geni i dajave,tek Çollakët e Sllatinës si dhe në gjurmët e provave që rrezatojnë.”Të më kishte gjetur demokracia edhe më të ri,... ,thotë Elmazi,ndërsa gjithmonë shpirtin e ka bardhësi.

KRENARI BREZASH...JEHONË KËNGËSH

Kulla me tre poda në Zall Kalis,sinonim i qëndresës së të parëve të Elmaz Muratit ngjan me kështjellën,u përcjell brezave krenarinë e gjyshërve,jehonën e këngëve.Kulla e Zitë e Dullë Rexhës rriti edhe qëndrestarët,tre vëllezërit promote përballë monizmit.Elmaz Murati krenohet me të parët,xhaxhallarët Bajram e Shuaip Zita,(Murati),me vëllezërit Zitën e Ramazanin,Shehatin e Hajriun. Ramazani,biri human e shpirtbehar nuk jeton më.Ai rrezaton fisnikëri,bujari e vitalitet,ai dhe vëllezërit e tij në Laprakë ngritën vilat dhe para vilës së tij ngriti,derdhi në bronx shtatoren e babait të paharruar Enver Zita(Murati).Edhe fëmijtë e vëllezërve të Elmazit janë të gjithë të shkolluar e të kulturuar.Geni çel genin.Kështu,nipi i Elmazit,Fatjon Murati është boksier,kampion në disa shtete të botës,ku,në ringjet më prestigjioze mori medalje të arta, bëri që të këndohet himni dhe të shpaloset flamuri kombëtar.Krenari zemre,krenari brezash. Kulla dhe bijtë e saj kanë tashmë plot këngë të bukura.Poeti i mrekullueshëm Naim Plaku thuri vargje për Shuaip Zitën:”Mbaju fort,o kulla e Zitës’,”Veleshicë,moj ndale vrapin”, e plot të tjera.Këngët janë sinonim i burrërisë,qëndresës,i shpirtit të lirë demokratik.Duke njohur dhe lartësuar këto vlera,duke përkrahur të rejat e kohës,kështu edukohen brezat,ndrit historia.Elmaz Murati krenohet kur kthen kokën pas,krenohet për provat e jetës dhe të përkushtimit.Do të mbeten testament,këngët,qëndresa,puna e përkushtimi.Pena e legjendës Naim Plaku,midis të tjerash shkruan:

”Del prej toke zani i shpresës/Qofsh bekue, oj shpia e Rexhës/,Siç thotë nana kur të përkund/Bir,o bir m`u bafsh katund/Ke shumë nipa edhe mbesa/Në Tiranë këndon Zitë Rexha/Knon bilbili sa del drita/Amanetin siç e la Zita”...

Besatim lirie,krenari brezash për qëndrestarët, rrezatim demokratik me prova jete e përkushtimi,kjo është deviza e inxhinierit,e intelektualit të fisnikërisë, demokratit të shquar, Elmaz Murati. Urimet në brezni sjellin gjithnjë jehonën e viteve të kësaj familje fisnike,bukurinë madhështinë e të djeshmes dhe të së sotmes,por edhe provat e e përkushtimit të një jete me dinjitet e të lartësuar.

O K A Z I O N !

Shitet **APARTAMENT:** 2 + 1(87.3 m²)
pranë Drejtorisë së Përgjithshme
të Doganave, Laprakë.

570 Euro/ metri/katror, E MOBILUAR!

Cel.: 0692098212



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/ Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.



Supë me kungull të verdhë



PËRBËRËSIT PËR 4 PERSONA: kungull 400 gr.; qepë 1 kokërr; gjalp 50 gr.; 1 fetë bukë; vaj ulliri; piper; kripë.

VËSHTIRËSIA: e thjeshtë.

KOHËZGJATJA: 30 minuta.

PËRGATITJA: Në një tenxhere skuqim qepën e qëruar dhe të prerë në feta të holla në pak vaj, shtojmë kungullin të prerë në kubikë të vegjël pasi i kemi pastruar më parë nga lëkura. E lëmë të skuqet për pak minuta më pas shtojmë ujë për të zier duke e kontrolluar herë pas here. Masën e përftuar nga zierja e bluajmë në mënyrë të tillë që të krijohet një krem i lidhur mirë. Shtojmë gjalpin, kripën dhe piperin. Bukën e presim në kubikë të vegjël dhe e thekim në furrë për pak kohë. Hedhim supën në një pjatë dhe i shtojmë sipër copa buke të thekura dhe pak vaj.

info@vivandachef.al

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT...

Kushton vetëm 600 lekë në vit... / email: rrugaearberit@gmail.com

LIBRA

Të gjithë këto tituj te libraria M&B në Tiranë i gjeni me 10% zbritje nga 1 qershori deri më 30 gusht 2018

...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...



1500 lekë



1500 lekë



700 lekë



800 lekë

Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë, **librarisë M&B** në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi.

Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):